

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 E mërkurë, 8 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 9.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare e Seancës, paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
14 çaktivizuar.

15 Për procesverbal, z. Krasniqi na ndjek përmes
16 videolidhjes. Ndërkohë që të akuzuarit e tjetër janë të
17 pranishëm në sallën e gjyqit.

18 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
19 Prokurorisë 03825. Do të vazhdojmë të qëndrojmë në seancë
20 publike me përjashtim të rasteve kur do kërkohet që të kalojmë
21 në seancë private për arsye bindëse.

22 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin ë sallë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryesues, kemi një çështje
24 logjistike që ka të bëjë me dëshmitarin e radhës, duam t'ju
25 njoftojmë që e ulim kohën e vlerësuar për të bërë pyetje për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 të nga tre orë në një orë, kështu që besoj që do kemi kohë të
2 mjaftueshme për të përfunduar me dëshmitarët deri në fund të
3 javës.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
5 përditësim tjetër?

6 Z. STRONG: [Përkthim] Pas pyetjeve për kolegun tim nuk
7 mendoj se do të kemi pyetje nga ekipi i klientit tonë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

9 Z. TULLY: [Përkthim] Mendoj që do më duhet një orë e
10 gjysëm, gjysma e kohës që kisha parashikuar fillimisht.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Unë kërkoj të njëjtën kohë që kam
13 thënë edhe të hënën.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
16 Dëshmitar.

17 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi për të gjithë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
19 vazhdojmë me dëshminë tuaj sot. Dua t'ju kujtoj që ju lutem
20 mundohuni të jepni përgjigje pyetjeve qartë me fjali të
21 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i
22 kërkonit Avokatit që ta përsërisë pyetjen, ose t'ju thoni që
23 nuk e kuptoni pyetjen në mënyrë të tillë që sqarohet pyetja.

24 Po ashtu ju lutem na tregoni se cila është baza e
25 njohurive dhe fakteve apo rrethanave për pyetjet që do t'ju

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 3

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 bëhen.

2 Ju kujtoj gjithashtu që jeni nën betim për të thënë të
3 vërtetën.

4 Po ashtu ju lutem flisni përpara mikrofonit dhe prisni
5 pesë sekonda përpara sesa t'i përgjigjeni pyetjes. Flisni
6 ngadalë në mënyrë të tillë që t'ju kapin përkthyesit. Po ashtu
7 ju lutem prisni derisa të përfundojë pyetjen Avokati para se
8 të jepni përgjigje sepse pastaj bëhet shumë e vështirë për të
9 marrë përkthimin e duhur në qoftë se kemi ndërprerje të kësaj
10 natyre.

11 Nëse keni nevojë që të bëni një pushim, na e thoni këtë
12 gjë dhe do të bëjmë organizimet e nevojshme.

13 Mbrojtja e z. Thaçi, mund të vazhdoni.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

15 DËSHMITARI: W083825 [Vijon]

16 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

17 [Vazhdim]

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

20 PË. Mirëmëngjes.

21 PY. Do fillojmë sot duke e parë të gjithë videon e
22 konferencës për shtyp të datës 23 shtator 1998.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
24 paraqesë në ekran provën materiale P321, duke filluar nga
25 minuta e 15, sekonda e 50 e asaj video.

1 Znj. Sekretare, ju kërkoj ndjesë, në fakt, dua që të
2 transmetohet një video që është me titrat në anglisht në
3 mënyrë të tillë që të mund ta ndjekin të gjithë palët në
4 sallë. Për procesverbal është videoja DHT01416.

5 [Luhet video incizimi]

6 [Zëri] "Pra, bëhet fjalë për konferencë që e ka mbajrt z.
7 Gjergj Dedaj pas kthimit nga kjo vizitë në Drenicë që e cila
8 është komentu gjatë edhe që besoj se do të komentohet akoma më
9 shumë. Ta shohim këtë material e kthehem në studio për ta
10 dëgjju pastaj rrëfimin e z. Dedaj për atë se çfarë ka ndodhur
11 atje".

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Ta ndalojmë këtu ju lutem.

13 PY. Z. Dedaj, tani do të filloj të aktivizoj videon për
14 konferencën për shtyp, por dua që t'i kushtoni vëmendje jo
15 vetëm asaj çfarë do thoni, por do ju kërkoja që t'i kushtoni
16 vëmendje të posaçme vetes tuaj në video. Dhe, për shembull, në
17 qoftë se vini re që shfaqni ndonjë shenjë jo rehatie ose bëni
18 ndonjë shprehje fytyre ose ndonjë shenjë tjetër që mendoni që
19 ia vlen që të ndahet me neve, ju lutem na thoni që ta ndalojmë
20 videon. A e kuptuat udhëzimin, Dëshmitar?

21 PË. Po

22 PY. Në rregull.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë znj. Sekretare, ju lutem
24 të vazhdoni me videon.

25 [Luhet videoincizimi]

1 [Zëri] "Me të arritur në Qirez, pasi kemi kalue një rrugë
2 nëpër disa fshatra, pasi që jemi ndalu disa herë, bile në
3 punktet e policisë serbe edhe nga një orë e gjysë, domethënë,
4 ka arritur një efektiv i policisë, siç thanë ata, sekrete të
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët kanë pyet për kush
6 është organizatori, kush udhëheq grupin, kush janë këta këtu.
7 Na thashë ishim nga Prishtina 30 pjesëmarrës në delegacionin,
8 këtu prefshi edhe gazetarët.

9 "Unë kanë pasë biseda edhe të ndara me ne. Kryesisht janë
10 interesu dhe na thanë për aktivitetin tonë politik,
11 aktivitetin e secilit. Unë flas për bisedat që kanë pasë me
12 mu, aktivitetin tim politik në cilësinë e nënkryetarit të
13 Kosovës dhe në cilësinë e kryetarit të Partisë Liberale të
14 Kosovës. Metoda e marrjes tonë, ndalimit tonë, për mu
15 personalisht ishte e pakuptimtë, e panevojshme, sepse nuk
16 ishim njerëz të panjohur në projektin tonin. Aktiviteti jonë
17 gjithmonë ka qenë legal që të japim prioritet gjithmonë.

18 "Dje pasi ka filluar një ofensivë shumë e egër, që
19 Drenica ishte në një shtetrrëthim të plotë, mund të them të
20 hekurt. Në Qirez kemi parë një gjendje thashë edhe rrugës për
21 në Qirez ku njerëzit lëviznin në drejtime të ndryshme duke
22 ikur edhe e pyetnin njëri-tjetrin, "Ka je ka shkon ti?", "Ka
23 po shkoj unë?". Domethënë, një gjendje ku njerëzit vërtetë në
24 udhëkryqe nuk dinin kush ku po shkon. Një gjendje se s'mund të
25 përshkruhet, domethënë, si pasojë e kësaj ofensive të egër

1 serbe. Dhe ishim mjaft të shqetësuar. Deri në orën 14.00,
2 domethënë, ditës së djeshme, domethënë, 48 orë dhe kështu na
3 kanë shqiptu se tash janë të liruar dhe ju kemi mbajt në
4 ndalim për 48 orë.

5 "Interesimi i tyre ishte, domethënë, në radhë të parë pse
6 nuk e kemi paralajmëru vizitën, që mendoj se ne nuk do ta
7 paralajmërojmë vizitat kur shkojmë asnjëherë. Dhe do shkojmë
8 edhe në territore tjera sepse, thashë, e kemi obligim se po
9 shkojmë te njerëzit tonë te tokat tona, te trevat tona.

10 "Nuk kemi qenë të kërcënuar e them në kuptimin e fjalës
11 'kërcënim'. Kur mendoj se ndalesa, sipas mendimit tim, ishte e
12 pakuptimtë. Sepse nuk kish kurrfarë arsye që ne të ndalohemi
13 përderisa ne ishin të gjithë persona publik. Domethënë ishim
14 njerëz që për aktivitetin tonë, për punën tonë, gjithmonë,
15 domethënë, e din opinionin dhe është ditë dhe kemi punuar në
16 mënyrë legale. Prandaj ne s'ishim shku atje të bëjmë kurrfarë
17 propagande as politike, as partiake, as kundër UÇK-së, as pro
18 UÇK-së. Ne, thashë dhe në fillim, misioni i ynë ishte i
19 karakterit humanitar.

20 "Ato forca, ai efektiv që jemi taku kanë pasë sjellje
21 korrekte me ne. Ndërsa sa i përket asaj se ne jemi parti të
22 tjera, jemi, domethënë, të afërta me Presidentin Rugova,
23 mendoj se çdo respekt kemi të gjithë partitë politike për z.
24 Rugova, Presidentin e Republikës së Kosovës, i cili në
25 zgjedhjet e fundit ka fitu votën e popullit të Kosovës.

1 "Nuk kam dijeni çfarë argumentesh kanë pasë ata, mund
2 t'ju them publikisht se nga të gjithë pjesëmarrësit që ishim
3 nuk mund të ekzistojë as në letër, as e thënë me gojë, as me
4 shkrim, se jemi kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kundër
5 organizimit institucional të Kosovës".

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, së pari a vutë re që të shfaqnit ndonjë shenjë
8 parehatie, të bënit ndonjë grimancë në video?

9 PË. Jo.

10 PY. Ato gjërat që thatë në video a janë të vërteta dhe a janë
11 të sakta me aq sa dini dhe besoni ju?

12 PË. Mendoj se -- po më vjen shumë keq që kjo video nuk është
13 e tëra, sepse konferenca ka zgjatë pak më shumë. Edhe kam
14 thënë që mes të tjerash, po tash nuk di a ka efekt me tregu
15 këtu, po nëse mund të sigurohet video që UÇK-ja është në
16 mbrojtje të pragut të shtëpisë, të familjeve tona, të nderit
17 dhe e kam ftu popullin e Kosovës për solidaritet me UÇK-në.

18 Dhe në atë video në konferencë kam ftu NATO-n për me u
19 solidarizu me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës edhe gjena tjera.

20 PY. Në rregull. Megjithatë tek kjo pjesa e videos që sapo
21 pamë bashkërisht, gjërat që thatë në video tek kjo pjesa që ne
22 luajtëm, a janë të gjitha të vërteta dhe të sakta me aq sa
23 dini dhe besoni ju?

24 PË. Mendoj se po. Edhe pse, thashë unë, e kam dhënë këtë
25 paraqitje para gazetarëve, nuk e di, po diku rreth dy orë

1 mbasi jam kthy, jemi kthy nga zonat e luftës, ku kemi pa një
2 terror të tmerrshëm të forcave serbe ndaj popullatës së
3 Drenicës. Dhe gjendja jonë, domethënë, ishte e rëndë,
4 shpirtnore domethënë, shka kemi parë në Drenicë.

5 PY. Në rregull. Është e saktë kjo që ky është një fragment,
6 është një pjesë e konferencës për shtyp. Dhe në një pjesë
7 tjetër të konferencës për shtyp, sikurse e përmenda dhe dje,
8 ju thatë që jeni ndaluar nga policia sekrete e UÇK-së.

9 Domethënë u ndaluar prej policisë sekrete të UÇK-së. Pyetja
10 ime ishte që a kishit ndonjë frikë për familjen në momentin
11 kur ju e përmendët policinë sekrete të UÇK-së në konferencën
12 për shtyp në atëherë?

13 PË. Unë kisha frikë për familjen vetëm nga forcat serbe. Për
14 vete s'kam pasë kurrë frikë as ndaj forcave. Nuk i kam njoft
15 bile që ekzistojnë në Kosovë. [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR] nga forcat serbe.

18 PY. Po. E kuptoj. Dhoma ku e dhatë konferencën për shtyp ose
19 konferencën për gazetarët ishte plot me gazetarë, apo jo?

20 PË. Ishte plot me gazetarë por edhe figura politike.

21 PY. A kishte figura të tjera politike?

22 PË. Po, ka pasë figura dhe të tjera politike.

23 PY. Përveç katër vetëve që ishit të ulur aty në tryezë, a
24 kishte pjesëtarë të tjerë të delegacionit që ishin të
25 pranishëm në sallën ku dhatë konferencën për shtyp?

1 PË. Nuk jam shumë i sigurt, sepse unë jam përqendru për me
2 thanë të vërtetën edhe saktësinë në atë konferencë sepse ishin
3 shumë gazetarë, kishte dhe gazetarë të huaj aty që raportnin
4 për mediat e huaja. Ishte një konferencë me rëndësi, ma vonë
5 mund të kuptohet krejtësisht rëndësia e kësaj konference.

6 Por me thanë të drejtën se disa individëve aty nuk ju ka
7 pëlqy kjo paraqitje e imja.

8 PY. Në videon që sapo pamë i thatë shtypit që UÇK-ja ishte
9 sjellë në mënyrë korrekte?

10 PË. Kjo është shumë e vërtetë. Sikur të mos ishte sjellë
11 korrekte kurrë s'e kisha thënë.

12 PY. Në rregull. A kishte ndonjë gazetar në dhomë që të tha që
13 "Në qoftë se UÇK-ja u soll në mënyrë korrekte, pse shikojmë
14 këtë shenjën në fytyrën e z. Blakaj?" apo "Pse shohim dorën
15 tënde që është e mavijosur?" --

16 PË. Jo --

17 PY. -- jua bëri ndonjë pyetje ndonjë gazetar?

18 PË. Askush s'e ka hap këtë temë, as e ka bërë këtë pyetje.

19 PY. Pra, mesa dini ju asnjë gazetar nuk solli në vëmendjen
20 tuaj asnjë problem që mund të kishte në dukje, asnjë lëndim që
21 mund të kishte në dukje askush prej jush që ishit ulur aty në
22 tryezë nga ju të katërt?

23 PË. Askush. Askush. Asnjë gazetar.

24 PY. Dje bëtë këtë koment dhe dua që t'ju pyes lidhur me të.

25 Ju përfaqësonit në shtyp që UÇK-ja u soll në mënyrë korrekte?

1 PË. Po.

2 PY. A ju kujtohet ose atëherë ose a ju kujtohet tani në qoftë
3 se ju do i kishit kërkuar z. Blakaj që të ulej ngjitur me juve
4 në qoftë se ai do kishte pasur një lëndim dhe në qoftë se ju
5 do thonit që UÇK-ja është sjellë ashtu siç duhet, pra, ishte
6 sjellë në mënyrë korrekte, do ia kishit kërkuar z. Blakaj po
7 të kishte pasur lëndim që të ulej pranë jush?

8 PË. Nuk kam pasë asnjë arsy që me i thënë z. Blakaj mos u ul
9 në konferencë me ne edhe, domethënë, kush ka dasht me u ul,
10 disa kanë shku në shtëpi nuk janë kthy në konferencë. Unë kam
11 pasë përgjegjësi si kryetar i delegacionit me dhanë përgjigje
12 të sakta dhe të vërteta për ngjarjen që në një farë mënyre
13 është stërmadhu për qëllime të ndryshme nga qarqe të ndryshme
14 por kryesisht nga qarqet anti-Kosovë, antishqiptarë

15 PY. Ju e patë videon. Patë edhe pjesë të tjera të videos dje
16 edhe sot e pamë të gjithë bashkë. A kishte z. Blakaj ndonjë
17 lëndim të dukshëm në hundë?

18 PË. Unë s'kam vërejt. Ai ka mujt me pasë ndoshta ndonjë
19 lëndim u rrëzu a. Unë, nëse ka mundësi, këtu kisha kërkuë një
20 gjysë minuti seancë private.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për çfarë
22 arsye po kërkon për seancë private?

23 DËSHMITARI: Për me e sqaru këtë, këtë pyetje. Me e bë një
24 sqarim korrekt.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëni

1 këtë edhe pa seancë private. Kështu që vazhdoni më tej.

2 DËSHMITARI: Unë meqenëse Sokol Blakaj ka ndru jetë dhe e
3 kam pasë mik dhe bashkëpunëtor të ngushtë, nuk kisha dashtë
4 publikisht me thanë atë që muj me thanë privatisht.

5 Por mos harroni -- më fal. Se na kemi qëndru nëpër mal
6 dhe kena lëvizë nëpër mal ku kena mundësi me u gërvisht e me -
7 - domethënë, qito njerëz që kemi jetu në qytet edhe në kushte
8 me shi e baltë, të ndjekun nën bombardime permanente nga
9 forcat serbe dhe kena lëviz nëpër mal.

10 PY. Dëshmitar, thjesht po ju pyes në qoftë se në videon që
11 pamë juve a vutë re apo jo ndonjë lëndim në hundën --

12 PË. Jo.

13 PY. -- e z. Blakaj? Kjo është pyetja.

14 PË. Unë s'kam vu re.

15 PY. Faleminderit.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryesues i seancës, përderisa
17 ia paraqitëm këtë video dëshmitarit, do të kërkoja që të
18 pranohet si provë materiale.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
20 çaktivizuar]

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, nuk kam kundërshtime. Është e
22 njëjta video, e vetmja gjë është që ka titra në anglisht.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova
24 materiale do të pranohet në prova dhe do t'i caktohet një
25 numër.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 12

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
2 këshillohen]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
4 këtë dokument do ta lidhim me një provë materiale që e kemi
5 pranuar më përpara. A ka ndonjë problem për juve në qoftë se
6 bëjmë këtë organizim.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka problem për aq kohë sa
8 pranohet si provë, është në rregull.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 dokumenti DHT01406 deri në DHT01406 do të marrë numrin e
11 provës materiale P321.1.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, dëshiroj që të diskutoj me juve një çështje që
16 u diskutua dhe dje. Bëhet fjalë për fotografinë që ju sollët
17 me vete për intervistën me EULEX-in në 2014. Ju kujtoni,
18 besoj, kur ju patë një shënim që ju tregua nga Prokurorja dhe
19 Prokurorja dhe unë në fakt e diskutova pak edhe më vonë pastaj
20 lidhur me faktin që fytyra juaj, domethënë, ju bëra pyetja
21 nëse fytyra juaj ishte e ënjtur apo jo. A ju kujtohet ky
22 diskutim dje, Dëshmitar?

23 PË. Fytyra ime s'ka qenë e ënjtur. Ka qenë ajo që ka qenë.

24 Edhe kush kurrë në jetën e tij fytyrën time s'e ka prekë në
25 aspektin çfarë po pretendohet këtu. Kurrë njëherë, asnjëherë

1 në jetën time.

2 PY. E kuptoj. Pyetja ime për ju është kjo: Të mendojmë që
3 shkuat në intervistën e EULEX-it me një fotografi tënden me
4 një fytyrë të ënjtur. E di, domethënë, ju thatë që nuk ka
5 ndodhur kjo, megjithatë le ta mendojmë sikur ka ndodhur, po ne
6 tani e dimë që në konferencën për shtyp ju nuk e kishit të
7 ënjtur fytyrën. A pajtoheni me mua që ju keni mbërritur në
8 intervistën e EULEX-it me fotografinë në dorë për të
9 çorientuar hetuesit e EULEX-it lidhur me lëndimet që kishit
10 pësuar në Qirez, në qoftë se kjo do kishte qenë e vërtetë?
11 Domethënë, po flasim në nivel hipotetik, sikur të ishte kjo
12 situatë.

13 PË. Nuk më kujtohet që kam pasë fotografi dhe unë kurrë nuk
14 po i bëj këto fiskultura për të çorientuar asgjë. Mendohem aq
15 sa di dhe sa kam mbajtur mend gjithmonë me thënë të vërtetën.
16 Ato që i harroj, që është krejtësisht normal. 25 vjet
17 përjetimeve tona që për Evropën, për Amerikën janë 2500 vite
18 të vuajtjeve tona, domethënë, nëse i konvertojmë 25 vjet të
19 mënyrës së vuajtjeve tona atëhere ka mundësi shumë gjena edhe
20 t'i kem harru dhe ato dhe mund të krijojnë keqkuptime. Mirëpo
21 kur është në pyetje e vërteta unë nuk i iki asnjëherë për
22 asnjë çmim.

23 PY. A keni pasur ndonjëherë lëndime të krahut?

24 PË. Kam thënë unë, e kam thënë që jam rrëzu dy-tre herë, nuk
25 e kam evidencu se unë s'kam shku atje me shënue sa herë më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç (Vazhdon) Faqe 14
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 shket këmba, sa herë rrëzohna. Kena shku për një mision
2 krejtësisht tjetër që e kam spjegu disa herë që 25 vjet.
3 PY. Do ta bëj më konkretisht pyetjen. A ka pasë ndonjë kohë
4 përpara shtatorit, 20 shtatorit 1998 ose pas 23 shtatorit
5 1998, a keni pasë ndonjë lëndim në krah?

6 PË. [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 PY. [REDAKTUAR]

10 PË. [REDAKTUAR]. Tash ndoshta krejt privatësinë
11 s'kam nevojë me thënë, po unë vetëm sot -- okei.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse është e mundur për çështje
13 mjekësore, për të diskutuar një çështje mjekësore, do kërkoja
14 që të kalonim në seancë private.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
16 çaktivizuar]

17 Për arsye të privatësisë mjekësore të dëshmitarit do të
18 kalojmë në seancë private.

19 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F2133RED

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë private.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
23 vazhdoni.

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Faqe 15

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR] Dhe nuk di.

7 Jo, është me rëndësi të thuhet pastaj kam shku në

8 [REDAKTUAR] me ndihmën e disa miqve, se s'kam pasë mundësi

9 vetë [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 PY. [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]?

13 PË. [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 PY. Po [REDAKTUAR]

21 PË. Po.

22 PY. [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]?

24 PË. Nuk më kujtohet. Shiqo, për nga ana e datave, besoni ose

25 mos besoni është e drejtë e juaj, shumë vështirë e kam problem

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç (Vazhdon) Faqe 16
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 ndoshta edhe nuk i di data as datëlindjet e fëmijëve të mi, se
2 s'kena -- truni jonë është i shkatërrim, shpirti jonë është i
3 shkatërrim nga Serbia.

4 PY. [REDAKTUAR]?

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj në këtë pikë se mendoj
6 që dëshmitari ka dhënë përgjigjen, jepet në faqen 12, tek
7 rreshti 5, duke filluar nga rreshti 5, [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, [REDAKTUAR]

16 ju ka shkaktuar ndonjë enjte në fytyrë? A ju kujtohet kjo?

17 PË. Jo, jo. Nuk më kujtohet. Se unë s'kam pasë enjtje në
18 fytyrë. Unë ndoshta kam qenë atëherë kam qenë më i shëndoshë.

19 Ku di unë tash, nuk e kam -- po unë s'kam pasë kurrfarë as në
20 konferencë kur jam kthi prej zonave të luftës, as një shenjë,

21 as një enjtje në fytyrë siç po e thoni ju. Sepse fytyrën time
22 nëse gjeni një herë në jetë që e ka prek dikush negativisht

23 përveç, domethënë, familja ime, e njerëzit e mi, atëherë unë e
24 kërkoj vullnetarisht burgim të përjetshëm.

25 PY. E kuptojmë. A ju kujtohet në qoftë se janë bërë fotografi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Faqe 17

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 të trupit tuaj [REDAKTUAR]?

2 PË. Nuk më kujtohet unë që kam fotografi, as që janë bë
3 fotografi. Veç më kujtohet saktësisht jam rrëzu. A rrëzimi më
4 i rëndë ka qenë në tualetin kur kam shku në tualet në shkollën
5 Migjeni në Baicë sepse ka qenë tualeti larg nuk ka qenë brenda
6 objektit, në oborr dikund edhe terreni ka qenë shumë i keq.
7 Dhe gjithë natën ka ra shi pa ndal.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, mund të kalojmë
9 në seancë publike.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
11 Sekretare na kaloni përsëri në seancë publike.

12 ~~{Seancë e hapur}~~

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës.
14 jemi në seancë publike.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, tani dëshiroj që t'ju tregoj një fragment nga
17 procesverbali i Partisë Liberale nga një mbledhje e Partisë
18 Liberale, menjëherë pas këtij incidenti të cilën ju ia keni
19 dhënë Prokurorisë në seancën përgatitore.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Për Sekretaren është dokumenti
21 116759 deri në 116753-ET, ky është versioni në anglisht. Në
22 shqip, është dokumenti me të njëjtin numër. Dhe dua të
23 paraqitet faqja 116760.

24 PY. Dëshmitar, këtë ia keni treguar Prokurorisë javën e
25 kaluar. A mund të na thoni ju çfarë është ky dokument?

1 PË. Po. Po më kujtohet, domethënë, na, Partia Liberale e
2 Kosovës kena mbajt kryesisht mbledhje çdo të premte, një herë
3 në javë. Ka ndodh që edhe ditëve të tjera ka ndodh më shpesh
4 simbas situatës. Na s'kemi pasë kushte atje, laptopa, teknik
5 edhe kena mbajt në çdo mbledhje të kryesisë kena mbajt
6 procesverbal, që do të thotë, atë çka kemi fol, diskutu, ka
7 qenë njëni prej nesh i angazhum me shkru krejt çka është fol
8 në mbledhje të kryesisë që me i ruajt ato dhe me i -- unë ato
9 edhe sot e kësaj dite i kam. Edhe i kam ofrue Prokurores së
10 nderuar që nëse ka dëshirë ia sjellë edhe origjinalin.

11 Këtë mbledhje të kryesisë, që ka ndodhë tri-katër ditë, a
12 nuk e di tash saktë, mbasi jemi kthy nga zonat e luftës dhe
13 unë e kam përshkrue vizitën e delegacionit tonë edhe këtu
14 thuhet, domethënë, e vërteta.

15 PY. Në rregull. Kur thoni tri-katër ditë pas vizitës në zonën
16 e luftës e keni fjalën tri-katër ditë pas ngjarjeve në Qirez
17 dhe Baicë, apo jo?

18 PË. Në shtator. Në shtator, domethënë dhe aty shkruan që në
19 shtator a mbajt kjo mbledhje. E na jena kthy dikund më 22 a 23
20 shtator. Shtator 1998.

21 PY. Ky takim ka qenë mbledhja e kryesisë së Partisë Liberale
22 dhe ka qenë takim publik, është mbajtur publikisht?

23 PË. Po, shiqo, në takimet e kryesisë, domethënë, na i kena
24 mbaj të gjithmonë kryesia e partisë. Pastaj kena pasë këshillin
25 kombëtar që kanë qenë ndarë të këshillit kombëtar. Pastaj kena

1 pasë konferenca shtypi. Konferencën e shtypit veç e kisha kry,
2 s'kisha nevojë tash prapë me thirr dy herë konferencë shtypi.
3 E kena mbajt kryesia kena diskutu për këtë.

4 PY. Po jua bëj pyetjen ndryshe. A ka pasë gazetarë të
5 pranishëm në këtë takim?

6 PË. Jo.

7 PY. A ka pasur persona nga publiku i gjerë në këtë takim?

8 PË. Jo, jo. Ato mbledhjet e kryesisë, ju lutem. Dhe kryesia
9 ka debatu për krejt çka ka ndodhë, domethënë, në Drenicë.

10 PY. Mirë. Fillojmë me këto që janë të shkruara këtu, pastaj
11 do ju pyes nëse janë të vërteta. Po shoh në anglisht mesin e
12 paragrafit, paragrafit sipër. Thotë:

13 "Pasi biseduam me personat, pasi kemi bisedu me popull
14 dhe kemi folur për qëllimet humanitare që kishim, ne u
15 prezantuar dhe ata deshën të dinin kush ishim sepse kishin
16 shqetësime, sepse mendonin që ishin kërkuar që të dorëzonin
17 armët. Pasi verifikuan diskutimet që patëm, liruan gazetarët -
18 - dhe është diçka që nuk lexohet ndërsa --

19 PË. Jua lexoj unë, nëse keni nevojë.

20 PY. Patjetër atëherë. Lexojeni ju, ju lutem.

21 PË. Po.

22 "Pasi i kemi kryer bisedat në popull dhe qëllimet
23 humanitare që kishim, jemi legjitimu dhe kanë dashur të dinë
24 se çfarë kemi diskutuar se mos gjoja kemi kërkuar për dorëzim
25 të armëve. Po ashtu, pasi kanë verifikuar diskutimin tonë, i

1 kanë liruar gazetarët dhe femrat, kurse 13 të tjerëve na kanë
2 ndalur, ndaluar, na kanë dërguar në një vend të panjohur për
3 ne, ku janë sjellur në mënyrë dinjitoze". Ajo vazhdon.

4 PY. Në rregull. Pra, ju i keni thënë kryesisë se janë sjellë
5 në mënyrë të përshtatshme, të denjë. Në atë kohë, a ju
6 kujtohet nëse mund të keni pasur mbase frikë t'i tregoni
7 kryesisë ato që kishin ndodhur në të vërtetë në Qirez dhe në
8 Baicë?

9 PË. Nuk është mirë me fol, z. Avokat i nderum, për ne që kemi
10 qenë në atë delegacion edhe unë personalisht na e kena vra
11 frikën në vitin 1991. Ajo nuk ka ekzistuar, nuk ka banu në
12 qënien tonë. Sepse kemi qenë të gatshëm në çdo sekondë me u
13 fliju dhe çdo ditë e kemi vu në tryezë jetën tonë dhe lirinë
14 tonë. Domethënë, në kuptimin kanë mujt me na arrestu kur dojnë
15 forcat e Milosevic. Dhe këtë e kemi dëshmu edhe në demonstrata
16 të gjëra ditore kur forcat serbe më kanë thënë me automatik
17 "Nëse ecën dhe një hap do të gjuajmë", unë e kam ec edhe një
18 hap. Nëse ecën dhe një hap do të gjuajmë, unë ka ec edhe dy
19 hapa.

20 Domethënë, nuk kemi frikë. Frika se nuk është fjalë e
21 madhe me fol tash këto gjëna s'kam dëshirë shumë, po frika nuk
22 ka ekzistuar në qënien tonë, as sot nuk ekziston.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryetar i Trupit
24 Gjykses, kërkoj që ky dokument të pranohet si provë.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 21

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
2 çaktivizuar]

3 Dokumenti me numër 116759 deri në 116753 apo 763?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] 763. Po.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kisha
6 kuptuar sikur ishte 753. Në rregull. Atëhere dhe një herë
7 dokumenti me numër 116763-ET edhe përkthim në gjuhën shqipe
8 pranohen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto materiale marrin
10 numrin e provës materiale 1D62. Gjithashtu, të nderuar
11 Gjykatës, kini parasysht që dokumenti është i klasifikuar si
12 konfidencial. Çfarë duhet të bëjmë me këtë klasifikim?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A duhet të
14 ruajmë të njëjtin klasifikim?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, të paktën nga ana jonë.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] As nga ana jonë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Dokumentet do të riklasifikohet si dokument publik.

19 Vazhdoni.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Dëshmitar, dua të flasim tani lidhur me arsyet pse është
22 dëshmia juaj tashmë e ndryshme krahasuar me dëshminë e
23 shtatorit 1998, atë të vitit 2001, 2014 dhe ditës së sotme.
24 Disa prej arsyeve ju i përmendët, por gjykoj se duhet të
25 flasim pak më thellë lidhur me këto, të paktën sa i takon

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 22

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 motivimit politik që ju e përmendët dhe arsyet për hakmarrje.

2 Ju thatë që kishit një motiv për hakmarrje kur dhatë këto

3 deklarata, pra, kishit një farë hakmarrje kur dhatë këto

4 deklarata, a është e vërtetë kjo?

5 PË. Në bazë të mediave, se mediat në Kosovë, një pjesë e tyre

6 janë në fakt ato që prodhojnë e sajojnë aktakuza e fymje sikur

7 kudo, domethënë dhe në Ballkan posaçërisht. Edhe unë kam pasë

8 rastin e ndalimit tim, kam pasë një hidhnmim që është normal,

9 se unë kam qenë person publik dhe me gjithë zemër, me gjithë

10 shpirt jam angazhue për lirinë e Kosovës. S'e nuk e thashë

11 mendimin.

12 PY. Do ju orientoj te diçka më konkrete.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do kërkoja që të shfaqej

14 në ekran dokumenti 113189-02-TR-ET në gjuhën angleze dhe të

15 njëjtin numër dhe gjuha shqipe.

16 PY. Ky është transkript i një interviste që është dhënë në

17 televizion ku është transmetuar ku është transmetuar dhe

18 videoja juaj. Ju lutem të shkojmë në faqen 11 të dokumentit

19 edhe në shqip edhe në anglisht.

20 Më thanë që ky është versioni që është pranuar nga

21 Prokuroria, po ne na duhet origjinali se ky është një dokument

22 që është tërësisht i redaktuar.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Atëherë ky dokument ishte

24 dokumenti me numrin e provës materiale P321. Edhe materiali

25 tjetër gjendet në listën e prezantimeve. Pra, dua të them që

1 dhe transkripti i paredaktuar gjendet në të njëjtën listë
2 materialesh.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Prokurore.

4 Paragrafi i tretë lart në anglisht edhe paragrafi që i
5 përkon dhe në shqip.

6 PY. Ju i thoni intervistuesit:

7 "Shiqo".

8 Këtu po diskutoni pse keni ndryshime në versionin tuaj të
9 ngjarjeve, ju thoni:

10 "Shiqo. Ajo ka qenë në kontekstin, se tash me hi në
11 histori të gjata të karrierës sime politike, ajo është një
12 histori e veçantë dhe duhet me bë një emision special.

13 "Unë jam ngarkuar si zëvendësministër i infrastrukturës
14 ditën e premte. Ka qenë e premte. Të shtunën jam shkarkuar. Në
15 atë ministri ka pasë hy një kontroll. Nuk e di pse, nuk është
16 temë e imja ajo. Dhe në lajme ka dalë se është shkarkuar
17 zëvendësministri i transportit dhe në këtë ministri filloi me
18 u luftu korrupsioni. Unë kurrë s'kam qenë aty. Ka filluar pa
19 qenë unë aty. Edhe normalisht në një farë mënyre kam dashtë me
20 u revanshu, të hakmerresha. Sepse unë s'kam mujt me përdor
21 Kanunin e Lekë Dukagjinit, por të hakmerresha me fjalë..."

22 A keni thënë kështu në një emision televiziv?

23 PË. Shiqoni. Për me e sqaru pak duhet. Unë jam ngarku nga
24 Presidenti Thaçi, zëvendësministër i transportit të asaj kohe
25 të premtën. Ka qenë ditë e premte. Edhe të shtunën ose të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 24

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 dielën, s'është ajo fort me rëndësi, po pa shku në punë se të
2 hënën fillon puna, jam shkarku. Edhe në media ka dalë se
3 Hashim Thaçi e shkarkoi - një herë e ngarkoi të premtën pastaj
4 i njëjti person, Hashim Thaçi, Presidenti Hashim Thaçi, e
5 shkarkoi zëvendësministrin e transportit Gjergj Dedaj dhe në
6 këtë ministri filloi me u luftu korrupsioni.

7 Unë jo që jam shoku, po nuk di vëlla çka ashtë me mu, e
8 kam ndonjë copë ADN të çeliktë se e ka pasë me lëshu zemra. Pa
9 shku kurrë asnjë sekondë në atë ministri. Dhe unë kam thënë si
10 është e mundshme Presidenti Hashim Thaçi me më ngarku të
11 premtën dhe më shkarku. Këtë e ka bë dikush tjetër, që mund ta
12 them në një seancë private, s'kam dëshirë me laku emra. Por
13 diku, njerëzit e dinë në Kosovë. E ka bë dikush tjetër me na
14 shti në konflikt me Presidentin Thaçi.

15 Po unë gjithmonë e kam mendu deri kur e kam sqaru që e ka
16 bë Presidenti Thaçi. Unë me kanë praktikues i Kanunit, atëherë
17 ka mujt ose me më vra ose me u vra me Hashim Thaçi. Por unë
18 nuk jam unë. Unë kurrë nuk jam, as ai, as unë. Domethënë, na
19 jemi njerëz burrështetas jemi. Edhe, okej, i kam thënë i jap
20 shtatë ditë afat, në publik kam thënë, në media, Presidentit
21 Thaçi që atëherë ishte kryeministër, i kam thënë që me më
22 thirr me më tregu arsyen pse më ka ngarku dhe pse më ka
23 shkarku brenda 24 orëve. Dhe nëse nuk më thirr atëherë ka me
24 kanë keq. E keq domethënë, kisha ndjek rrugë ligjore.

25 Edhe gjithnjë kam mendu se më ka shkarku Hashim Thaçi.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 25

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 Edhe e kam pasë një urrejtje ekstreme nëse kish ndodhë kështu.

2 Se ka mujt me thënë s'ki me shku dhe okej.

3 Edhe kur kam mbas gjashtë ditëve, pesë ditë ose gjashtë
4 ditëve jam taku me Presidentin, kryeministrin e atëhershëm
5 Thaçi, me z. Thaçi, siç i kanë thënë në Washington, George
6 Washington e Kosovës dhe më ka thënë, "Gjergj, nuk të kam
7 shkarku unë". "Si?", "Unë s'të kam shkarku". "Po kush të ka
8 shkarku? Kush më ka shkarku?". Tha "A ke pi kafe na një ditë
9 me dikën". Edhe unë e kam ditë që kam pi kafe me dikën me
10 ftesën e atij, jo me ftesën time edhe atëherë e kam kuptu
11 lojën. Loja ishte me etiketu, me na konfliktu edhe me na
12 dëmtue ne dyve edhe familjet tona edhe ne dyve.

13 Edhe kjo është, domethënë, jo kësaj radhe po me qindra
14 herë kanë në emën të Hashim Thaçi kanë bë njerëzit edhe rreth
15 tij edhe në Kosovë gabime të tilla dhe mujt me thënë kanë bë dhe
16 krime, domethënë, tuj thirr në emën tina pa e ditë ky fare.

17 Dhe kjo atëherë, kam fillu mbas kësaj me rezonun dhe
18 atëherë kam fillu me mbledhë fakte në terren, se unë gjithnjë
19 kam mendu se Hashim Thaçi është kanë kryesori, u ka thënë me
20 na në Qirez, ku ta di unë. Kam mendu ndër dijen time. Edhe mu
21 ka dash shumë kohë e gjatë me u bind që kjo nuk është e
22 vërtetë.

23 PY. E vlerësoj këtë që sapo thatë, po dua që të sqarohemi për
24 këtë deklaratën në ekran, kjo që thoni ju është që keni jeni
25 revanshu me fjalë kundër Hashim Thaçit --

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 26

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 PË. Po.

2 PY. -- përmes këtyre deklarata, pra, duke dhënë këto

3 deklarata --

4 PË. Disa herë.

5 PY. -- dhe me këtë "hakmarrje verbale". Kur thoni "hakmarrje

6 verbale" ju përfshini aty edhe dëshminë që i keni dhënë EULEX-

7 it në vitin 2014?

8 PË. Po, të gjitha. Ça ka ndodhë mbas lufte deri kur e kam

9 kuptu të vërtetën. E mu ka dash shumë kohë. Sepse ju ndoshta

10 ju po harroni se unë jam marrë nja shtatë vite mbas lufte me

11 rivarrimin e anëtarëve të familjes time, me rivarrimet në

12 Kosovë. I kemi edhe nja 1700 të zhdukun a s'di sa janë

13 saktësisht se s'na kanë ardhë kurrë. Jena kanë edhe të hidhnum

14 edhe në drejtësinë ndërkombëtare se nuk i kanë zbardhë

15 masakrat në Gjakovë, në Mejë, në Drenicë, në burgun e

16 Dobravës. Nuk janë zbardhë. Nuk janë dënu. Kriminelët serbë

17 sot jetojnë shllirshëm.

18 E kam pru një çantë dokumenta me fakte kriminelë serbë në

19 Gjakovë dhe i kam paraqit me i depunu këtu, më kanë thënë nuk

20 na interesojnë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryetar i Trupit

22 Gjykues, do kërkoja që edhe ky transkript të pranohet si provë

23 dhe ma merr mendja që është e njëjta procedurë do lidhet me

24 provën që është pranuar nga Prokuroria dhe sigurisht që do

25 kërkoja që të ishte pjesa e paredaktuar, versioni i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 27

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 paredaktuar.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Transkripti
4 në versionin e paredaktuar pranohet si provë dhe do të marrë
5 numrin e provës materiale për Mbrojtjen.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky transkript lidhet me
7 provën materiale P321.1 e cila është pranuar më herët. Atëherë
8 këtij transkripti do t'i japim numrin e provës materiale
9 P321.1_ET për anglishten edhe _AT për shqipen.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. MISETIC: [Përkthim]

12 PY. Ju ia keni dhënë në fakt këtë informacion ZPS-së kur i
13 keni dhënë intervistë?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për këtë do kërkoja që të
15 shfaqej në ekran intervista e ZPS-së me numër 049784-TR-ET
16 Pjesa 1 e Rishikuar, faqja 14, rreshtat 12 deri në 23. Ndërsa
17 shqipja ka të njëjtin numër, thjesht, që është faqja 16 në
18 fillim të rreshtit 5 dhe pastaj vijon në faqen 17.

19 PY. Në fillim, fillojmë në rreshtin 12 me anglishten, besoj
20 se është rreshti 5, te shqipja.

21 "Kam dhënë një deklaratë në 2011 për koalicionin. Kam
22 thënë në mënyrë të padrejtë që Hashim Thaçi më ka torturuar.
23 Nuk është e vërtetë. Sepse Hashim Thaçi nuk më ka torturu, ai
24 nuk është korrekt. Domethënë sepse nuk më ka torturu, sikur të
25 më kishte torturu Hashim Thaçi edhe të kisha kanë pa maskë me

1 kush më ka torturu, me çfarëdo çmimi kisha thënë se po. Janë
2 thënë shumë gjëra, shumë deklarata mes konferencës së shtypit
3 dhe asaj çfarë thamë sot. Kanë qenë deklarata më shumë të
4 fushatave, të situatave ton apolitike, dua të distancohem nga
5 ato që kam thënë në atë program sepse kam qenë në gjendje të
6 rëndë shpirtërore”.

7 A ia keni thënë këtë ZPS-së?

8 PË. Po. Vetëm prapë e ngre si vërejtje timen që asnjëherë
9 gjatë këtyne intervistave as nuk kam pasë avokat, as
10 këshilltar, as me u këshillu me dikënd, domethënë, s’kam pasë
11 ide edhe këto kanë qenë fjalë shpesh herë që i kam gjuajt. Po
12 në letrën e vitit të kalum, nëntorit 2022, unë kam bërë një
13 letër këtyne Dhomave të respektume, domethënë, që unë
14 distancohna edhe mënyra pse, në fakt arsye pse jam distancu
15 sepse këto kanë qenë deklarata të dhëna për hakmarrje, revansh
16 në gjendje të rëndë. Shpesh gjënat i kam harru domethënë.

17 Edhe kur kam rezonë dhe jam ul dhe kam mbledhë fakte dhe
18 u thashë kam shku edhe në Qirez, kam shku edhe në Drenicë. Kam
19 shku edhe gjithandej Kosovës me dit kush kanë qenë ata
20 huligan, ata katër, pesë huligan. Edhe e kam marrë në
21 përfundim se kam deklarata të pamatura të panevojshme,
22 ekzagjeruara.

23 PY. Përmendët letrën që i keni dërguar Prokurorisë në 2022.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund ta vendosim në ekran. Është
25 prova materiale me numrin 108 -- jo ju kërkoj ndjesë me ERN

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 29

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 108990 E Redaktuar. E njëjta gjë edhe në shqip.

2 PY. Dëshmitar, për këtë letër e keni fjalën?

3 PË. Për këtë letër e kam fjalën që e kam dërgue me postë nga

4 [REDAKTUAR], në nëntorin e vitit të kalum.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen 2 të këtij dokumenti.

6 Shkojmë drejt fundit të faqes.

7 PY. Keni shkruar:

8 "Prandaj, distancohem nga deklaratat e mia të mëhershme
9 të dhënë në EULEX-s dhe në ZPS-së dhe nga disa nga prononcimet
10 publike në mënyrë të padrejtë dhe të ekzagjeruar kam akuzuar
11 disa nga tashmë të akuzuarit e Gjykatës Speciale. Motivi im
12 ishte inati dhe hakmarrja politike, revanshi elektoral".

13 Më pas shkruani në paragrafin e radhës:

14 "Këtë letër ua shkruaj me vullnet të plotë, me
15 përgjegjësi të plotë qytetare dhe juridike pas asnjë joshje,
16 nxitje apo kërcënim nga askush dhe asgjë tjetër".

17 A pasqyrohet këtu saktësisht, pra, a është pasqyruar
18 saktësisht ajo që i keni dërguar ZPS-së në vitin 2022 në këtë
19 letër?

20 PË. 100 për qind. Dhe për këtë letër mbaj përgjegjësi
21 personale çfarëdo lloj përgjegjësie. Pa asnjë nxitje asnji,
22 vetë e kam shkru. Më ka dalë më ka buru nga zemra jeme. Se kam
23 dashtë 1000 me ekzpodu. Domethënë, unë që 25 vjet nuk baj
24 gjumë të rehatshëm. Posaçërisht pas lufte kur më janë vra
25 njerëzit e të gjithë Kosovës. Se unë kam mujt me jetu në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 30

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 Florida e Kaliforni ku të kisha dashtë në botë. Po unë kam
2 dashtë jetën time me ja kushtu Kosovës dhe kam qëndru në
3 Kosovë para lufte, gjatë lufte, pas lufte. Nuk jam dezertor
4 dhe nuk jam azilant që kanë ardhë me aviona janë bë tash
5 ministra e Presidente.

6 PY. Faleminderit.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryetar i Trupit

8 Gjykues, kërkoj që ky dokument të pranohet si provë.

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me
11 numër 1989987-TR-ET pranohet.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Më duket se ka disa informacione
14 aty që ishin, u diskutuan në seancë private që gjykoj se duhen
15 redaktuar. Përveç kësaj pjesës s'kam ndonjë kundërshtim
16 tjetër.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Patjetër. Pasi të mbarojmë seancën
18 mund të diskutojmë lidhur me redaktimet e pjesës që u diskutua
19 në seancë private.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
21 çaktivizuar]

22 Z. MISETIC: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, ju i keni thënë gjëra të ngjashme Prokurorisë
24 në seancën përgatitore që e patët javën e kaluar, kështu?

25 PË. Po.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim shënimin përgatitor, 116768
2 deri në 116787.

3 PY. Shohim paragrafin 3 thuhet që dëshmitari thotë se:

4 "E vërteta e asaj që ka ndodhur në incidentin e shtatorit
5 1998 është pikërisht ajo që është pasqyruar në deklaratën që i
6 ka thënë konferencës së gazetarëve ditën që është kthyer në
7 Prishtinë dhe atë që i ka dhënë më vonë Zërit të Amerikës".

8 A është e vërtetë kështu i keni thënë Prokurorisë?

9 PË. Po. Dhe kjo është e vërtetë gjithmonë.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mund t'ia
12 lexoj të gjithë shënimin përgatitor nëse është nevoja por për
13 hir të kohës së kufizuar, thjesht propozoj për momentin që ky
14 dokument të pranohet si provë materiale.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam asnjë kundërshtim. Thjesht
16 të shohim njëherë klasifikimin mbase është diçka që duhet ta
17 konsiderojmë së bashku.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Dokumenti, pra, shënimi përgatitor me numër 116768-116787
20 pranohet.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
22 kjo merr numrin e provës materiale 1D64.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 PY. Ju e bëtë këtë deklaratë në konferencën për gazetarët më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 32

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 23 shtator dhe më pas për partinë një a dy ditë më pas dhe
2 thatë që UÇK-ja na trajtoi në mënyrë korrekte dhe vetëm më 3
3 shtator 2001, ju ngritët për herë të parë akuza sa i takon
4 faktit që ishit keqtrajtuar në Qirez dhe në Baicë nga UÇK-ja,
5 kështu?

6 PË. I tregova një qind herë arsyet, domethënë, nga mllefi,
7 nga inatet, revanshet, gjendja jeme personale që nuk muj me
8 spjegu edhe me ndejt një muaj ditë tu fol para jush. As nuk
9 mundet besa edhe me u kuptu edhe me u besu nga ju, domethënë,
10 edhe kam dashtë në një fazë kam mëndu, kam mëndu, në bazë
11 media, në bazë të propagandës, në bazë të çka është fol zi e
12 terr nga individë për UÇK-në kam mëndu se mos Hashim Thaçi
13 është fajtor. Kur jam bind ma vonë atëherë e kam thënë të
14 vërtetën. A e vërteta është ajo ditë kur --

15 PY. Dëshmitar, e kuptova, por duam të përcaktojmë faktin
16 këtu. Pra, para shtatorit 2001 nuk e kishe kontaktuar
17 ndonjëherë organet ligjzbatuese dhe nuk kishe ngritur
18 ndonjëherë akuza që ishe keqtrajtuar,--

19 PË. Jo, unë --

20 PY. -- në Baicë a në Qirez, a është kështu?

21 PË. Unë kurrë në jetën time s'kam lyp me shku te kurrë një
22 organ me e bë ndonjë akuzë a ndonjë kallëzim penal. Kurrë në
23 jetën time deri sot. Domethënë edhe ata më kanë thirr, pa
24 avokat, pa këshillë juridik.

25 PY. Do ta riformuloj pyetjen. Do ta bëj pyetjen ndryshe. Para

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 33

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 datës 3 shtator 2001, ju asnjëherë nuk kishit bërë ndonjë
2 deklaratë, nuk kishit deponuar ndonjë akuzë për institucionet
3 e zbatimit të ligjit që ju ishit keqtrajtuar në Qirez dhe në
4 Baicë, a është kështu?

5 PË. Nuk më kujtohet. Nuk besoj.

6 PY. Tani të shohim pak kronologjinë e deklaratës që keni
7 dhënë në 2001.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
9 paraqesë në ekran dokumentin SITF00055783 deri në 00055996,
10 konkretisht faqen SITF0005803. Nuk kemi përkthim të plotë në
11 shqip. Kemi vetëm një përkthim të pjesëshëm që fillon në 034126
12 deri në 034127.

13 PY. Dëshmitar, ky është shënimi i hetimit të UNMIK-ut në
14 fillim të hetimit sa i takon këtyre ngjarjeve, këtij
15 incidenti. UNMIK-u raporton që u vu në dijeni për herë të parë
16 më datën 1 shtator të 2001 sa i takon pretendimeve për
17 keqtrajtim të delegacionit tuaj dhe që ishte informuar nga
18 informatorë konfidencialë që kishin dhënë informacion në
19 lidhje me rrëmbimin dhe torturimin e disa shqiptarëve në
20 shtator të 1998. Oficeri i UNMIK-ut, atij i është thënë që një
21 prej emrave të viktimave ka qenë Gjergj Dedaj që ishte
22 udhëheqësi i PLK-së, i partisë politike PLK.

23 Pa nxjerrë emra, a e dini ju se kush ishte ky burim
24 anonim, kush e ka dhënë këtë informacion?

25 PË. Jo. Ka mujt me kanë serb. Ka mujt me kanë shqiptar. Nuk

1 muj me ditë.

2 PY. Nëse do të shkojmë tek pjesa tjetër 3 shtatori i 2001,
3 këtu thuhet që është regjistruar që ata janë takuar me ju dhe
4 tek pjesa e theksuar me ngjyrë të verdhë thuhet:

5 "Gjergj Dedaj tregoi se ishte rrahur dhe burgosur në
6 mënyrë të paligjshme nga UÇK-ja më 20 shtator 1998 dy net
7 bashkë me disa viktime të tjera dhe pastaj ishte liruar. Ai
8 shpjegoi se kishte udhëhequr një delegacion në atë fshat në
9 një mision humanitar dhe pastaj ishte burgosur në mënyrë të
10 paligjshme nga UÇK-ja".

11 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

12 PË. Po, po e shikoj.

13 PY. A ju kujtohet ky takim i parë me hetuesit e UNMIK-ut?

14 PË. Me thanë të drejtën ky është 2001, 22 vjet dhe është
15 vështirë me mu kujtu krejt detalet ose detalet. Mirëpo këtë
16 çështjen e Qirezit dhe të Baicës unë e kam sqaru saktë në
17 konferencë për shtyp, në Zërit të Amerikës, në mbledhje të
18 kryesisë dhe para Trupit të nderum, para kësaj Dhome të
19 nderume po e them. Kjo është e vërteta.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Të kalojmë në
21 versionin në anglisht tek faqja tjetër.

22 PY. Aty thuhet:

23 "Më tej, Dedaj i dha hetuesve një listë të emrave të
24 viktimave dhe dëshmitarëve ku shpjegohej se kush kishin qenë
25 të pranishëm, kishte disa emra aty në listë. Dhe ky ishte

1 delegacioni që kishte shkuar në vizitën humanitare për të parë
2 mirëqenien e shqiptarëve në zonë. Më pas Dedaj rrethoi numrat"
3 dhe ka një listë numrash.

4 "Dhe tha që këtyre njerëzve ju tha UÇK-ja që të mos
5 largoheshin. Më pas Dedaj vendosi shenjën '+' pranë gjashtë
6 emrave dhe Dedaj i tha hetuesve që këta ishin personat që
7 ishin rrahur nga UÇK-ja përfshirë dhe veten. Dedaj përmendi se
8 përmendet që personat që e rrahën ishin të maskuar, ndërkohë
9 që Hashim Thaçi, Rexhep Selimi dhe Sabit Geci e hapnin herë
10 pas here derën e dhomës ku ishin brenda".

11 A ju kujtohet kjo bisedë, Dëshmitar?

12 PË. Më shumë një film, një tregim për një film. Domethënë,
13 unë e kam shpjegu çka ka ndodhë.

14 PY. Po ju pyes në qoftë se ju kujtohet apo jo biseda siç e
15 lexova, po apo jo?

16 PË. Këto nuk më kujtohen mu. Shiqo. Unë njëmijë herë mund ta
17 shpjegoj, por kur janë me shkrim këto unë s'kam po ja që unë
18 nuk më kujtohen shka kam bisedu pa avokat, pa këshilltar
19 juridik.

20 PY. Në rregull. Dua t'ju kërkoj që të na ndihmoni, sepse
21 hetuesi thotë që keni qenë në takim dhe kishit një listë të
22 përgatitur, pra, lista ishte përgatitur për takimin.

23 PË. Asnjë s'kam pasë unë të përgatitun. Unë i kam pasë ato ça
24 ka mbajt mend ato ça kam dashet me i thënë edhe e kam spjegu
25 që e kam thënë për me u revanshu. Edhe në atë moment, në atë

- 1 kohë, në atë periudhë kam dash me ju revanshu. Unë s'kam
2 dashtë me përdorë Kanunin as kam mujt as nuk e përdori --
3 PY. Dëshmitar --
4 PË. -- po e vetmja gjë ka qenë goja që kam dashtë me
5 revanshu.
6 PY. E kuptoj, Dëshmitar. Hetuesit këtu kanë shënuar që ju i
7 keni dhënë atyre një listë të viktimave dhe të dëshmitarëve që
8 e kishit shkruar ju. Pyetja që kam për ju është që nga e dinit
9 ju që hetuesit dëshironin që të diskutonin Qirezin dhe Baicën
10 dhe ju si ndodhi që keni shkruar i përgatitur për këtë takim,
11 nga e dinit se ç'a do diskutoje në takim?
12 PË. Unë atë listë kam mujt me shkru aty për aty, domethënë,
13 se unë e di kush ka qenë në delegacion. Edhe ka mujt me ia
14 dhënë, domethënë, atë listë. Por mu kur më kanë thirr, sa më
15 kujtohet mu, nuk jam prezantu si policia ose diçka. Më kanë
16 thënë jena nga UNCHR-i a s'di çfarë një organizatë a mujna me
17 ardhë me ju vizitu? Kam thënë "Po". Ka qenë zyra hapur për
18 secilin, për gjithkënd.
19 PY. Ju i dhatë këto emra dhe kur i dhatë këto emra a keni
20 disku me ndonjë nga këto personat emrat e të cilëve kishit
21 shënuar aty?
22 PË. Jo.
23 PY. A i keni pyetur ata, keni diskutuar me ta?
24 PË. Jo.
25 PY. Pra, ja u dhatë emrat e tyre UNMIK-ut pa i pyetur fare

1 ata në qoftë se ata donin që të ishin --

2 PË. Po shiqo.

3 PY. -- pjesë e një hetimi penal apo jo?

4 PË. Ndoshta kam bërë të padrejtë ndaj tyne, por nuk kam pasë
5 kohë as mundësi as më kanë përgatitë ata me më tregue për
6 shembull, për agjendën për qëllimin e asaj vizite. Ka qenë
7 vizitë e paparalajmërume dhe e befasishme e tyne pa avokat, pa
8 këshilltar juridik.

9 PY. Ta vendosim pak në kontekst këtë. Kjo po ndodh ose po
10 ndodhte në atë kohë kur po bëheshin, po bëhej regjistrimi i
11 votuesve për zgjedhjet e parakohshme të 2001, kështu?

12 PË. Pas, ishte Këshilli Tranzitor, ku isha dhe anëtar i
13 Këshillit Tranzitor. Aty ka qenë edhe Presidenti Thaçi,
14 anëtar, Presidenti Rugova edhe të gjithë kryetarët e partive
15 politike ka qenë një farë forme parlamenti i Kosovës pa
16 zgjedhje Këshilli Tranzitor i Kosovës. Edhe këshilli i
17 përkohshëm administrativ se ka qenë qeveria atëhershme.

18 PY. po. Pyetja ime është e thjeshtë në fakt. Po mbaheshin
19 zgjedhjet në Kosovë, pra, bëhet fjalë për zgjedhjet e para
20 parlamentare në nëntor 2001 --

21 PË. Më duket 2002.

22 PY. -- kështu?

23 PË. Nuk e di saktë kur janë mbajtur zgjedhjet, po ndoshta në
24 fund të -- domethënë, mbas përfundimit të Këshillit Tranzitor,
25 janë mbajtur zgjedhjet e para në Kosovë. Nuk e di datën e saktë.

1 PY. Unë po ju them që zgjedhjet janë organizuar në nëntor të
2 2001. Dhe këto intervista përsëri kanë ndodhur gjatë periudhës
3 së zgjedhjeve, gjatë periudhës së fushatave zgjedhore më
4 saktë. Ju keni qenë kandidat për zgjedhjet parlamentare të
5 nëntorit 2001, kështu?

6 PË. Nuk më kujtohet që kam marrë pjesë, ndoshta kam qenë
7 kandidat. Nuk e di. Nuk jam i sigurt. Nuk du të spekuloj.

8 PY. Në rregull. Nuk ju kujtohet --

9 PË. Jo.

10 PY. -- që keni marrë pjesë për zgjedhjet e para parlamentare
11 që keni qenë kandidat --

12 PË. Në atë kohë ndoshta kam përjetu ndoshta në vitin 2001

13 PY. -- për zgjedhjet e para parlamentare në Kosovë?

14 PË. -- për shkak të forcave serbe është krejtësisht normale
15 mos mu kujtu. 100 për qind normale

16 PY. A ju kujtohet se edhe z. Devaja ka marrë pjesë në
17 zgjedhjet parlamentare të 2001 për PSHDK-në?

18 PË. Me thanë të drejtën unë --

19 PY. Partia Kristian-Demokrate.

20 PË. -- s'po kujtohna për veti atëherë s'kam kurrfarë mundësie
21 me u kujtu për të tjerët kush ka marrë pjesë dhe kush s'ka
22 marrë pjesë. Jua them shumë sinqerisht.

23 PY. Në rregull. A ju kujtohet në qoftë se partia e z. Devaja
24 që ishte Partia Kristian-Demokrate, a ka qenë e ngushtë ajo me
25 partinë tuaj politike?

1 PË. Po kena pasë raporte të shkëlqyeshme me Partinë Shqiptare
2 Demokristiane sepse edhe ajo është themelu në Gjakovë më 4
3 nëntor të vitit 1990. Unë kam marrë pjesë në kuvendin
4 themelues të kësaj partie. Edhe Partia Liberale e Kosovës
5 është themelu po ashtu në Gjakovë. Domethënë, jena ajo pjesa
6 elektoratit demokristian dhe liberal kryesisht vijmë nga
7 Gjakova, Klina, Prizreni, nga pjesa e Dukagjinit. Ma vonë jena
8 shtri dhe në Drenicë dhe në llap dhe në pjesë tjera të
9 Kosovës.

10 PY. Nëse do të vazhdojmë me të njëjtin dokument me shënimet
11 hetuese të EULEX-it vazhdojmë te pjesa tjetër, ata kanë
12 intervistuar z. Devaja të njëjtën ditë që ju kanë intervistuar
13 dhe juve. A ju kujtohet a e keni parë z. Devaja të njëjtën
14 ditë?

15 PË. Jo. As nuk po di. Tash po dëgjoj për herë të parë prej
16 jush.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Të vazhdojmë tek tjetra pjesë e
18 këtij shënimi. Të shkojmë te data 4 shtator, ju lutem. Të
19 shkojmë te dokument SITF0055806. Po.

20 PY. Më datë 4 shtator kanë intervistuar dhe Agim Krasniqin, a
21 është e saktë kjo? A keni njohuri që z. Agim Krasniqi është
22 intervistuar gjithashtu si pjesë e këtij procesi?

23 PË. Kurrë. Domethënë, nuk kam si me pasë njohuri se unë nuk e
24 kam ditë kën e interviston. Unë flas vetëm për Gjergj Dedajn.
25 Dhe marrë përgjegjësi vetëm për Gjergj Dedajn. Është e

1 padrejtë me spekulim me emra tjerë.

2 PY. Në rregull. Nuk po ju kërkoj që të spekuloni. Por a e
3 dini nëse Agim Krasniqi ka qenë anëtar i LDK-së që po ashtu
4 merrte pjesë në zgjedhjet parlamentare të 2001 si kandidat?

5 PË. E di që ka qenë anëtar i LDK-së, zyrtar i LDK-së edhe nuk
6 më kujtohet a ka marrë pjesë në zgjedhje. Jua them shumë
7 singerisht. Domethënë, nuk jam i sigurtë.

8 PY. Të kalojmë tek faqja tjetër. Të njëjtën ditë janë takuar
9 prapë me ju dhe atë ditë ju i keni dorëzuar një deklaratë të
10 shkruar me shkrim së bashku me këto provat materiale. A ju
11 kujtohet kjo ditë, Dëshmitar?

12 PË. Ajo ditë nuk më kujtohet, por ajo ngjarje ka ndodhë. A
13 data, ora, vështirë me mu kujtu.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër

15 PY. Më datën 10 shtator, hetuesit janë takuar me Mehdi
16 Bardhin dhe Mehdi Bardhi më pas u dha atyre informacion. A
17 jeni në dijeni të faktit që Mehdi Bardhi ka qenë pjesë e LDK-
18 së, anëtar i LDK-së?

19 PË. Po, Mehdi Bardhi ka qenë pjesë e LDK-së. Dhe sa më
20 kujtohet mu ka qenë nënkryetar i degës së Lidhjes Demokratike
21 të Kosovës për Drenas, siç e quajnë në Gllogovc.

22 PY. A e dini se pas zgjedhjeve parlamentare, Mehdi Bardhi u
23 bë deputet i Kuvendit të Kosovës për periudhën 2001-2004?

24 PË. Më duket që është ba. Nuk muj me thanë saktë, se s'kam
25 mbajtur ato evidenca.

1 PY. Në rregull.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër.

3 PY. Shohim shënimin që është mbajtur për datën 15 shtator.

4 Këtu thuhet që ata janë takuar me Sokol Blakajn. Sokol
5 Blakaj ishte sekretar i përgjithshëm i partisë tuaj politike,
6 kështu?

7 PË. Po.

8 PY. A është e drejtë të thuhet se në këtë kohë të gjithë ju
9 ishit oponentë, e kam fjalën oponentë politikë të partisë
10 politike të z. Thaçi, PDK-së?

11 PË. Po. Ishim kundërshtarë.

12 PY. Ishit kundërshtarë të z. Thaçi që nga koha e Qeverisë së
13 Përkohshme të Kosovës, domethënë, që prej shfaqjes së saj, apo
14 jo?

15 PË. Domethënë, politikisht ishim kundërshtarë.

16 PY. Po politikisht e kam fjalën. Po. Dëshiroj t'ju bëj disa
17 pyetje lidhur me këtë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
19 paraqesë në ekran dokumentin DHT026797 deri në DHT02706 në
20 faqen 3 në anglisht dhe numri për versionin në shqip është i
21 njëjti për dokumentin.

22 PY. Ky është një raport i datës 17 gusht 1998 nga Radio Free
23 Evrope.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të kalonim
25 në faqen 3.

1 PY. Tek pjesa që fillon:

2 "Ligjvënësit e Kosovës duan që të mblidhet parlamenti, që
3 të takohet parlamenti".

4 Në raport thuhet:

5 "Gjergj Dedaj, i cili kryeson Partinë Liberale të Kosovës
6 i tha radios Evropa e Lirë, më 9 gusht, se ai kërkon një
7 mbledhje të parlamentit shtetëror në hije. Dedaj tha se ishte
8 e pamundur të mbahen seanca parlamentare në Kosovë gjatë
9 luftës, por forcat serbe tani kanë ikur dhe ligjvënësit duhet
10 të takohen. Ai argumenton se ligjvënësit e shteteve hije kanë
11 ende një mandat nga elektorati dhe se është e vështirë të
12 kuptohet pse parlamenti mbetet i papunë në një kohë kur
13 organet e tjera janë të përfshira në përpjekjet për të
14 rindërtuar Kosovën dhe institucionet e saj. Ai theksoi se
15 parlamenti dhe Presidenti i shtetit hije, Ibrahim Rugova kanë
16 të drejtë të përfaqësojnë elektoratin deri në zgjedhjet e
17 reja".

18 A pasqyron kjo qartë pozicionin tuaj politik në gusht të
19 vitit 1999?

20 PË. Unë kam qenë ithtar që dhe qeveria e Kosovës e atëhershme
21 e ashtuquajtur, domethënë, sepse nuk s'e kena mbajtur seanca të
22 kuvendit me zgjedhje qeverinë, me vepru në Kosovë edhe çdo
23 politikan që don me u marrë me çështjen e Kosovës me qenë në
24 Kosovë. Edhe kam qenë ithtar që edhe Kuvendi i Kosovës i
25 atëhershëm edhe pse ka qenë i hendikepim se një pjesë e madhe

1 e Kosovës nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje për shkak të dhunës
2 serbe dhe situatës në teren e domethënë, me kry punën e vet së
3 pakti me dalë me ndonjë mbledhje, me ndonjë deklaratë. Mirëpo
4 ata kurrë s'janë taku. Edhe këtu kanë qenë edhe muj me thënë
5 plasaritjet e para mes meje dhe Lidhjes Demokratike të
6 Kosovës, kanë fillu plasaritjet.

7 PY. Në rregull. Megjithatë çështja që dua të ngre unë është
8 që ju ishit një person që besonit që qeveria e Kosovës duhet
9 që të ishin personat të cilët ishin zgjedhur në 1998, ndryshe
10 nga z. Thaçi dhe nga --

11 PË. Për me qenë --

12 PY. -- forcat të tjera të cilët sipas jush nuk kishin
13 legjitimitetin zgjedhor --

14 PË. -- i singertë --

15 PY. -- a është e saktë kjo?

16 PË. Megjenëse Presidenti Thaçi është në këtë dhomë edhe unë
17 jam në këtë dhomë, unë mbasi është formu Qeveria e Përkohshme,
18 si nënkryetar i kuvendit të Kosovës e kam vizitu Presidentin
19 Thaçi dhe i kam thënë deri në zgjedhjet e ardhshme është mirë
20 Qeveria e Përkohshme me e njoft Kuvendin e Kosovës dhe me e
21 njoftë Presidentin e Kosovës. Parlamentit i kam thënë është
22 mirë me e njoft Qeverinë e përkohshme të Presidentit Thaçi
23 edhe Presidentit Rugova i kam thënë edhe kam bë përpjekje me i
24 afriu.

25 Krejt rolin në jetën time ka qenë afrimi, pajtimi i

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 44

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 njerëzve, domethënë edhe me i afër edhe me u përgatit vendi
2 për zgjedhje se zgjedhjet janë instrumenti i vetëm i
3 demokracisë që prodhojnë disa institucione, qeverinë,
4 parlamentin, Presidentin edhe kështu ka mëndu. Kjo është e
5 vërtetë 100 për qind.

6 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Z. Kryetar kërkoj që ky dokument
7 të pranohet në provë materiale.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
9 çaktivizuar]

10 Dokumenti 55783. Kërkoni që të regjistrohet si provë kjo
11 apo jo?

12 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Po, edhe këtë. Por do i kthehem
13 përsëri këtij dokumenti. Megjithatë mund të regjistrohet tani
14 si provë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Dokumenti DHT02697 deri në 02706 pranohet si provë dhe do
17 t'i caktohet një numër.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
19 të marrë numrin e provës materiale 1D65.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 kërkoni që të regjistrohet si provë materiale dokumenti tjetër
22 kur ta shikoni të përshtatshme.

23 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Tani dua që të shohim një tjetër
24 artikull, që është dokumenti DHT02707 deri në DHT02714 në
25 faqet 2 dhe 3.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 45

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 Fillon tek kjo pjesa:

2 "A do të shtrij më tej këshillin tranzitor Kouchner"

3 PY. Ky është një tjetër raport ose artikull dhe thotë që:

4 "Koha Ditore raportoi më 4 shtator si përfaqësuesi

5 special i OKB-së Bernard Kouchner po planifikon të zgjerojë

6 Këshillin Tranzitor të Kosovës. Plani parashikon përfshirjen e

7 partive më të vogla politike që përfaqësohen në parlamentin e

8 shtetit hije. Veç kësaj, Kouchner do të shtoj Bardhyl Mahmutin

9 e Partisë Bashkimi Demokratik të sapo themeluar dhe Bujar

10 Bukoshin i cili është kryeministër i shtetit hije.

11 "Por Gjergj Dedaj nga partia liberale e Kosovës, i cili

12 është ankuar vazhdimisht për përjashtimin e tij nga këshilli i

13 tha radios Evropa e Lirë 'Unë nuk kam informacion për një

14 zgjerim të mundshëm të këshillit kalimtar. Megjithatë,

15 shpresoj që kjo të ndodhë sepse vetëm anëtarët tanë mund të

16 përfaqësojnë liberalët, asnjë parti tjetër nuk mund ta bëjë

17 një gjë të tillë'".

18 A ju kujtohet në shtator të 1999 që jeni ankuar për

19 përjashtimin e partisë tuaj nga Këshilli Tranzitor?

20 PË. Po. Kam pasë takim me z. Bernard Kouchner dhe kam shprehë

21 revoltën time për mospërfshirjen e partisë liberale të Kosovës

22 e cila në marrëdhëniet ndërkombëtare nga viti 1991 deri në

23 vitin 1999 ishte kampion, ishte partia numër 1 në Kosovë.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që edhe ky dokument të

25 pranohet si provë materiale.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 46

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
3 ka kundërshtim, kërkoj që dokumentit DHT02702 deri në DHT02714
4 të pranohet si provë materiale.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky
6 do marrë numrin e provës materiale 1D66.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Besoj që e kujtoni, Dëshmitar, që unë ndalova së lexuari
9 shënimin hetimor të UNMIK-ut më datë 15 shtator me intervistën
10 e z. Blakaj për hetuesit e UNMIK-ut. Pastaj pas pesëditësh dhe
11 pas dy javëve kur jeni ju dhe kolegët e tjerë tuajt është
12 shkruar një artikull të cilin unë dëshiroj që t'jua tregoj
13 tani.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Për Sekretaren është dokumenti
15 SITF00055783 deri në 00055996, faqja konkrete është
16 SITF00055858 deri në 860. Ndërkohë versioni në shqip 5562,
17 mendoj që është 63 në fakt. Edhe njëherë për të qenë të qartë
18 versioni në shqip 55862.

19 PY. Së pari, ky është një artikull i cili është botuar në
20 Bota Sot më datë 20 shtator 2001, pak javë pasi filloi hetimi
21 i UNMIK-ut. Bota Sot njihet që është një botim që ka qenë
22 pranë LDK-së, a është e drejtë që të thuhet kjo?

23 PË. Me të thënë të drejtën me ëndje s'kisha dashe me komentue
24 shkrimet e gazetës Bota Sot. Domethënë, ndoshta një seancë
25 private kisha mujt po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 47

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 PY. Nuk është e nevojshme. Ju e shihni që titulli i
2 artikullit është 'Hashim Thaçi ka urdhëruar, ndërkaq Sabit
3 Geci ka zbatuar urdhrin: 'Arrestoheni delegacionin nga
4 Prishtina'".

5 Ky është një artikull i cili del në një fushatë,
6 domethënë, në një periudhë fushate zgjedhore për zgjedhjet
7 parlamentare. A pajtoheni me mua?

8 PË. Po, po. Ishte një fushatë hakmarrjeje gjithandej se ishte
9 lufta për terren politik, tash për pushtet. Edhe kjo ishte e
10 paskrupullt, e papërvojë, pa përvojë në demokraci. 1000 vjet
11 ishim të robnum.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
13 lutem vetëm thjesht përgjigjuni pyetjes.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, artikulli citon burime anonime. A keni qenë ju
16 një prej burimeve të informacionit për këtë artikull?

17 PË. Jo, unë s'bëj kurrë, nuk jam kurrë deklarata anonime.
18 S'kam arsy. Nuk njifna, domethënë, si anonimus.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse do shkojmë tek fleta, tek
20 faqja e fundit në versionin në anglisht.

21 PY. Në artikull thuhet, në fund të faqes:

22 "Hashim Thaçi dhe Sabit Geci janë personat përgjegjës për
23 arrestimet tona".

24 Pastaj tek kolona e fundit, thuhet:

25 "... pas lirimit të 13 politikanëve ata organizuan një

1 konferencë me gazetarët ku theksuan që sjellja e UÇK-së ishte
2 korrekte me ta. Edhe pse disa prej tyre janë rrahur në mënyrë
3 të egër në mënyrë brutale prej tyre".

4 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

5 PË. Kush e ka thënë këtë?

6 PY. Kjo thuhet në artikull. Nuk jepet burimi, nuk thuhet se
7 kush e ka dhënë këtë informacion por thjesht --

8 PË. Këta që e kanë shkru këtë --

9 PY. -- është ajo çfarë shkruhet në artikull.

10 PË. Këta që e kanë shkru këtë artikull nuk kanë qenë në
11 Drenicë. Ajo sha ka ndodhë në Qirez dhe në Baicë e kam thënë
12 po atë ditë që jam kthyer nga Qirezi dhe Baica.

13 PY. Po. Por në deklaratën që i keni dhënë UNMIK-ut është
14 përdorur pak a shumë e njëjtë gjuhë në fund të deklaratës --

15 PË. Ju tregova --

16 PY. -- që disa prej jush janë rrahë në mënyrë kafshërore?

17 PY. Ju kam treguar sot.

18 PY. E di. E di. Thjesht po pyes sepse ka ngjashmëri ndërmjet
19 letrës që i keni dërguar UNMIK-ut që thoshte që jeni rrahur në
20 mënyrë kafshërore dhe formulimit që ka ky artikull që flet për
21 rrahje të rënda apo brutale. A jeni i sigurt që nuk keni qenë
22 ju një prej personave që keni dhënë informacion për këtë
23 artikull?

24 PË. Jo, unë nuk e kam dhënë. Unë krejt çka kam dhënë e kam
25 dhanë publikisht. Edhe këtu jam ka foli publikisht edhe pse

1 kam kërku seancë private për shkak të familjes, se unë që dy
2 ditë marrë me qindra edhe kërcënime edhe ofendime të papame. E
3 bëhen në studio debate, njerëz të pagum mbas tyne janë
4 oligarkë, ku dish për shka bëhet, domethënë, me njollosë
5 figurën time. Unë jam këtu dhe jam shumë krenar për çdo pikë
6 dhe çdo sekondë të jetës time që e kam bë për Kosovën. A dhe
7 shumë rrallë kush me qenë ma krenar se unë, ka dhe tjerë, po
8 shumë pak ka në Kosovë.

9 Domethënë, krejt i kam spjegu dhe nuk po kuptoj e
10 përmendni kafshërore, brutale, të sakatum, e na dalim mbas dy
11 orëve në konferencë shtypi krejtësisht normal. Kjo është pak
12 anakronike.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim raportin e hetuesit të
14 UNMIK-ut që mban numrin SITF00055783 deri në 55996,
15 SITF0055810.

16 PY. Ju thoni, jo "ju", thuhet, thuhet. Katër ditë pasi doli
17 artikulli në gazetë ishte një shënim që thuhet:

18 "Duhet pasur kujdes kur kontaktojmë viktimat e LDK-së për
19 shkak të faktit se i dyshuari është një figurë politike e
20 nivelit të lartë në PDK që mendohet se ka lidhje me krimin e
21 organizuar. Për më tej, po afrohen zgjedhjen në Kosovë dhe
22 duke qenë Hashim Thaçi është kandidat duhet pasur shumë kujdes
23 kur kontaktojmë viktimat e LDK-së. Mund të pretendohet nga
24 përkrahësit e PDK-së se ky hetim bëhet qëllimisht për të
25 diskretituar kandidatët".

1 Dhe ju tani pajtoheni me këtë të dyshuar, me këta të
2 dyshuar?

3 PË. Domethënë, pajtohem se ka qenë një luftë e papame,
4 domethënë, një luftë e egër politike e partive kundër partive
5 oponente, kundërshtare politike me të gjitha mjetet, me të
6 gjitha spekulimet, me gjitha akuzat e mundshme të pamundshme,
7 të besueshme e të pabesueshme, të saktë dhe të pasakta.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. I nderuar kryetar i
9 Trupit Gjykues tani do kërkoja që të pranohej -- tani doja të
10 pranohej në prova raporti i hetuesit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 Ka ndonjë kundërshtim?

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po ai është një dokument mbi 200
14 faqe, 248 faqe dhe vetëm 10 faqe janë përdorur. Nuk ka kuptim
15 që të pranohen të gjitha faqet, po mund të pranojmë thjesht
16 faqet që janë përdorur me këtë dëshmitar, sepse janë disa
17 dokumente të marra së bashku aty.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt pajtohet me Prokuroren.
19 Duam vetëm atë pjesë të raportit të hetuesit që kemi diskutuar
20 që të pranohet si provë materiale.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
22 çaktivizuar]

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Një moment. Është materiali
24 SITF00055803 deri në 55811.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 51

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 Atëherë dokumenti i sapo cituar pranohet.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin e
3 provës materiale 1D67.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
5 çaktivizuar]

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E pashë që Sekretarja u dha dhe
8 numrin përkatës, por duhet të keni parasysh që disa pjesëza të
9 të njëjtit dokument janë pranuar dhe si prova materiale. Që
10 besoj se janë prova materiale 682 edhe 864 dhe 686. Po e them
11 këtë që Sekretarja e Gjykatës të bëjë organizimin e nevojshëm.

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje për Tahir Deskun. Ju
14 thatë që së pari Tahir Desku erdhi t'ju vizitonte në një dhomë
15 ku po ju mbanin dhe tha se tre anëtarë të delegacionit do të
16 vriteshin. A ju kujtohet që e thatë këtë në dëshminë tuaj për
17 EULEX-in?

18 PË. Po kështu ka thënë ai. Domethënë, edhe pse unë e kam
19 njoft Tahir Deskun edhe nga Prishtina shumë kohë para se ai të
20 shkonte në UÇK. Nuk ka qenë ndonjë person kredibil, i
21 besueshëm. Edhe gjena tjera që s'kam dëshirë meqenëse ka vdek
22 s'kam dëshirë të them diçka më tepër. Se është një proverb
23 thuhet për të vdekunin duhen vetëm fjalë të mira.

24 PY. Fatkeqësisht, duhet të përmendim diçka që besoj se ju e
25 keni përmendur dhe më herët, ju e dinit që z. Desku kishte

1 probleme me alkoolin, apo jo?

2 PË. Po kishte probleme. Këtë e dinë gjithë Kosova. Se Kosova
3 është e vogël. Është një qytet.

4 PY. Në deklaratën që keni dhënë për EULEX-in në 2014, që mban
5 numrin 034236-034237 -- edhe njëherë është me numër 034236
6 deri në 034287. Ju keni thënë:

7 "Tahir Desku i përgatiste lajmet sa i takon veprimtarisë
8 së UÇK-së në Drenicë".

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për procesverbal është
10 gjithashtu prova materiale 680.

11 PY. Çfarë keni dashur të thoni ju kur thatë Tahir Desku i
12 përgatiste lajmet lidhur me ato që bënte UÇK-ja në Drenicë?

13 PË. Po ai ka qenë një farë poeti, a një farë gazetari. Për me
14 të thënë të drejtën, kur e kam pa me uniformë edhe me automat
15 mu ka kthye memoria ime kur e kam taku një herë në rrugë të
16 New York kur isha në vizitë zyrtare në Amerikë. Kur e kam pa
17 në rrugë, të ulur në rrugë duke pi birra. E nuk disha cili
18 është Tahiri ai i New York në rrugë si *homelees* apo është tash
19 Tashir Desku këtu.

20 Domethënë është kontraverse unë s'ka -- me thanë të
21 drejtën ju po më pyetni se unë s'isha marrë fare seriozisht me
22 të.

23 PY. Në rregull. Por ju e dinit që ishte pjesë e UÇK-së dhe
24 mbulonte disa detyra që lidheshin me lajmet mbase në UÇK.

25 PË. Po kishte atëherë lajme. Shiqo, ishin mbyllur të gjitha

1 media shqipe në Kosovë nga forcat serbe. Kishte disa lajme që
2 jipeshin në radiotelevizionin shqiptar

3 PY. Po ju pyes për rolin konkret që kishte Tahir Desku në
4 UÇK.

5 PË. Jo.

6 PY. Ju e dini që ai kishte një lloj roli që lidhej me mediat
7 në UÇK.

8 PË. Mendoj që ishte ndoshta i ngarkum me media, po këtë ma
9 mirë e din UÇK-ja. Unë nuk muj me ditë sepse është muj me
10 thanë, si me thënë, konkretisht diçka atëherë mundet mos me
11 qenë e vërtetë. Por ajo pjesë dhe nuk di shka ka muj tjetër
12 gjë ai me bë në UÇK, tu e njoft përpara.

13 PY. Në deklaratë keni thënë që ai përmendi faktin që shtsbi
14 donte të vriste Agim Krasniqin, Mehdi Bardhin edhe ju, po ju
15 nuk e dini a e ka pasë fjalën për shtabin e Drenicës apo --

16 PË. Jo, jo.

17 PY. -- ka dash të thotë ndonjë shtab tjetër?

18 PË. Ai ka thënë në emën të vetë. Ku di unë për shka ka.
19 Domethënë, tashi janë 25 vite këtu. Por ai ndoshta e ka pasë,
20 nuk e di pse e ka pasë atë qëllim pse na ka thënë. Unë
21 personalisht e kam marrë shumë qesharake. Sikur me pasë pru me
22 pi një kafe ekspres, qaq seriozisht e kam marrë Tahir Deskun.

23 PY. Ju treguan një kumtesë që pretendohet se ishte nxjerrë
24 nga policia ushtarake e UÇK-së. A e dini nëse ka pasur -- ka
25 qenë dhe Tahir Desku një prej personave që ka hartuar këtë

1 kumtesë, këtë deklaratë?

2 PË. Nuk kam dëshirë me spekulë. Nuk më kujtohet.

3 PY. Në rregull. Në dëshminë që keni dhënë për EULEX-in, the

4 gjatë kohës që po ju zhvendosnin, po ju lëviznin e po ju

5 kthenin në Qirez dhe në Krajmirovç, ju vendosën, ishit në një

6 veturë dhe të tjerët i vendosën në një veturë tjetër, kështu?

7 PË. Po, ndarazi kemi qenë se s'na ka zënë krejt grupin një

8 veturë.

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] A mund të na thoni numrin e faqes?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, më jepni një

11 çast sa të gjej numrin e faqes.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, besoj se është

13 faqja 12.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Ta le për momentin do

15 ta shoh pak më vonë.

16 PY. Dëshmitar, ju jeni liruar dhe keni komunikuar me Shaun

17 Byrnes, kështu?

18 PË. Rrugës duke u ngjitur në kodër të Cicavicës napër mal.

19 S'ka pasë rrugë

20 PY. Gjatë komunikimit me Shaun Byrnes, a i the ndonjëherë që

21 të kishin rrahur?

22 PË. Jo, s'kam fol. Unë Shaun Byrnes e kam takue atëherë në

23 Prishtinë mbas konferencës për shtyp, të nesërmen. Po të

24 nesërmen në konferencë për shtyp. Konferencën për shtyp e kam

25 mbajt, domethënë, pasi jam kthyer e të nesërmen e kam takue z.

1 Shaun Byrnes. Një personalitet shumë i respektum që unë e kam
2 e gëzoj gjithmonë respektin për të e mbaj, e ruaj me shumë
3 respekte.

4 PY. Në asnjë prej rasteve kur e keni telefonuar pas lirimit
5 ose kur e keni takuar në Prishtinë, pra, në asnjë prej këtyre
6 rasteve ju nuk i keni thënë atij që jeni rrahur, kështu?

7 PË. Jo, e kam përshkru sikur atë çka kam përshkru para jush
8 këtu, domethënë, situatën e vërtetë. Edhe Shaun Byrnes kur e
9 kam takue, kur e kam telefonue nga mali vetëm jemi marrë vesh
10 teknikisht si me mujt me e realizu kthimin tonë pa probleme në
11 Prishtinë.

12 PY. Dhe ju asnjëherë nuk i thatë z. Byrnes që dikush me emrin
13 Hashim Thaçi ishte përgjegjës për ndalimin tuaj, kështu?

14 PË. Jo. Domethënë, nuk ja kam thënë. Sepse edhe një herë po
15 jua përsëris, Hashim Thaçi e kam takue krejt mbas kësaj
16 ngjarje në Baicë, mbas disa orëve. Tani nuk e di saktë një orë
17 a dy, a tri. Nuk është shumë. Sado që të them nuk muj me ia
18 qëllu se s'e kam shkru, s'e kam avidentu.

19 PY. A është e drejtë të themi se në qoftë se do ia kishe
20 thënë një diçka të tillë z. Byrnes kjo do të kishte ndodhur
21 goxha kohë pas lirimit tuaj?

22 PË. A bën edhe njëherë me më pyet se nuk e kuptova pyetjen?

23 PY. Pra, nëse nuk ia keni thënë ditën e lirimit dhe nuk ia
24 keni thënë as kur e keni takuar në Prishtinë, në qoftë se ju
25 ia keni thënë diçka të tillë, i takon që këtë t'ia keni thënë

1 kohë më vonë, kohë më pas?

2 PË. Shiqo, unë e kam taku disa herë, z. Byrnes edhe mbas
3 kësaj ngjarjeje edhe kena bë biseda shumë miqësore për shumë
4 tema. Edhe unë nuk du me thënë këtu, po Shaun Byrnes e ka
5 vlerësue, domethënë, lart qëndrimin tim, por e ka pasë
6 gjithmonë edhe respekt dhe qëndrim shumë pozitiv edhe për z.
7 Thaçi, Presidentin Thaçi dhe për UÇK-në. Sepse pa UÇK-në, pa
8 NATO-n, pa sakrificat, gjakun që kanë derdhë njerëzit tonë
9 edhe pa Amerikën dhe Evropën kurrë s'ish bë liria e Kosovës.
10 Edhe këto janë sende të shenjta për ne e posaçërisht për mu,
11 po edhe besoj që për 99 për qind të shqiptarëve të Kosovës.
12 PY. Dua t'ju pyes për deklaratën e EULEX-it.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Që ka numër 034504 deri në 034537
14 edhe prova materiale ndryshe 81 në faqen 034517. Ju kërkoj
15 ndjesë e dhashë numrin e një dokumenti të gabuar.

16 PY. Dua t'ju pyes për deklaratën e EULEX-it po më duhet të
17 gjejë fillimisht numrin e saktë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Është prova materiale P680 në
19 faqen 034266.

20 PY. Duhet të gjejmë dhe pak versionin në shqip. Shqipja ka
21 numrin 034283.

22 Këtu thuhet, është pak e gjatë, po dua të sigurohemi që e
23 kemi kuptuar ne siç duhet. Thuhet:

24 "Na vendosën në vetura dhe na çuan në fshatin Krajmirovç.
25 Na çuan në shtëpinë e një personi me mbiemrin Mehmeti. Ish një

1 person në moshë. Ishte shtëpia e tij dhe nga kjo ishte mënyra
2 si e kuptova unë se ai ishte kreu i shtëpisë. Kjo është me
3 rëndësi sepse nga kjo shtëpi në Krajmirovç, mua më futën në
4 veturë bashkë me Veli Bytyqin, Hashim Thaçi dhe Sabit Gecin.
5 Sabit Geci ishte vozitësi, kurse Veli Bytyqi dhe unë ishim
6 ulur në ulësen e prapme".

7 Dëshmitar, është e saktë kjo?

8 PË. Po

9 PY. "Ata me veti kishin dy armë automatike dhe pasi që nuk
10 kishin hapësirë përpara, ata na pyetën nëse mundem me i lënë
11 armët në ulësen e prapme. Nuk e di a dëshironin të na
12 provokonin, por neve nuk kemi bërë asgjë me ato armë. Pastaj
13 ata e ndalën veturën. Pjesa tjetër e grupit ishte në kombin të
14 cilin e kam përmend më herët".

15 Kur thoni pjesa tjetër e grupit e keni fjalën për pjesën
16 tjetër që delegacionit?

17 PË. Po.

18 PY. Pra edhe Agim Krasniqi ka qenë në komb?

19 PË. Të gjithë kanë qenë pjesa tjetër përveç unë edhe Veli
20 Bytyqi.

21 PY. Pastaj tregon për pjesën kur thotë, vazhdon dhe thotë:

22 "Ata lëshuan radion për të dëgjuar lajmet dhe dëgjuam se
23 ministri i Mbrojtjes Ahmet Krasniqi ishte vrarë në Tiranë.
24 Hashimi dhe Sabiti ishit të gëzuar, në realitet ishin të
25 entuziazmuar. Ata folën me njeri-tjetrin. Ne nuk e kuptonim

1 pse ishin aq të gëzuar. Pastaj Sabiti më tha se jo 13 nga ne,
2 po vetëm 12 do të shkonin të Prishtinë. Unë e pyeta pse dhe ai
3 më tha Agim Krasniqi i cili ishte në komb do të vritej nga ata
4 tha Sabiti. Ai i takonte partisë politike të Rugovës me të
5 kaluar ushtarake dhe ai ishte kryetari i komitetit të sigurisë
6 të kuvendit të Kosovës dhe sipas mendimit të tyre ai ishte i
7 radhës i cili do të duhej të bëhej Ministër i Mbrojtjes".

8 A ju kujtohet kjo?

9 PË. Kjo --

10 PY. Është e saktë?

11 PË. Kjo, domethënë, sa i përket entuziazmit e ato çka po
12 thuhet këtu, të qeshjes, ajo absolutisht s'ka ndodhë. Ka qenë
13 më shumë revansh. Unë ju thashë edhe një herë, një kohë të
14 gjatë mbas kësaj ngjarje unë këta njerëz i kam konsideru
15 armiq. Kundërshtarë domethënë. Edhe pastaj është e vërtetë,
16 domethënë, që [REDAKTUAR] ndoshta me na provoku ose me na
17 frikësu ose me na -- ku di unë qëllimet e tina. Nuk kam mujt
18 me lexu kokën e tina, trunin e tina dhe ka thënë që do të
19 kemi, domethënë, lidhur me Agim Krasniqin dhe ka dalë nga
20 makina, Hashimi dhe Velia s'kanë dalë fare nga makina,
21 Presidenti Thaçi dhe i nderumi Bytyqi.

22 Edhe kur ka dalë nga makina kam dalë edhe unë nga makina.
23 Ai më ka thënë "Mos del nga makina". Unë kam dalë nga makina
24 sepse s'kam dashtë t'i ndodhë kërrkuj ajo çka ai ndoshta na ka
25 provoku. Nuk besoj që ka pasë atë mendim. Edhe sot nuk besoj

1 që e ka pasë atë mendim, por nuk muj me e lexu trunin e tij as
2 atëherë as tash. Dhe me thënë të drejtën, unë kam qenë --
3 PY. Në rregull. Unë do vazhdoj të lexoj domethënë.

4 "Kjo ishte në mendjen e tyre. Sabiti zbriti nga vetura
5 dhe e nxirri një armë të dorës nga vetura. Edhe unë zbrita nga
6 vetura. Ai më tha 'kthehu mbrapa në veturë ose do të vras'.
7 Unë i thashë se unë isha lideri i grupit dhe se ai duhet të më
8 vriste mua së pari. Unë i thashë Hashimit ta ndalonte sepse
9 këta ishin civilë që nuk kishin bërë asgjë të keqe. Të gjithë
10 janë intelektual".

11 Dhe vazhdon, Prokurori ju pyet:

12 "A keni qenë të liruar në këtë moment?"

13 Ju i jeni përgjigjur:

14 "Ne ishim të liruar, por nën përcjelljen e tyre.

15 "Por në bazë të insistimit tim, Sabiti nuk shkoi tek
16 kombi me armë në orë, por ai u kthye në veturë dhe i tha Agim
17 Krasniqit 'Shko dhe falënderoju liderit të grupit tuaj sepse
18 ai është një lider i vërtetë i cili bile pranoj që të vritej
19 për të shpëtuar ju. Gjergj Dedaj është ai që ta shpëtojë jetën
20 dhe jo unë'".

21 Kështu i keni thënë EULEX-it?

22 PË. Shiqo, këto nuk mund me i mbajt mend këto detale se është
23 një kohë shumë e gjatë, është një situatë e vështirë
24 domethënë. Por e di që e kam lut Presidentin Thaçi me gojë,
25 domethënë, e kam "Ndale këtë njeri, fute në kerr, në makinë".

1 Edhe muj me thënë tuj i falenderu --

2 PY. Në rregull. Në rregull.

3 PË. Okej.

4 PY. Po ju EULEX-it nuk i keni thënë që e ndaloi Presidenti

5 Thaçi?

6 PË. Jo, jo s'e ka ndalu.

7 PY. EULEX-it i keni thënë --

8 PË. Jo.

9 PY. -- na lejoni të përfundojmë. Ju i keni thënë që ju e
10 ndaluat dhe [REDAKTUAR] kaq shumë u impresionua nga kjo që
11 kishit bërë ju, saqë i ka thënë Agim Krasniqit që ju ia kishit
12 shpëtuar jetën Agim Krasniqit.

13 PË. I ka thënë ai ato fjalë.

14 PY. Këtë i keni thënë EULEX-it?

15 PË. I ka thënë ato fjalë domethënë. Edhe, mirëpo, unë s'kam
16 nuk kam pasë, domethënë, në mal me [REDAKTUAR] ballë për ballë
17 nuk e kam pasë atë mundësi unë me ndalë unë vetë Sabit Gecit.
18 Mirëpo unë edhe kur vijna në krye të një grupi edhe kur jam në
19 krye të disa shokëve, e disa miqve, unë njifna nga kodi im
20 familjar se nëse duhet me -- unë e kam mëndu gjithmonë që do
21 të ballafaqohemi me paramilitarët serb. Ju kam thënë çdo
22 rrezik e marr unë edhe nëse duhet me u vra le të vritna unë.

23 Sepse unë kam qenë i gatshëm çdo ditë edhe jam rru çdo
24 ditë se ku të vritna mos me u vra, domethënë, i papastër. Dhe
25 për këtë arsy, domethënë, ka qenë një dramë ama shumë e kur e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 61

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 kam analizu e mëndu se ai Sabiti ka mujt, për shembull, me
2 pasë dashtë na kish vra krejtve, ai me të vra domethënë.
3 Mirëpo aty më shumë ka qenë një presion, një frikë, tentim me
4 na frigu dhe s'ka ndodhë kurrëgjë.

5 Edhe e kam lut edhe Presidentin Thaçi që është i
6 pranishëm në këtë dhomë, "Të lutna ndale këtë njeri sepse na
7 jemi të lirum, na jena kështu-kështu, kush jemi edhe krejt
8 Kosova e din kush jemi". Domethënë edhe këta e kanë ditë kush
9 jemi edhe për atë arsy. Mirëpo kanë pasë një -- këtë nuk po ma
10 thoni ju shpesh se shumë fakte nuk po i thoni. Këta kanë pasë
11 saktë drejtë me na ndalë. Me ditë kush jemi na. Çdo ushtri i
12 kish ndalë një delegacion të tillë kur shkon pa leje, pa i
13 njoftu.

14 PY. E dëgjua këtë, e kemi dëgjuar këtë. Të jeni i sigurt. Të
15 jeni i sigurt që e kemi dëgjuar këtë. Po dua të fokusohemi tek
16 incidenti me Sabit Gecin dhe Agim Krasniqin. Do të habiteshit
17 ju po t'ju thoja unë që Agim Krasniqi kur i ka dhënë dëshminë
18 EULEX-it ka thënë se nuk e kujtoj ndonjë rast që të jetë
19 kërcënuar nga Sabit Geci apo t'i ketë thënë Sabit Geci që ju i
20 kishit shpëtuar jetën, a është befasi kjo për ju?

21 PË. Ajo është e drejtë e tina. Domethënë, nuk hyj unë në
22 deklarata sha kanë thënë tjerët. Ai i bën nder ajo, a s'i ban
23 nder është çështje e tij personale, mu nuk më intereson. Unë e
24 di që ai delegacion ka qenë njerëz me dinjitet kanë qenë të
25 gatshëm me arrestu nga Serbia edhe me u vra nga Serbia. Se ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 62

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 pasë plot në listë që kanë hi e pastaj janë tërhek nga frika.

2 E shumë që s'kanë pranuar fare me hi në listë.

3 Mirëpo, kjo çka ka thënë Agimi unë nuk muj me -- unë nuk
4 e interpretoj. Por e di, ndigjo, titullin e kësaj, krejt kësaj
5 dëshmie, nëse më lejohet me thënë, ia veni është fat që unë
6 kam qenë në krye të këtij delegacioni, kam qetësu gjithçka
7 edhe është fat që ka qellu Hashim Thaçi, se shpesh ka dalë në
8 terren nëpër zona tjera, që ka qellu Presidenti Hashim Thaçi
9 në Drenicë edhe na jena sot të gjithë shëndoshë e mirë. Është
10 fat për këta dy vetë. Këta dy vetë janë të nderum edhe janë
11 ata të cilët e kanë tejkalu këtë situatë edhe krejt tjerat
12 folni shka doni sa herë doni.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal referenca e
14 dëshmisë së Agim Krasniqit mbante numrin 034504 deri në 034537
15 dhe më pas në 034517.

16 I nderuar Gjykatës, është momenti për të bërë pushimin.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
18 tani do të bëjmë pushimin deri në orën 11.30. Ju lutem mos
19 flisni me askënd lidhur me dëshminë tuaj.

20 DËSHMITARI: *Thank you* [në anglisht].

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni diçka
23 për të thënë?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë nuk kam edhe shumë pyetje,
25 besoj se do përfundoj për një orë e gjysmë pas pushimit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 63

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdon)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Bëjmë pushim deri në orën 11.30.

3 --- Pauza fillon në orën 11.00

4 --- Seanca rifillon në orën 11.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, ju lutemi sillni dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

9 [Përkthim] Atëherë do të vazhdojmë përsëri me pyetjet e
10 ekipit të z. Thaçi për ju, dëshmitar.

11 Z. Misetic, fjala për ju.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

13 PY. Dëshmitar, besoj që do lumturoheni kur të them që kam
14 edhe pak pyetje të mbetura për t'ju bërë.

15 Së pari, a do të na tregoni dot se në çfarë rrethanash
16 jeni caktuar, jeni emëruar, ambasador i Kosovës?

17 PË. Shiqo, qetë fjalën "lumturoheni", kjo nuk vlen për mu, të
18 falënderoj shumë që e mendoni ashtu. Se unë s'di çka është
19 lumturia.

20 Sa i përket kësajna, unë në vitin 2018, në fund të vitit
21 2018, në sajë të një marrëveshje parazgjedhore e nënshkrime me
22 Partinë Demokratike të Kosovës jam emnu ambasador i
23 jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Kosovës në
24 Republikën e Maqedonisë në Shkup.

25 PY. Çfarë marrëveshje u bë me PDK-në?

1 PË. Shiqo, të qenit liberal në Kosovë, miqtë e mi edhe
2 amerikanët ma kanë thanë që është sakrificë dhe është
3 aventurë, mirëpo unë e kam bo për qëllime të caktume të cilat
4 i kam thanë disa herë, nuk po du me folë tash për parti
5 politike. Edhe ka -- në pamundësi për me fitu ulësen në
6 kuvendin e Kosovës, sepse në krejt Ballkan partitë liberale
7 kanë probleme, atëherë kam bo koalicion që nga viti 2007, jam
8 në koalicion me Partinë Demokratike të Kosovës edhe derisa të
9 jem gjallë do të jem votues i saj.

10 Dhe në këtë marrëveshje kemi specifiku që do të kemi një
11 zëvendës ministër, e këshilltar ose edhe në mungesë të një --
12 ose edhe një ambasador. E kam nënshkru me të nderumin,
13 kryetarin e kuvendit të Kosovës, Kadri Veselin.

14 PY. Është një dokument i nënshkruar ky?

15 PË. Po.

16 PY. Ndonjë pjesë e marrëveshjes, a përfshin ndryshimin e
17 dëshmisë tuaj që i keni dhënë EULEX-it në shkëmbim të postit
18 për ambasador?

19 PË. Si e -- të lutem?

20 PY. Ndonjë pjesë e marrëveshjes, a ishte fakti që ju duhet të
21 ndryshonit dëshminë që i keni dhënë EULEX-it në mënyrë që të
22 emëroheshit ambasador?

23 PË. Jo. Njimijë ambasadora me m'i pas dhanë, e kryeministër
24 me më pas bo, president me më pas bo, edhe president të
25 Evropës me më pas bo, kjo nuk lidhet me këtë pjesën për të

1 cilën jemi këtu.

2 PY. Pyetja e radhës është kjo, a e njeh dikënd me emrin

3 Zymber Zymberi?

4 PË. Zymber Zymberi?

5 PY. Po.

6 PË. E njoh.

7 PY. Si e njeh?

8 PË. Ka pas punu në sigurimin e përparshëm të policisë

9 përpara, domethënë, para lufte, motit domethënë, në vitet
10 1980, 1990.

11 PY. E njeh vetë personalisht atë?

12 PË. E njoh personalisht. Mendoj se e njohin të gjithë në
13 Kosovë. Është njeri i njoftshëm, bile është i gjatë kështu,
14 s'ka njeri gati ma të gjatë në Kosovë. Nëse është fjala për
15 atë, ndoshta është ndonji Zymber tjetër. Njoh shumë njerëz në
16 Kosovë unë.

17 PY. A e njeh një person me emrin Zoran Stijovic?

18 PË. Edhe atë e njoh, sepse më ka marrë në pyetje. Më ka
19 arrestu.

20 PY. Kur të ka arrestu ai ty?

21 PË. Kur, ndoshta kur jam kthy prej nji demonstrate në Bon, në
22 Gjermanisë, kam folë në demonstratë në Bon. Para lufte, para
23 lufte, po, para lufte. Edhe porsa jam kthy në Prishtinë më
24 kanë arrestu edhe më ka marrë në pyetje me armë në tavolinë.
25 Ka nxjerrë revolen në tavolinë. Edhe aty kam bë kërkesë "Mos

1 më prek me dorë, vrajëm, me dorë mos gabo me më prekë”.

2 PY. Në rregull. A ke pasur ndonjë bisedë, ndonjëherë me

3 Zymber Zymberin apo Zoran Stojivic për ngjarjet e ndodhura në

4 Baicë?

5 PË. Jo. Absolutisht kurrë një jetën time. Ajo ngjarje, unë

6 Zoran Stijovic e kam njoftë para lufte, kur e kam njoftë

7 s’kanë qenë këta të UÇK-së fare, domethënë. Atëherë jam

8 arrestu unë.

9 PY. Kur e ke parë herën e fundit personalisht Zoran Stijovic?

10 PË. Herën e fundit e kam pa në Gjykatën Speciale në

11 televizion, Stijovic. Ka qenë një proces. Nuk di kundër --

12 PY. [Nuk ka përkthim]

13 PË. Ah, kurrnjiherë. Asnjëherë, as nuk du me e pa kurrë. Nuk

14 kam dëshirë me e pa kurrë, as e kam pa kurrë.

15 PY. [Nuk ka përkthim]

16 PË. *In Bonn.*

17 PY. [Nuk ka përkthim]

18 PË. Kurrnjiherë në jetë.

19 PY. Kur ka qenë hera e fundit që keni parë Zymber Zymberin

20 personalisht?

21 PË. Zymberi lëshohet nëpër [REDAKTUAR] ai, ec aty nëpër shesh

22 të [REDAKTUAR] edhe tash. Duket pak si i paralizumë,

23 domethënë, e shofim, por unë s’kam biseda private me të,

24 asnjëherë. Kurrë në jetë teme nuk jam ulë në tavolinë me të.

25 PY. Zymber Zymberi a të ka inkurajuar, mbështetur ndonjëherë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 67

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 që të takoheshe me Zoran Stijovic për të diskutuar ato

2 ngjarjet që kanë ndodhur në Qirez dhe në Baicë?

3 PË. Asnjiherë, asnjiherë. Shiqoni, kjo çka po më pyetni po më

4 duket si ndonji film i Hitchcock. S'kam lidhje me këto. Bile

5 mu mos më -- çka të doni muj me thanë për mu, veç këtë pjesën

6 e policisë së Serbisë aty mos më përzeni mu hiç. Unë qe 100

7 vjet Serbia ka vra familjen time. Rrumbullak 100 vjet.

8 PY. E kuptojmë.

9 PË. 20 burra e djem të rinj.

10 PY. E kuptojmë. Do ju falënderoj për përgjigjet që i dhatë

11 pyetjeve të mia.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar z. Kryegjykatës,

13 përfundova me pyetjet e mia.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

15 z. Misetic.

16 Ndonjë pyetje nga Mbrojtja e Z. Veseli?

17 Z. STRONG: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully?

19 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit. Do përpigem që të

20 përfundoj pyetjet brenda një seance. Mbase mund të jetë pak më

21 gjatë se një seancë, por do të bëj më të mirën e mundshme.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

23 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit.

24 Pyetje të palës tjetër nga z. Tully:

25 Z. TULLY: [Përkthim]

1 PY. Mirëmëngjes, dëshmitar. Unë quhem Eric Tully, unë
2 përfaqësoj Rexhep Selimin. Do t'ju bëj pyetje për rreth një
3 orë, një orë e gjysmë. Do të mundohem të jem sa më shkurtër të
4 jetë e mundur. Kemi gati dy ditë e gjysmë që po dëgjojmë
5 dëshminë tuaj, kështu që kur të jetë e mundur, ju lutem,
6 përgjigjuni me "po" apo "jo" pyetjeve që do të bëjmë. Dëshiroj
7 që pyetjeve t'u përgjigjeni me aq sa kujtoni se mundeni, por
8 si z. Misetić, në qoftë se mendoj që jepni një përgjigje më të
9 gjatë në pyetjen time, do ngre dorën në mënyrë të tillë që
10 t'ju bëj shenjë për të ndaluar.

11 Do bëj një përmbledhje të temave që do të cek. Por, për
12 momentin, dua që të jem i qartë për pyetjet e mia, kështu që
13 në qoftë se ka ndonjë pyetje që ju nuk e kuptoni ose në qoftë
14 se keni nevojë për sqarime të tjera, ma thoni këtë gjë.

15 E kuptoj nga shënimi përgatitor që flisni anglisht.
16 Dëgjoni apo jo, e dëgjoni përkthimin, dëshmitar, apo jo?

17 DËSHMITARI: Jo, du -- zëri është shumë i ulët. Më fal.
18 [Në anglisht] *Thank you.* Faleminderit.

19 Z. TULLY: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, po thoja që nga shënimi përgatitor vura re që
21 flisni anglisht. Kështu që në qoftë se i kuptoni pyetjet e mia
22 nga anglishtja, duhet që gjithsesi të prisni derisa të
23 përfundojë përkthimi në shqip përpara se të jepni përgjigje.

24 Për t'ju dhënë një ide se si do t'ju bëj pyetjet, më
25 lejoni t'ju them që kam dy tema të gjera që do të mbuloj. Së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 69

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 pari, do të merrem me ngjarjet në Qirez dhe pastaj veçmas do
2 të merrem me ngjarjet në Baicë.

3 Nuk do i referohem fare Personit numër 1 kështu që nuk
4 është e nevojshme për ju që të jepni përgjigje për këtë
5 person, me përjashtim të rasteve kur do t'jua kërkoj
6 shprehimisht këtë gjë. Sa i takon temës së parë, do të trajtoj
7 identifikimin e z. Selimi, pra identifikimin e z. Selimi si
8 personi që ka qenë në makinë dhe personi me të cilin ju keni
9 folur në rrugën që ju keni bërë nga Qirezi në Baicë. Juve ju
10 bë një pyetje të hënën sa i takon z. Selimi, kështu që unë do
11 t'ju sugjeroja që personi që ju keni folur në makinë, dhe në
12 fakt keni folur më tej në shkollë në Baicë, nuk ka qenë z.
13 Selimi, por ka qenë dikush tjetër. Dikush që njihet me nofkën
14 Guri, sepse z. Selimi nuk e ka përdorur këtë nofkë gjatë kohës
15 së luftës.

16 Megjithatë, përpara sesa të vazhdoj te kjo pjesa,
17 dëshiroj që t'ju bëj një pyetje që kërkon një përgjigje me
18 "po" apo "jo". Përpara shtatorit të 1998, ju nuk e keni parë
19 asnjëherë më përpara Rexhep Selimin apo jo?

20 PË. Jo, asnjëherë.

21 PY. Nuk e keni parë asnjëherë. Gjatë ngjarjeve në Qirez ose
22 në Baicë, në shtator 1998, askush nuk është prezantuar si
23 Rexhep Selimi dhe askush asnjë person i tretë nuk është se ju
24 ka prezantuar dikë që ky është Rexhep Selimi, po apo jo?

25 PË. Deri në Baicë, edhe pse ka qenë në makinë me mu, nuk e

1 kam ditë që është Rexhep Selimi. Ka thanë "Jam Guri". Deri kur
2 na ka kthy letërnjoftimet.

3 PY. E kuptojmë. Dua t'ju lexoj një paragraf nga një anëtare e
4 delegacionit, nga Sanije Zeqiraj. A ka qenë anëtare e
5 delegacionit, dëshmitar?

6 PË. Po, po. Po, ajo ka qenë, por u kthy në Prishtinë.

7 PY. Në rregull.

8 Z. TULLY: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares që të
9 paraqesë provën materiale 1D39, faqen 11439. Nëse nuk mund ta
10 paraqisni dot, mund ta lexoj, mbase është më e thjeshtë këtu.

11 PY. Sanije Zeqiri i thotë [REDAKTUAR] "Në kohën e ngjarjes në
12 Qirez, nuk e dinte se kush ishte Rexhep Selimi, as popullata
13 civile nuk e dinte se kush ishte Rexhep Selimi".

14 Bazuar në atë çfarë thotë z. Zeqiraj, z. Selimi nuk ka
15 qenë një figurë publike në shtator 1998. A pajtoheni ju me
16 këtë dëshmitar?

17 PË. Unë s'e kam njoftë dhe nuk kam se si me komentu
18 deklaratat e znj. Zeqiri, sepse në fakt ajo dhe grupi tjetër
19 që kena folë i zonjave janë urdhënu me u kthy për Prishtinë.

20 PY. Ju pajtoheni atëherë që z. Selimi u bë i njohur për
21 publikun në Kosovë drejt fundit të luftës, ose mbase edhe pas
22 luftës, më vonë në vitin 1999. A pajtoheni me këtë?

23 PË. Shiqo, nuk e di kush e ka njoftë dhe kush s'e ka njoftë
24 z. Selimi. Çdo respekt për të. Unë kam arritë me e njoftë
25 vetëm në Baicë.

1 PY. Dëshmitar, vetëm pas ngjarjeve në Baicë ju e bëtë lidhjen
2 ndërmjet emrit të Rexhep Selimit dhe personit që keni takuar
3 apo me të cilin keni biseduar në atë makinë, pas 1998, kështu?

4 PË. Unë në makinë nuk e kam ditë që është -- a është apo nuk
5 është Rexhep Selimi se kurrë s'e kisha taku e kurrë s'e kisha
6 pa.

7 PY. Kur e mësove emrin e Rexhep Selimit?

8 PË. Kur në Baicë na ka kthy, kam thanë edhe atë ditë, edhe
9 them gjithmonë, me shumë mirësjellje, edhe me shumë respekt,
10 domethënë, ka shpreh, edhe keqardhje, domethënë, por na ka
11 kthy letërnjoftimet. Aty është pëshpëritë se ky është Rexhep
12 Selimi, domethënë, unë nuk, nuk e kam njoftë. S'di qysh me ju
13 thanë ndryshe. Kurrë në jetë teme s'e kam pa ma përpara.

14 PY. Pra, keni dëgjuar fjalë që ai ishte Rexhep Selimi, por ai
15 vetë nuk është se ju është prezantuar se unë jam Rexhep
16 Selimi, kështu është?

17 PË. Jo, jo, nuk është prezantu. Nuk ka pasë arsye me u
18 prezantu se na, domethënë, nuk më kujtohet që është prezantu.

19 PY. Në rregull. Ju thatë që e keni dëgju nga të tjerët, keni
20 dëgjuar thashetheme që ishte Rexhep Selimi, këtë e keni dëgju
21 nga persona të tjerë që ishin pjesë e delegacionit?

22 PË. Mund të jenë thashetheme, mund të jenë çka të dojnë, unë
23 po them çka kam ndëgju edhe çka kam mendu, edhe çka mendoj
24 sot.

25 PY. Pas ngjarjeve në Baicë, në shtator të 1998, kur ka qenë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 72

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 hera e fundit kur keni bërë lidhjen e emrit Rexhep Selimi me
2 fytyrën e Rexhep Selimit, kur e keni parë atë?

3 PË. Shiqo, mbas lufte, domethënë, njerëzit janë, në Prishtinë
4 kanë jetu. Prishtina është -- bile rruga kryesore është një
5 shesh që me bo me kalu dy-tri herë gati krejt njerëzit
6 kryesorë të Prishtinës i sheh. Domethënë, edhe nuk e di datat
7 unë, s'kam pasë nanji nevojë me shënu datën kur e kam taku
8 këtë njeri apo atë njeri.

9 PY. Nuk dua të më japësh datën ekzakte, por thoni pas luftës.
10 Domethënë pak a shumë kur ka qenë? Ju thatë që ishte pas
11 luftës, pra pas luftës keni bërë lidhjen e Rexhep Selimit,
12 emrit, me personin, ë? Ka qenë pas luftës, më vonë në 1999, në
13 vitin 2000? Kur?

14 PË. Jo -- e kam njoftë në -- jo e kam njoftë në distancë
15 mbase lufte, por unë kurrë s'kam pasë kështu kontakte, s'kam
16 pasë me të domethënë.

17 PY. E kuptojmë. Dje kur po flisnit me z. Misetic dhe kur po -
18 - dhe në fakt nuk po flas për ngjarjet në Qirez, por për atë
19 çfarë keni thënë ju për thelbin.

20 Pra, dje kur po flisnit me z. Misetic, përmendët dy
21 individë në zyrën e LDK-së, që ishin Gani Koci dhe personi 1.
22 Nuk më intereson përshkrimi i ngjarjeve, por thjesht dua t'ju
23 pyes në qoftë se e kam kuptuar drejt që këto kanë qenë dy
24 individët që ju i keni njohur vetë dhe që kanë qenë në zyrën e
25 LDK-së më datë 20 shtator të 1998?

1 PË. Nuk e kam kuptu pyetjen.

2 PY. Kur ju dhe delegatët e tjerë ishit në dhomë, që po
3 mbaheshit aty tek dhoma në Qirez, të vetmit dy persona që ju
4 përmendët kur po flisnit me z. Misetic ishte Gani Koci dhe
5 Personi numër 1. A kam të drejtë që këta janë dy personat e
6 vetëm që ju i njohët, i identifikuat, nga ajo dhomë?

7 PË. Po, keni të drejtë. Keni të drejtë.

8 PY. Kur u takuat me këtë individ ai e quajti veten Guri, dhe
9 këtu kjo ka ndodhur në makinë ndërkohë që ju po shkonit nga
10 Qirezi në Baicë.

11 PË. Po.

12 PY. Do ju lexoj një fragment nga dëshmia që keni dhënë të
13 hënën. Është transkripti nga data 6 nëntor, faqet 9357 deri
14 9358, pyetja që ju bëhet është kjo:

15 "E kuptoj që nuk jeni të sigurt tani. Por a ju kujtohet
16 që keni dhënë dëshmi vite më përpara, nëntë vite më përpara në
17 2014 që keni thënë që në makinë me ju ka qenë Rexhep Selimi."

18 Dhe ju thatë:

19 "Ndoshta ishte ai. Por për shkak se ai është këtu tani
20 unë mendoj që përgjigjja ka qenë subjektive në deklaratën
21 time. Por personi që ishte në makinë nuk jam i sigurt në qoftë
22 se ka qenë Rexhep Selimi apo jo."

23 Pyetja që kam tani për ju është kjo, a ju kujtohet t'ju
24 jetë bërë kjo pyetje dhe të keni dhënë përgjigjen që sapo
25 lexova?

1 PË. Po.

2 PY. Faleminderit. Përpara sesa të shkojmë më tej, a mund të
3 më sqaroni, ju lutem, se sa vetë ishin në atë makinë bashkë me
4 ju, personi që u prezantua si Guri dhe shoferin?

5 PË. Shoferi, ka qenë edhe personi për të cilin ju po flitni,
6 ka qenë ulur në atë makinë, edhe unë.

7 PY. Pra, nuk kishte asnjë person tjetër që u fut në makinë,
8 domethënë, dhe askush nuk doli nga makina, vetëm tre veta keni
9 qenë, nuk është se ndaluar diku dhe morët dikë apo zbriti
10 dikush, kështu?

11 PË. Nuk më kujtohet ai -- nuk më kujtohet.

12 PY. Në rregull. Faleminderit. Dy ditë më përpara, na thatë që
13 shoferi në makinën ku ishit rrugës nga Qirezi për në Baicë,
14 ishte Sylejman Selimi. A ju kujtohet ta keni thënë këtë,
15 dëshmitar?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe ju nuk e dinit se kush ishte Sylejman Selimi në atë
18 kohë, apo jo?

19 PË. Po, kishim dëgju për të se ai ishte nëpër media, pastaj
20 këto i kam mësu ma shumë prej njerëzve aty në, gjatë qëndrimit
21 në Baicë, 48 orë, domethënë, që ai është, ka qenë edhe pak ma
22 i veçantë në pamje, domethënë. Edhe ka mundësi që të jetë kanë
23 Sylejman Selimi.

24 PY. Në rregull. Por, ju menduat që mbështetur në faktin që e
25 keni parë Sylejman Selimin më vonë në jetën tuaj, ju ishit në

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 75

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 gjendje që të thonit me siguri që ai person që ishte në makinë
2 ishte Sylejman Selimi. A është e saktë kjo?

3 PË. Po, po. Se unë kam bisedu me njerëz mbase lufte, kush ka
4 qenë ai në makinë, se mu më ka interesu. Edhe sot e kësaj dite
5 më intereson zbardhja totale e kësaj ngjarje. Edhe derisa të
6 vdes.

7 PY. Pra, dëgjuat të tjerët që ta thonin këtë që ishte
8 Sylejman Selimi. Këtu e mbështetët njohurinë tuaj mbi faktin
9 që ishte Sylejman Selimi, kështu?

10 PË. Unë thashë -- ka mundësi, edhe jam i bindun që ka qenë
11 Sylejman Selimi, por 100 për qind s'mund me folë as për vete,
12 se 25 vjet në pyetje.

13 PY. Në rregull.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Znj. Sekretare, do kërkoj që të
15 paraqisni në ekran [REDAKTUAR], numri ERN është
16 034318 deri në 034462, faqet 034323. Dhe referenca për
17 dokumentin në shqip mban të njëjtin numër ERN-je në faqen
18 034336, dhe me ERN që përfundon me 7 në faqen pasuese.

19 PY. Do ju tregoj diçka në ekranin që keni përpara, dëshmitar.
20 Do ju tregoj diçka, do lexoj pjesën përkatëse dhe pastaj do ju
21 bëj pyetje.

22 Ju kërkojmë ndjesë, dëshmitar, se po kërkojmë që të
23 paraqitet dokumenti në ekran nga Sekretarja.

24 Z. TULLY: [Përkthim] Në versionin në anglisht është pak
25 më poshtë në faqe. Një minutë. Mendoj që vazhdon te faqja

1 tjetër. Është në fund të kësaj faqe dhe në fillim të faqes --
2 jo, e kisha fjalën për shqipen.

3 PY. Në fillim fare dua që ta lexoni. Do lexoj nga faqja
4 përpara kësaj faqes që keni në ekran. Dhe aty thuhet që:

5 "Të gjithë ne ishim vendosur në makina. Vetëm gratë ishin
6 -- gratë dhe gazetarët ishin larguar. Unë dhe Agimi shkua te
7 makina e Sulltanit. Unë atë nuk e njihja në atë kohë."

8 Kjo është deklaratë e Mehdi Bardhit. Dhe Prokurori pyet:

9 "Si e keni ditur që ai quhej Sulltan?"

10 Dëshmitari thotë:

11 "Të gjithë e dinin që ai quhej Sulltan. Agimi bisedoi me
12 të. Nuk jam i sigurt nëse vetura ishte Mercedes apo diçka e
13 ngjashme si ajo. Agimi bisedoi me të dhe më tregoi se ai ishte
14 vetë Sulltani. Pastaj ne mbërritëm në fshatin Baicë..."

15 Ju nuk e kujtoni që Mehdi Bardhi dhe ky personi tjetër u
16 futën në veturë me juve dhe shkuat të gjithë së bashku në
17 Baicë, apo jo, domethënë, Sulltani dhe Mehdi Bardhi u futën në
18 makinë me ju.

19 PË. Jo, jo.

20 PY. Nga ky paragrafi që shohim, duket sikur z. Bardhi ishte
21 shumë i sigurt ashtu siç ishit ju lidhur me identifikimin e
22 Sylejman Selimit. Por dallimi është që ai e njeh, e njihete, e
23 njihete mirë Sylejman Selimin dhe dinte të thoshte që me kë po
24 fliste. Në këto rrjedhë ngjarjesh, a e pranoni që ndoshta
25 identifikimi i shoferit të makinës mund të jetë i gabuar prej

1 jush?

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj, nuk e kuptoj fare,
3 nuk e di ku është Sylejman Selimi këtu sepse është thjesht një
4 emër, Sulltani, dhe asgjë tjetër nuk thuhet.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

6 Z. TULLY: [Nuk ka përkthim]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
8 vazhdoni me pyetjen, z. Tully.

9 Z. TULLY: [Përkthim]

10 PY. Pasi ne lexuam këtë pjesën, nuk po sugjerojmë që të
11 gënjeni, por a e pranoni që identifikimi që i keni bërë ju për
12 shoferin e makinës mund të ketë qenë i gabuar në atë kohë?

13 PË. Unë nuk gënjej kurrë.

14 PY. Por mund të bësh gabim, se --

15 PË. Mund të harroj.

16 PY. Në rregull. Por, mbështetur në kaq sapa lexova, a e
17 pranoni që aftësia për të identifikuar me saktësi njerëzit që
18 ti nuk i njihje vetë, rrugës nga Qirezi për në Baicë, mund të
19 mos ketë qenë aq e saktë sa keni besuar fillimisht që të
20 ishte?

21 PË. Kjo është e mundshme. Është njerëzore. Unë s'jam rritë,
22 as kam lindë në një shtëpi me ta.

23 PY. Faleminderit, dëshmitar. Dua që të përmendim personin që
24 quhet Guri në makinë. Atëherë, do i referohem personit që e ka
25 quajtur veten Guri, por këtë person ju nuk e kishit parë

1 asnjëherë, më herët më përpara në jetën tuaj, apo jo

2 dëshmitar?

3 PË. Asnjëherë në jetën time.

4 PY. Në rregull. Për qartësi, e di që e keni thënë dhe më

5 herët, që Rexhep Selimi nuk u prezantua për ju dhe nuk e

6 prezantoi as dikush tjetër si Rexhep Selimi atë, atë ditë, por

7 në mënyrë të ngjashme askush në Qirez apo në Baicë nuk të ka

8 thënë ty se nofka e Rexhep Selimit ishte Guri, kështu?

9 PË. Jo, personi që ka qenë në makinë me mu për të cilin po

10 flasim, kur e kam pyetë "Kush je mor ti", ka thanë "Jam Guri".

11 Nuk e di kush është Guri, domethënë, sot e atë ditë --

12 PY. Në rregull.

13 PË. -- kurrë. Vetëm du me shtu --

14 PY. Po vazhdoni.

15 PË. -- që është sjellë shumë korrekt me mu, kushdo të jetë

16 kanë ai Guri. Bile ma ka ble edhe një Coca-Cola, ma ka dhanë

17 me pi se isha i etur. Edhe e falënderoj shumë, kurrë në jetë

18 nuk e harroj atë pije. Domethënë është sjellë shumë mirë me

19 mu. Kushdo të jetë kanë ai, pa marrë parasysh. A Guri, a

20 Shkëmbi, a Çeliku, a -- kushdo të jetë kanë ai, unë jam

21 mirënjohës.

22 PY. Faleminderit, dëshmitar. Flasim tek ky -- te kjo nofkë.

23 Unë shqipen s'e kam të mirë, por me sa di unë Guri do të thotë

24 në anglisht është Stone, por shqip është Guri, gur domethënë.

25 PË. Stone, Guri.

1 PY. Unë e aludova këtë, por a e dini ju që Guri nuk ka qenë
2 nofka apo *nom de guerre* që e përdorte z. Selimi gjatë luftës?

3 PË. Këto nuk e di. As nuk e di kush e ka përdorë. Se me thanë
4 të drejtën, unë nuk merrem me nofka shumë.

5 PY. Në rregull. Përpara se të vinit këtu, a keni pasur
6 mundësi ta lexoni njëherë aktakuzën që ka ngritur Prokuroria
7 kundër të akuzuarve?

8 PË. Nuk besoj që e kam lexu.

9 Z. TULLY: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, ju lutem të
10 vendosni në ekran materialin F00999, Shtojca 3 e aktakuzës,
11 paragrafi 7. Nuk më nevojitet shqipja.

12 PY. E shihni tek titulli ku thotë "Rexhep Selimi", edhe vetë
13 Prokuroria në provat e veta, në aktakuzë ka vendosur nofkën
14 apo pseudonimin për Rexhep Selimin, dhe në asnjë vend nuk
15 thuhet aty që Guri ka qenë nofka e Rexhep Selimit gjatë
16 luftës. A ju habit kjo që ju thashë?

17 PË. As unë nuk e thashë që Guri ka qenë Rexhep Selimi. Thashë
18 se nuk di kush ka qenë Guri, dhe sot e kësaj dite nuk di kush
19 ka qenë Guri.

20 PY. Mirë. Shohim emrat në ekran - që thotë "Dhjetëshi" - me
21 sa kuptoj unë, me sa shoh unë, se unë shqip nuk di, asnjë nga
22 këto këtu nuk më duket si Guri mua.

23 PË. A keni nevojë për ndonjë përgjigje?

24 PY. Po, domethënë, a ka gjasë të, ta keni keqkuptuar, apo
25 duket këtu ndonjë emër të jetë Guri në këtë tekst? A lexohet

1 ndonjë emër si Guri?

2 PË. Jo, nuk shoh në këtë tekst Guri. Unë vetëm thashë çka më
3 kujtohet ndoshta dhe kam harru, është përzi, po çka më
4 kujtohet për afërsisht, personi që ka bisedu me mu në makinë më
5 ka thanë që "Jam Guri". Edhe nuk më ka interesu. Kam,
6 domethënë, nuk jam marrë.

7 Unë kam mendu se krejt ky rast për të cilin po flasim
8 këtu, do të jetë një proces i kundër herës nuk jam jurist unë,
9 edhe përfundon me fshaq [fonetikiisht] domethënë, me -- po jo
10 pse vjen kjo ditë e zezë për Kosovën e për mu, edhe për UÇK-në
11 edhe për krejt. Mirëpo duhet me e kalu edhe këtë, duhet me i
12 sqaru disa gjana. Është e nevojshme me i kalu.

13 PY. Nuk dua t'ju ndërpres, por thjesht dua të fokusohem tek
14 kjo pjesë.

15 Sidoqoftë, unë dua t'ju tregoj për këtë nofkën Guri, që
16 keni thënë ju. Ky ka qenë një nofkë goxha e njohur në UÇK.
17 Përdorej edhe në zonat pranë, pra në zonat ku ndodhën këto
18 ngjarje në 1998, madje ka pasur një njësi, është përdorur dhe
19 në njësitet në Baicë. Unë do të tregoj disa dokumente, nuk janë
20 të gjitha në shqip, do të përpiqem që t'i kalojmë sa më
21 shpejt, por thjesht ndiqni në ekran.

22 Z. TULLY: [Përkthim] Ju lutem, Sekretare, të vendosim
23 08322-TR-ET Pjesa 5 [sipas përkthimit], faqja 12. Shqipja
24 është në faqen 13, rreshtat 7 dhe 14.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj që t'i shfaqet ky

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 81

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 dokument dëshmitarit. Besoj se ky është një dokument objekt i
2 masave mbrojtëse.

3 Z. TULLY: [Përkthim] Po nuk thuhet këtu emri i
4 dëshmitarit.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Por ka informacione të tjera që
6 identifikojnë dëshmitarin dhe nuk duhen zbuluar.

7 Z. TULLY: [Përkthim] Atëherë mbase nuk do ia tregoj
8 dëshmitarit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lexojani ju.

10 Z. TULLY: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, do ju lexoj një intervistë që ka dhënë një
12 anëtar tjetër i UÇK-së dhe thotë:

13 "Kam arrestuar një person me mbiemrin Guri, ishte shefi i
14 inteligjencë, shërbimit sekret. E kam emrin këtu."

15 Nuk po e lexoj emrin.

16 "Është ende gjallë, është ende gjallë. Ka qenë komandant
17 i shërbimit informativ me nofkën Guri".

18 Pra ky është një shembull që nofka Guri përdoret.

19 PË. Po emri Guri është përdoret dhe ka emra plot Guri te
20 shqiptarët. Gurakuqi, Guraziu, Guri, domethënë, edhe ka mujtë
21 edhe mbrenda UÇK-së me pasë plot me nofka Guri e nuk jam ai që
22 ka mbajtur këto evidenca.

23 PY. Mirë, po vazhdoj pak përpara.

24 Z. TULLY: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund të
25 kalojmë në seancë private për këtë? Sepse dua të përdor emrin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825(Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 82

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 e një personi dhe nuk e di a është e përshtatshme që këtë emër
2 ta përdor në publik.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
4 seancë private.

5 ~~{Seancë private}~~[Seancë e hapur] Riklasifikuar në
6 bazë të F2133RED

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

7 Z. TULLY: [Përkthim] Do kem kujdes me emrin.

8 Bëhet fjalë për dokumentin 058280-TR-ET Pjesa 6, faqet 4
9 dhe 5. Kalojmë në faqen tjetër. Ju lutem, të kalojmë në faqen
10 tjetër, ju kërkoj ndjesë.

11 PY. Këtu thuhet:

12 "Besoj se asokohe përdorja pseudonimin Gurin."

13 Ky është një intervistë me z. Sali -- nga Brigada 136 në
14 Dukagjin.

15 "Dhe besoj se unë e kam pasur pseudonimin Guri.

16 "Po, pseudonimin Guri e përdorja shumë rrallë", thotë.

17 Z. TULLY: [Përkthim] Tani të shkojmë tek dokumenti me
18 numër R091-4443.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na jepni dhe
20 një herë numrin?

21 Z. TULLY: [Përkthim] Po, është dokumenti me 091 --
22 40914443 [sipas përkthimit. Shkojmë më poshtë.

23 PY. Shikoni më poshtë një person me emrin Jetullah Qarri?

24 Edhe këtu nofka e tij, pseudonimi i tij është Guri. E shikoni,
25 dëshmitar?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825(Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 83

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 PË. Po, por nuk e njoh, s'di për kënd bëhet fjalë.

2 PY. Pa problem. Kam dhe dy dokumente të tjera që dua t'ju
3 tregoj.

4 Z. TULLY: [Përkthim] SPOE00049154 deri në 49159, në faqen
5 49154. Shkojmë te pika e).

6 PY. Dhe këtu, te paragrafi këtu thuhet:

7 "Mund të jetë Fadil Qadraku me nofkën Guri, nga fshati
8 Vrshevc. Aktualisht jeton në Prishtinë, Rruga Germija."

9 E shihni pra këtu, edhe një person tjetër me nofkën Guri?

10 PË. Po.

11 Z. TULLY: [Përkthim] I lutem Sekretares tani të shohim
12 dokumentin ERN 0809 [sipas përkthimit] 0837 [sipas përkthimit]
13 në faqen 082987.

14 PY. Diku nga mesi i faqes, fillon fjalia -- ky është vëllai i
15 Fadil Qadrakut, për të cilin sapo folëm. Ai thotë:

16 "Më pas shkova në Baicë tek xhaxhai im Veliu, Veli
17 Bahtjari -- tek xhaxhai im Veli Bahtjari për t'i thënë atij që
18 kisha gjetur familjen."

19 Shikoni pra që edhe ky, zotëri, kishte lidhje familjare,
20 farefisnore në Baicë?

21 PË. E shiqoj, ama ide s'kam se kush është ky njeri.

22 PY. Nuk ka problem. Do ju tregoj dhe një dokument. Edhe pasi
23 të shkojmë në dokument do ta mbyll këtë temë.

24 Ka qenë edhe një njësit që njihej si Guri 1, që ishte
25 pjesë e togës së UÇK-së në Baicë. Dhe do ju tregoj që z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 84

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 Selimi s'ka pasur asnjë lloj lidhje me këtë në fakt.

2 Z. TULLY: [Përkthim] Prandaj, do ju lutesha që në ekran
3 të shfaqet dokumenti me numër 0979 në 0959 [sipas përkthimit]
4 në faqen 09581 [sipas përkthimit] njësoj dhe shqipja dhe
5 anglishtja.

6 PY. Në krye të faqes thotë:

7 "Shtabi -- "

8 Në krye thotë:

9 "Shtabi është i njësitit Guri 2 [sipas përkthimit]".

10 Domethënë nuk është nevoja që ta dini, por thotë:

11 "Shtabi është pjesë e njësitit Guri 2 [sipas përkthimit]"

12 "Shtabi i Baicës dhe Testernikut -- është pjesë e
13 kompanisë Guri 1".

14 E shihni? A e shihni?

15 PË. S'kam ide. Nuk e di kush janë këta.

16 PY. Dhe një dokument tjetër.

17 Z. TULLY: [Përkthim] U000-7755-ET [sipas përkthimit]
18 është dokument me një faqe.

19 PY. Është komandanti i këtij njësitit, edhe është i vendosur
20 në Baicë. E shihni, e shihni këtë dokument përpara?

21 PË. Po, e shoh.

22 PY. Jahir Dumaku është komandanti, më falni. Dëshmitar, ju
23 tregova disa dokumente. Dhe këto ishin shembuj dhe ju në fakt
24 e kuptuat besoj çfarë desha të thoja unë. Që nofka Guri ishte
25 e përhapur mes anëtarëve të UÇK-së dhe kishte më së paku një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 85

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 njësit që operonte në atë zonë gjatë luftës me këtë nofkë, me
2 këtë emër.

3 Kështu që mund të ketë shumë mundësi kush ka qenë ky
4 person, që është prezantuar si Guri. Mund të ketë qenë dhe
5 ushtar që i përkiste njësitet Guri, mund të ketë qenë dhe
6 komandant i njësitet Guri, apo jo?

7 PË. Unë nuk i njof këta, çka m'i prezantove, deri tash kurrë
8 s'kam dëgju për ta.

9 PY. Por, qëllimi, pika im është kjo. Ka shumë të ngjarë që ky
10 personi me nofkën Guri të jetë dhe anëtari i njësitet Guri,
11 komandanti i njësitet Guri. Dhe ky mund të jetë personi që ka
12 qenë me ju në makinë. Pra, a e pranoni këtë si hipotezë?

13 PË. Po, gjithçka është e mundshme, domethënë, mundet. Po unë,
14 unë këta njerëz për të cilët ju i përmendni, i vendos në
15 ekran, unë kurrë s'kam dëgju për ta dhe as i njoh.

16 PY. Nuk ka problem, nuk është kjo me rëndësi e njihni apo jo,
17 apo e keni dëgjuar. Po a e pranoni mundësinë që personi që ka
18 qenë në makinë me ju mund të mos ketë qenë z. Selimi?

19 PË. Unë nuk thashë, unë e thashë vetëm edhe për vete nuk jam
20 i sigurt 100 për qind a jam unë sot këtu. Se edhe sinqerisht
21 s'është ka më besohet që jam këtu. Hiç, krejt. Ëndërr është ka
22 më duket. Edhe pse prapë du me protestu se keni shku në seancë
23 të hapur. Më keni vu në rrezik familjen time edhe mu, edhe të
24 ardhmen time edhe të mbesave e nipave të mi, edhe kjo nuk
25 është shumë njerëzore, humane. Por na jena mësu me sakrifica

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 86

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 familjare dhe le të vazhdon deri në fund. Ajo është temë
2 tjetër. Por këtu çka du me thanë, du me qenë i singertë,
3 domethënë, --
4 PY. Në rregull, faleminderit.

5 Z. TULLY: [Përkthim] Dëshmitari, në fakt, sapo më kujtoi
6 që jemi në seancë private. Duhet të ishim në seancë publike.
7 Faji im.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbaruat me
9 pyetjet që kishit në seancë private?

10 Z. TULLY: [Përkthim] Po, mbarova.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
12 seancë publike.

13 ~~{Seancë e hapur}~~

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

15 Z. TULLY: [Përkthim]

16 PY. Në rregull, dëshmitar. Jemi në seancë publike. Tani do
17 flas për ngjarjet në Baicë. Fillimisht për kontekst, sa i
18 takon gjendjes tuaj shpirtërore atëherë, ju keni folur, kur
19 keni folur me EULEX-in, që është në provën materiale P680, në
20 faqen 034259, kujtesa juaj për atë që ka ndodhur specifikisht
21 në Baicë, veçanërisht për kacafytjet, ju kujtohet që ju keni
22 thënë që keni qenë i tronditur, keni qenë i tronditur kur kanë
23 ndodhur këto kacafytje, kështu është?

24 PË. Po çdo njeri normal edhe me ia thanë një fjalë të keqe
25 tronditet, edhe ndoshta me e shiku keq.

1 PY. Dhe kjo tronditje sigurisht ndikoi në kujtesën tuaj, sa i
2 takon hollësive apo detaleve për atë kacafytje. A mund të
3 themi që ndikoi kjo?

4 PË. Jo. Kujtesën, edhe shpirtin tim, edhe zemrën time, e ka
5 shkatërru e dëmtu Serbia. Edhe këta me më zemër [fonetikiisht]
6 dikund se nuk po e besoni. Me bo me ditë si, sa, qysh, ma merr
7 mendja se ju kishë ardhë të gjithëve, çka jeni në këtë dhomë,
8 keq.

9 PY. E kam fokusin tek ajo që ka ndodhë në shkollë, në Baicë.
10 Dhe a i mbani mend ju ato detaje apo jo? Dhe unë do ju citoj,
11 do ju lexoj diçka nga intervista që i keni dhënë në 2018
12 Prokurorisë. Nuk është nevoja të shfaqet në ekran. Ju keni
13 thënë:

14 "Asnjëherë nuk e kam analizuar saktësisht ato dy minuta."
15 Dhe e keni fjalën për kacafytjen që ka ndodhur atje. "Sepse,
16 ua them sinqerisht nuk po më funksiononte më truri në ato
17 momente."

18 A është e saktë kjo?

19 PË. Kjo është e vërtetë. Edhe çdo njeri normal, domethënë, që
20 është njeri në atë moment ndoshta edhe me pasë forcën e Mike
21 Tyson fizike, ka mujtë mos me i funksionu truni.

22 PY. Ju keni këmbëngulur për këtë qysh në 2014, se ia keni
23 thënë edhe EULEX-it. Dhe më korrigjoni nëse e kam gabim. Është
24 reflektuar në provën materiale P680. Keni thënë:

25 "Truri s'po m'i kapte të gjitha këto. Dhe nuk mund jua

1 tregoj të gjitha ato që kanë ndodhur atje."

2 Dhe këtu i referoheni kacafytjes dhe keni këmbëngulur, i
3 keni mëshuar fort kësaj pike qysh në 2014, a është kështu?

4 PË. Domethënë, ka qenë edhe sot e vështirë për mu me i
5 paramendu edhe me i kujtu -- edhe me i fresku, edhe me i thanë
6 të sakta detalet, se ka qenë rrufeshëm ajo çka ka ndodhë. Ka
7 qenë, gati ka qenë natë. Ka fillu me u errësu. Edhe këto
8 pyetje po më, në fakt janë presion ndaj meje. Edhe ndaj
9 familjes time.

10 PY. Flasim tani për praninë e personit që u prezantua si Guri
11 gjatë kacafytjeve, edhe EULEX-i dhe Prokurori kanë bërë pyetje
12 për këtë.

13 Ditën e hënë ju treguan një fragment të intervistës së
14 EULEX-it të 2014 dhe Prokurori ju kishte bërë një pyetje për
15 diçka që kishit thënë në atë intervistë. Është e reflektuar në
16 transkriptin e 6 nëntorit 2023 kjo, në faqen 9872-9387. Unë do
17 ju lexoj çfarë ju pyetën. Prokurori ju pyeti:

18 "Ju thoni, ju pyetën nëse ka qenë Rexhep Selimi atje dhe
19 përgjigja juaj ishte:

20 "Ai ka qenë atje, por unë kam qenë i tronditur. Asnjëherë
21 s'më kishin rrahur përpara.

22 Këtu i referohet dëshmisë që i keni dhënë EULEX-it, pra
23 thatë këtu thuhet që sapo jeni rrahur.

24 "Kur pashë disa nga shokët e mi të gjakosur që ishin
25 deputetë, anëtarë të kryesisë, s'po mi kapte truri të gjitha

1 këto, kështu që s'mund t'jua tregoj të gjitha gjërat që kam
2 parë.

3 "A ka ndodhur vërtet kjo?"

4 Dhe ju vazhdoni të përgjigjeni, ja pyetja -- ky ishte
5 vetëm konteksti. Do bëj dhe pyetjen. A ju kujtohet që
6 Prokuroria ju tregoi këtë pjesë të deklaratës që i keni dhënë
7 EULEX-it në 2014?

8 PË. Të lutem, tërheqë fjalën "rrahje". Mu s'më ka rrahë
9 askush, edhe me ju thanë të drejtën mu s'mund më rrah askush.

10 PY. E kuptojmë këtë, dëshmitar. E kuptojmë...

11 PË. Jo, nuk po më kupton.

12 PY. Po këto janë fjalët që ka përdorur Prokuroria, s'po i
13 përdor unë --

14 PË. Dëgjo, s'ka lidhje.

15 PY. -- unë po i lexoj, unë po lexoj çfarë është thënë.

16 PË. -- s'ka lidhje kush i ka përdorë, pse i ka përdorë, në
17 çfarë konteksti. Kam thanë se Rexhep Selimi, nëse ka qenë
18 Rexhep Selimi, domethënë, na ka kthyer letërnjoftimet në Baicë.
19 Është sjellë --

20 PY. Ju lutem --

21 PË. -- jo, jo, është me rëndësi.

22 PY. -- ju lutem, ndaloni një çast.

23 PË. -- mos ma përzi --

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.

25 Dëshmitar. Ju lutem, përgjigjuni pyetjes. Po jepni më shumë

1 informata nga ç' duhen.

2 Z. TULLY: [Përkthim]

3 PY. Po ju pyes kaq: A ju kujtohet që ju treguan një pjesë të
4 intervistës, dhe ju lexuan një pjesë të intervistës ku kishte
5 pyetje-përgjigje? A ka qenë Rexhep Selimi atje? Dhe ju keni
6 thënë:

7 "Ka qenë atje, por kam qenë i tronditur."

8 Unë po ju pyes këtë, a mbani mend që ju bën këtë pyetje?

9 PË. Po. Kush nuk ka qenë i tronditun? Domethënë --

10 PY. E kuptoj këtë, dëshmitar --

11 PË. [Folës që flasin njëkohësisht] -- ju lutena mos bani
12 pyetje që i dini edhe -- veç provokuese --

13 PY. -- dëshmitar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
15 duhet të prisni patjetër që të përfundojë pyetja përpara se të
16 përgjigjeni, sepse ndërprisni edhe folësit.

17 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Për referencë, para se të vazhdojmë, referenca e
19 dokumentit që ka përdorë Prokuroria është prova materiale 680
20 në faqen 034259.

21 Kur ua bëri këtë pyetje të hënën Prokuroria, ata nuk ju
22 treguan faqen e radhës të së njëjtës intervistë nga 2014 kur
23 ju kanë bërë fiks të njëjtën pyetje, dhe përgjigjja juaj është
24 e ndryshme nga ajo që ju është treguar ditën e hënë. Dhe unë
25 këtë do t'ua lexoj.

1 Z. TULLY: [Përkthim] Është prova materiale P680, në faqen
2 P034260, dhe do të doja që ky dokument të shfaqej në ekran.
3 Shqipja është me numrin 034277. Është drejt fundit të faqes
4 tek anglishtja.

5 PY. Është një pyetje që ju ka bërë dhe ju është treguar të
6 hënën.

7 "Z. Selimi ka qenë në atë dhomë në atë kohë?"

8 Bëhet fjalë pas kacafytjeve. Ju jeni përgjigjur:

9 "Nuk jam i sigurt nëse është larguar nga dhoma për t'u
10 maskuar dhe për t'u kthyer prapë në dhomë. Nuk mund të jem i
11 sigurt."

12 Dëshmitar, e patë këtë në ekran besoj?

13 PË. Po.

14 PY. A nuk është e vërtetë që në 2014, sikurse nuk mund ta
15 thoni sot me siguri, që personi me emrin z. Selmi ka qenë
16 vërtet në dhomë kur ka ndodhur kjo kacafytje, pra a është e
17 vërtetë?

18 PË. Jo, ai nuk ka qenë në dhomë në momentin kur ka ndodhë
19 kacafytja. Thashë na ka kthy letërnjoftimet dhe kam thanë edhe
20 dje, edhe në seancën përgatitore, dhe nuk e di ku ka shku.
21 Kështu kam thanë. Edhe kjo është e vërteta.

22 Edhe kam thanë, që ju s'di a keni harru, as [REDAKTUAR],
23 as Rexhep Selimi, as Hashim Thaçi nuk kanë qenë në grupin e
24 huliganëve që janë sjellë keq me ne. Këtë e kam thanë, dhe kjo
25 është 100 për qind e vërtetë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 92

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 PY. Dhe e kisha në fakt pyetje të radhës. Sepse UNMIK-u e ka
2 dokumentuar sikur ua ke thënë në 2001, por kur ju kanë pyetur
3 në 2014 nëse ka qenë i pranishëm z. Selimi në dhomë kur
4 ndodhën kacafytjet, ju nuk e përsëritët më akuzën që Sabit
5 Geci, Hashim Thaçi dhe Rexhep Selimi panë përmes derës
6 ndërkohë që po ndodhnin këto kacafytje. Pra në 2014, nuk e
7 keni thënë më këtë, dëshmitar, apo jo?

8 PË. Mu m'u ka dashtë kohë, edhe vite, që mos tham dekada,
9 ndoshta edhe sot më duhet edhe prapë kohë, me ditë të vërtetën
10 e kësaj ngjarje, këtij incidenti, që u bo skandaloz, por në
11 fakt ka qenë një incident minor, normal, sikur ndodh në
12 parlamentet e Kosovës, edhe në parlamentet e Evropës.

13 PY. Lidhur me këtë pikë, duke pasur parasysh çfarë diskutuam,
14 nuk është për t'u habitur që askush nga delegacioni që ka
15 dhënë deklaratë, pra askush nuk ka thënë nga delegacioni që ka
16 qenë i pranishëm z. Selimi apo ndokush tjetër në dhomë, duke
17 verifikuar letërnjoftimet, ndërkohë që kishte kacafytje mes
18 delegacionit dhe anëtarëve të UÇK-së. Pra nuk është për t'u
19 habitur fakti që s'e ka thënë njeri këtë.

20 PË. Jo, nuk është për t'u habitur, edhe unë po e ritheksoj se
21 në atë moment nuk ka qenë në dhomë Rexhep Selimi.

22 PY. Flasim për temën që e kemi diskutuar disa herë. Bëhet --
23 momenti që ju kanë kthyer letërnjoftimet. Kur keni folur me
24 EULEX-in në 2014, ju keni thënë që letërnjoftimet ua ktheu një
25 person që ju menduat që ishte Rexhep Selimi, më 20 shtator, në

1 një klasë ku ishte gjithë delegacioni. Ndërsa dje thatë që
2 ishte ky personi me nofkën Guri që ua ktheu letërnjoftimet në
3 korridorin, në hollin e shkollës, përpara se të ndodhnin
4 kacafytjet. A ju kujtohen këto përgjigje?

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] A mund të na jepni edhe faqet
6 përkatëse?

7 Z. TULLY: [Përkthim] Patjetër. Është deklarata e EULEX-it
8 në faqet 34268 në anglisht dhe 34286 në shqip. Ju kërkoj
9 ndjesë, por për transkriptin e djeshëm nuk e kam ende
10 referencën, por mund t'ju jap pak më vonë.

11 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që i dhatë këtë përgjigje?

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, e kam pak merak se ju përdorët
13 emrin "Guri", por unë nuk -- nuk më kujtohet që ta këtë
14 përdorur ai emrin Guri prandaj po kërkoja dhe citimin konkret.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

16 Z. TULLY: [Përkthim]

17 PY. Dëshmitar, a ju kujtohen këto pyetje-përgjigje? Nuk po
18 themi, nuk po ju them kush ua kthemi [sipas përkthimit], por
19 kur ua kthyen në klasë apo në korridorin a hollin e shkollës,
20 në 20 shtator?

21 PË. Në hollin e shkollës. Dhe nuk kam përmendë unë aty Guri
22 asnji pseudonim, asnji nofkë. Dhe me sa më kujtohet mu, sa kam
23 unë mundësi që mund të jem edhe gabim, ai person që kam thanë
24 edhe tash po e rikonfirmoj, me mirësjellje, me respekt, me
25 fjalë të mira, dhe keqardhje, na ka kthy letërnjoftimet, unë

1 kam mendu që është Rexhep Selimi. As kam thanë Guri, as në
2 seancë përgatitore, as dje, as sot, sa nuk e them as nesër,
3 asnjherë.

4 PY. Dëshmitar, bëhet fjalë për të njëjtin person me të cilin
5 ke biseduar në makinë, që është prezantuar si Guri. Se ti the
6 që nuk ka ardhur një person tjetër i dytë. Kështu që personi
7 që ju ka dhënë letërnjoftimet mbrapsht është i njëjti person
8 me të cilin ti ke folur në makinë që ke thënë që është Guri,
9 kështu?

10 PË. Unë mendoj se i njëjti njeri që ka qenë në makinë me mu
11 përpos shoferit, ai person edhe na ka kthy me mirësjellje,
12 edhe në makinë është sjellë shumë mirë, edhe na ka kthy
13 letërnjoftimet. Unë këtë kam thanë, edhe këtë po them, edhe
14 këtë edhe do ta them gjith... --

15 PY. Kaq mjafton, në rregull. Këtë po them dhe unë. Nuk po
16 them që keni thënë emrin Guri, thjesht po them që është i
17 njëjti person. Sepse në fakt ky është i vetmi emër me të cilin
18 keni prezantuar këtë person, prandaj ndonjëherë përdor emrin
19 Guri.

20 A e kuptoj drejt që ju po thoni që letërnjoftimet në atë
21 kohë ju kthyen të gjithë delegatëve, jo vetëm juve, por të
22 gjithë delegatëve që ishin aty në atë dhomë, është e saktë
23 kjo?

24 PË. Po. Ne -- ju kanë kthy të gjithëve deputetëve.

25 PY. Të gjithëve ju kthyen më 20 shtator 1998, kur ishit në

1 shkollë, kështu?

2 PË. Kur ishim në hollin e shkollës, të gjithëve.

3 PY. Ka edhe persona të tjerë në delegacion të cilët kanë

4 dhënë deklaratat lidhur me kohën se kur janë dhënë

5 letërnjoftimet. Dua që të përqendrohemi gjithashtu edhe për

6 shokun që keni pësuar edhe aftësinë për të mbajtur mend apo

7 jo, nuk është se po ju akuzoj për tjetër gjë. Por thjesht dua

8 që t'ju tregoj për deklaratat e të tjerëve, se askush tjetër

9 që ka qenë pjesë e delegacionit nuk ka thënë që letërnjoftimet

10 janë kthyer në holl të shkollës apo në klasë më datë 20

11 shtator. Atëherë, do t'ju lexoj pjesën që kanë thënë

12 dëshmitarët e tjerë, ose delegatët e tjerë.

13 Për shembull, Kurtesh Devaja, që ka dhënë deklaratë, ai

14 thotë që letërnjoftimet i janë dhënë grupit në një lëndinë

15 rrugës për në Krajsmirovç. [REDAKTUAR] është [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR] faqja 226 [sipas përkthimit].

17 Simon Augustini thotë që letërnjoftimet janë dhënë në

18 oborr të shkollës ditën kur është liruar delegacioni. Dhe kjo

19 ka qenë më datë 22 shtator. Për procesverbal bëhet fjalë për

20 dokumentin 034403 deri në 34441, në faqen 34417.

21 Ndërkohë që Jusuf Telaku thotë që letërnjoftimet i janë

22 kthyer delegacionit në shtëpinë ku shkuan në Krajsmirovç, në

23 shtëpinë e Ismet Mehmetit, në Çiçavicë.

24 Edhe një herë, nuk është se ju akuzoj se po gënjeni këtu,

25 nuk po gënjeni askënd. Por po them që kemi katër dëshmi të

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 96

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 ndryshme, katër ditë të ndryshme, dhe të dhëna të ndryshme nga
2 ato që i keni dhënë juve hetuesve sa i takon momentit të
3 kthimit të letërnjoftimeve. A e pranoni juve, ndërkohë që ju
4 lexova këto fragmente nga dëshmitë e të tjerëve, që askush nga
5 ju nuk e kujtoni qartë se kur ju janë kthyer letërnjoftimet
6 mbrapsht?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

9 Z. TULLY: [Përkthim]

10 PY. A e pranoni mundësinë që mund të keni bërë një gabim në
11 dëshminë tuaj sa i takon kohës kur ju janë kthyer
12 letërnjoftimet?

13 PË. Çdo njeri i gjallë gabon, por unë jam i bindun, dhe ashtu
14 mendoj. Në radhë të parë nuk e di çka kanë deklaruar dëshmitarë
15 të tjerë, se me asnjënin s'kam komunikuar, as i kam pyetë. Sot
16 po dëgjoj për këto gjana. Unë mendoj se letërnjoftimet na i
17 kanë dhanë në hollin e shkollës në, shkollës Migjeni, në
18 Baicë.

19 PY. Në rregull. Do vazhdoj më tej, do diskutojmë për diçka
20 tjetër që keni thënë në dëshminë tuaj, që përshkruani dikë që
21 ishte ulur te karrigia e mësuesit në klasë. A është dëshmia
22 juaj ende dhe tani që kur u çuat në Baicë, kur shkuat në
23 Baicë, ishte një person, pa identifikuar personin, një person
24 ishte ulur në fillim të klasës, në vendin e mësuesit. Dhe
25 kishte këto kartat tuaja, letërnjoftimet tuaja?

1 PË. Është e vërtetë.

2 PY. Është e vërtetë. A do habiteshit në qoftë se do ju thoja
3 që askush nga delegacioni nuk përshkruan një person që ishte
4 ulur në fillim të klasës që shikonte letërnjoftimet, siç keni
5 pretenduar ju? Pra askush tjetër s'e ka thënë këtë nga
6 delegacioni.

7 PË. Unë flas vetëm për vete. Unë jam përgjegjës vetëm për
8 veprat e mia para çdo ligji dhe para çdo dhome. Nuk mund me i
9 interpretue qëndrimet e të tjerëve. Unë kam pa një person që
10 është ulë në karrigë vetëm ndërsa na kena qenë në anën e
11 kundërt të tij. Edhe kjo është ajo çka mund t'ju them.

12 PY. Në rregull.

13 Z. TULLY: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqesë
14 [REDAKTUAR] faqet 34455 në ekran, të lutem.

15 Ndërkohë faqja në shqip mban numrin 34486 deri në 34487.

16 PY. Jepet një përshkrim nga Kurtesh Devaja për momentin kur
17 dërgoheni në klasë. Dhe këtu jepet dhe thuhet:

18 "Kur dolëm nga makina pamë ushtarët të cilët kishin
19 veshur, kishin vënë maska të zeza. Nuk njohëm asnjërin prej
20 tyre, por ata thjesht kishin maska dhe kishin emblemat e UÇK-
21 së në armë [sipas përkthimit].

22 "Ku ju çuan pastaj?

23 "Na futën në një klasë të mësimit në atë ndërtesën e
24 shkollës.

25 "Ju kujtohet sa ka qenë ora kur mbërritët aty?

1 "Ora ka qenë përafërsisht 4 e pasdites. Ishte kjo para se
2 të errësohej.

3 "Çfarë ka ndodhur kur ishit në klasë?

4 "Në klasë të mësimit kemi kaluar 10-15 minuta. Të gjithë
5 kemi qenë të hutuar dhe gjatë gjithë kohës shpresonim që nuk
6 do të -- që do të na lejonin që të shkojmë.

7 Siç mund ta shikoni nga ky paragrafi, dëshmitar, z.

8 Devaja nuk përmend asgjë për sa i takon letërnjoftimeve këtu.

9 PË. Është e drejtë e tij. A jeni ka më pyetni mu çka unë
10 mendoj, a jeni ka më pyetni çka ka mendu e çka mendon Kurtesh
11 Devaja?

12 PY. E kuptojmë. Nuk do e tregoj pjesën tjetër në ekran,
13 thjesht do të e lexoj për të qenë më e thjeshtë. Do ju lexoj
14 një pjesë të dëshmisë që ka dhënë Jusuf Telaku, për referencë
15 është dokumenti 034353 deri në 034402, në faqen 034372. Ai
16 flet rreth momentit kur çohen në Baicë. Ai thotë:

17 "Anëtarët e delegacionit zor se thanë asgjë. Erdhi një
18 pikë kur dikush erdhi në dhomë dhe tha, e dini kush jam unë?
19 Askush nuk tha asgjë, as unë. Unë nuk njoha askënd nga
20 personat që erdhën aty."

21 Edhe në këtë rast nuk përmendet asnjë person që ishte
22 ulur në fillim të klasës.

23 Tani do të vazhdojmë me leximin e deklaratës që i ka
24 dhënë z. Agim Krasniqi EULEX-it. Për procesverbal është
25 dokumenti 34504 deri në 034573 në faqen 034511. Agim Krasniqi

1 thotë si më poshtë:

2 "A mund të na tregoni se çfarë ndodhi kur ishit në atë
3 klasë?

4 Dëshmitari thotë:

5 "Të gjithë ishim ulur aty, edhe papritmasi një grup
6 njerëzish që nuk i njihnim fare erdhën përpara nesh.

7 "A ishin të gjithë me uniformë këta persona?

8 "Besoj që të gjithë kishin uniforma.

9 "A ishin UÇK?

10 "Ishin të armatosur?

11 "Jo.

12 Prokurori thotë:

13 "Çfarë ndodhi më pas?

14 Z. Krasniqi thotë:

15 "Po. Arsyeja për ndalimin aty në atë dhomë ishte që ne
16 ishim futur në një territor që ishte nën mbikëqyrjen dhe
17 kontrollin e UÇK-së pa informacion paraprak dhe pa marrë leje.
18 Ky ishte justifikimi se pse na mbajtën të ndaluar aty."

19 Edhe në rastin e z. Krasniqi nuk përmendet asnjë person
20 që ishte ulur në fillim të klasës, apo jo?

21 PË. Ky është versioni i tij.

22 PY. Në rregull. Në fund fare, një person i fundit, është

23 [REDAKTUAR] Mehdi Bardhit, [REDAKTUAR] është [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR] në faqen 034323 deri në 034324, ai thotë:

25 "U futëm në shkollën në Baicë. Ishte drejt mbrëmjes."

1 Prokurori pyet:

2 "Ishte errësirë?

3 "Dëshmitari: Nuk e mbaj mend mirë, por duhet të ketë qenë
4 errësirë.

5 "Prokurori: Çfarë ndodhi më pas?

6 "Dëshmitar: U futëm në godinën e shkollës... u dërguam në
7 një shkollë dhe aty erdhën katër pjesëtarë të UÇK-së me maska
8 dhe me armë. Ata na thanë, 'Do t'ju intervistojmë, hajdeni,
9 çohuni'. Dhe i pari që shkoi, mendojmë, besoj që ishte
10 Gjergji".

11 Përsëri, edhe në rastin e këtij dëshmitari nuk përmendet
12 askush, asnjë person që ka qenë në fillim të klasës i ulur. E
13 shikoni këtë, dëshmitar?

14 PË. Dhe kjo është versioni i tij.

15 PY. Në rregull -- ka edhe shumë --

16 PË. Unë jam këtu me dhanë versionin tim.

17 PY. -- të tjerë. Në rregull, dëshmitar. Pra ka pasur dhe
18 persona të tjerë që kanë qenë bashkë me ju në atë sallë, në
19 atë dhomë. Bëhet fjalë për të njëjtin ngjarje, por askush
20 tjetër nuk përmend faktin që ka qenë një burrë i ulur në krye
21 të klasës. A e pranoni mundësinë që mbase mund të keni gabuar
22 dhe mbase mund të mos ketë pasur ndonjë person në krye të
23 kasës siç e keni përshkruar juve?

24 PY. Unë thashë që të gjithë jemi njerëz, edhe s'ka njeri në
25 këtë botë që s'gabon. Edhe robotat nganjëherë gabojnë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 101

Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 Domethënë, por unë po flas çka unë kam mbajtur mend, që mund të
2 jetë, domethënë, e harrume. Unë po flas vetëm çka mbaj mend.
3 Nuk i interpretoj të tjerët çka thojnë, se ju përmendët katër
4 dëshmitarët që kanë dhanë katër varianta të ndryshme.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully, ju
6 lutem, pak më ngadalë flisni sepse është e vështirë t'ju kapin
7 përkthyesit.

8 Z. TULLY: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

9 PY. Në rregull, dëshmitar. Do t'ju bëj dhe një grup tjetër
10 pyetjesh përpara se sa të kalojmë tek tema e fundit që dua të
11 shtjelloj me juve sot. Sërish ka të bëjë me ngjarjet në Baicë.

12 Në intervistën me EULEX-in ju keni folur lidhur me një
13 ndërveprim, apo bisedë që pretendoni që të ketë ndodhur
14 ndërmjet personit që ju thoni që ka qenë ulur në krye të
15 dhomës, që e keni identifikuar si Rexhep Selimi. Do ju lexoj
16 një pjesë, një paragraf.

17 Për procesverbal, është marrë nga intervista juaj e 2014,
18 faqja është 034236 deri në 034287, faqja 0348258, konkretisht.
19 Prokurori ju pyet:

20 "Kur ishit në shkollë, kë njohët?

21 Ju thoni:

22 "Ata na futën në një klasë me tavolina. Rexhep Selimi u
23 ul në vendin ku ulet zakonisht mësuesi, së bashku me
24 letërnjoftimet. Ai tha si ka mundësi që ju të gjithë jeni
25 profesorë, intelektualë, si ka mundësi që keni ardhur këtu?

1 Ju thoni që jeni përgjigjur që:

2 "... ju kishit shkuar atje si anëtarë të misionit
3 humanitar dhe duke bërë këtë gjë kishit vënë në rrezik jetën
4 tuaj. Dhe mendonit në fakt që jeta juaj ishte në rrezik nga
5 serbët, jo nga UÇK-ja".

6 A ju kujtohet --

7 PË. Vetëm nga --

8 PY. -- t'ia keni thënë këtë EULEX-it në 2014, dëshmitar?

9 PË. -- vetëm nga serbët ishte jeta jonë në rrezik. Bile edhe
10 këtu me këtë pyetje po ma rrezikoni prapë jetën nga serbët.

11 Serbët janë të gatshëm me ba gjithfarëlloj triakash edhe
12 sajimesh siç edhe kanë bo edhe për këtë gjykatë, domethënë,
13 për me mujtë me --

14 PY. Dëshmitar, këto janë fjalët që keni thënë ju në një
15 deklaratë të EULEX-it, nuk është se po e sajoj unë. Por këtë
16 besoj e keni thënë te EULEX-i. A ia keni thënë EULEX-it?

17 PË. Po, në EULEX -- edhe në EULEX kam thanë që ishim të
18 rrezikumë na në këto vizita, kemi qenë të rrezikumë nga
19 serbët. Edhe ashtu jemi nisë. E kena pranë atë rrezik.

20 PY. Mendoj që e kuptoni se ku e kam thelbin këtu, sepse në
21 qoftë se e keni thënë që ky person ka qenë në krye të dhomës,
22 të klasës, sepse në qoftë se do keni thënë që "Ne mendonim që
23 jeta jonë është në rrezik nga serbët, jo nga UÇK-ja", besoj që
24 ka qenë pak dramatike situata, apo jo? Në qoftë se do e keni
25 thënë, në qoftë se e keni thënë, gjithmonë.

1 PË. Jeta jonë ka qenë gjithnjë, për aq sa mbaj mend, që kam
2 lindë e kam fillu me u rritë me mbajt mend deri më sot, ka
3 qenë e rrezikume jeta jonë e familjes sime vetëm nga serbët.

4 PY. Por këto fjalët që janë të regjistruara këtu, në 2014, në
5 qoftë se ju i keni thënë vërtet këto fjalë për personin që
6 pretendoni që ka qenë ulur është fillim të klasës, këto do
7 ishin fjalë fyese apo jo? Domethënë këto do ishin fjalë që të
8 gjithë ata që do kishin qenë, që kanë qenë aty me juve do t'i
9 kishin mbajt mend, apo jo Dëshmitar?

10 PË. Shiqo, unë kurrë s'kam thanë për personin që na ka kthy
11 letërnjoftimet përveç fjalë të sakta, që është sjellë mirë, me
12 keqardhje, edhe na ka kthy letërnjoftimet. Spekulime të tjera
13 mu nuk më interesojnë.

14 PY. Dëshmitar, nuk është e nevojshme që t'i kthehemi përsëri
15 atyre, por unë ju lexova disa fragmente të dëshmive të disa
16 personave që kanë qenë pjesë e delegacionit. Dhe në mbështetje
17 të asaj që ju keni thënë asnjëherë një gjë të tillë personit
18 që ishte ulur në krye të dhomës, nuk ka asnjë person në
19 delegacion që kujton që ka pasur ndonjë shkëmbim ndërmjet teje
20 dhe një personi në krye të klasës, sepse nuk ka qenë, nuk ka
21 pasur fare një person në krye të klasës, apo jo?

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtojmë. Kjo nuk është
23 shtjelluar me dëshmitarin, vetëm thjesht i parashtruar këtë
24 propozimin që ka qenë ndoshta, që ndoshta mund të ketë qenë
25 dikush në krye të dhomës. Nuk është shtjelluar deri në fund.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

2 Z. TULLY: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, a do ju befasonte që ndonjë person tjetër i
4 ndryshëm nga ju, nga delegacioni, të kujtonte ndonjë -- që nuk
5 kujton asnjë lloj ndërveprimi ose asnjë lloj bisede që ju
6 pretendoni që të keni pasur ndërmjet vetes edhe këtij personit
7 në fillim të klasës?

8 PË. Në atë situatë asgjë nuk më befason.

9 PY. Pse, sepse nuk ka ndodhë kjo bisedë, fare, prandaj?

10 PË. Jo, nuk më befason sepse njerëzit kanë mujtë me harru,
11 nuk e di unë. Unë nuk kam dëshirë me spekulu kush, pse ka
12 thanë kështu, pse - nuk jam unë ai njeri, asnjëherë. Por unë e
13 them që mendoj se ka qenë një, një person në karrigë përballë
14 nesh që na ka kthyer me mirësjellje letërnjoftimet. Edhe unë
15 mendoj se letërnjoftimet i kena marrë në Baicë.

16 Unë e mendoj. Edhe gabimi është njerëzor, muj edhe me pas
17 harru, me --

18 PY. Në rregull. Përpara se sa të kaloj tek tema e fundit, dua
19 t'ju them që juve ju tregua deklarata që i keni dhënë UNMIK-ut
20 në 2001, dhe që unë përsërita disa herë. Juve jeni në dijeni
21 që nuk keni përmendur një person që ka qenë i ulur në fillim
22 të klasës apo që mund të keni pasur një bisedë me një person
23 të tillë në deklaratën që keni dhënë në 2001, apo jo,
24 dëshmitar?

25 PË. Ka mundësi, unë -- unë e kam sqaruar edhe në deklaratën e

1 2001, sa janë bo ato deklarata, 2014, e krejt, i kam sqaru. Në
2 çfarë gjendje janë bo edhe arsyen pse janë bo.

3 PY. E kuptoj, dëshmitar. tani do të kaloj tek tema e fundit.
4 Shpresoj që të mund të përfundojmë përpara pushimit të drekës.

5 Z. Misetic sot më herët, sot paradite, foli me ju lidhur
6 me një bisedë që ju thatë që ka ndodhur ndërmjet jush dhe
7 Tahir Deskut. Ju e keni bërë të qartë që nuk i besonit asgjëje
8 çfarë thotë ai sepse ai është i alkoolizuar.

9 Pyetja që kam për ju është kjo: Kur ju kujtua dhe kur i
10 thatë këtë histori Prokurorëve të EULEX-it në 2014, ju nuk ia
11 keni thënë këtë gjë lidhur me Tahir Deskun, domethënë, që
12 Tahir Desku nuk është i besueshëm, sepse është i alkoolizuar?
13 Pse nuk e keni thënë këtë gjë?

14 PË. Kam harrue. Edhe në gjendjen çfarë kemi deklaru, në
15 kohën, pas luftës, nuk e di prej nga jeni ju, a keni pa
16 ndonjiherë luftë me sy, por s'është ajo e rëndësishme. Edhe a
17 keni pa varre të hapura, e njerëz të masakrumë e të djegun.
18 Edhe kjo nuk është e rëndësishme. Por në situata të tilla
19 është shumë e vështirë njeriu me pasë arsyen e shnoshë edhe me
20 i thanë gjanat ashtu siç duhet. Është e pamundshme.

21 PY. A mund t'ju bëj disa pyetje lidhur me personat e tjerë që
22 kanë qenë aty, në dhomë, kur keni pasë këtë bisedë me Tahir
23 Deskun. A ka pasë ndonjë delegat tjetër, ndonjë preson tjetër
24 të pranishëm, kur keni pasë bisedën?

25 PË. Të gjithë kanë qenë në dhomë, në klasë. Tahir Desku u ul

1 në fund të klasës vetëm me mu. Edhe kur m'i ka thanë ato
2 gjajna unë s'e kam marrë hiç seriozisht. Se tash me të thanë
3 dikush në 12 të natës ke me u vra, edhe me e marrë qesharake
4 atë punë, ju e kuptoni atë nivelin e komunikimit edhe se si e
5 kam trajtue me [E pakuptueshme] Tahir Deskun. Ndërsa shokët e
6 mi, të delegacionit kur më kanë pyetë, kur ka dalë Tahir Desku
7 më kanë pyetë, "Çka tha", thashë, "Tha fjalë të mira, tha që
8 nesër do shkojmë në shtëpi". Që me mujtë ata me u rehatu me
9 fjetë rehat. Se unë s'e kam marrë as -- më vjen keq se ai ka
10 vdekë, i qoftë i lehtë dheu i Kosovës, por me, domethënë, nuk
11 e kam marrë seriozisht. Se unë e kam njoftë edhe përpara, e
12 kam spjegu disa herë.

13 PY. Në rregull. Tahir Desku besoj që ti e ke përshkruar që
14 ishte poet, apo jo? Tahir Desku nuk është se ishte ndonjë
15 person që kishte ndonjë kompetencë të madhe brenda UÇK-së apo
16 jo?

17 PË. Nuk e di unë çfarë kompetenca ka pasë, veç unë jam habitë
18 kur e kam pa Tahir Deskun me uniformë edhe me automatik, se si
19 e kisha pa atë në Nju-Jork. Të shtrimë në rrugë, të pijtë.

20 PY. Kur Tahir Desku u fut në klasë, a ndodhi në ndonjë moment
21 që iu drejtua dhe anëtarëve të tjerë të delegacionit, a foli
22 me dikënd tjetër, apo vetëm me ju?

23 PË. As -- nuk -- vetëm me mu. Se mu më ka njoftë nga
24 Prishtina. Me të thanë të drejtën e kam thanë edhe këtu.

25 Vëllau im e ka mbajtur një restorant në Prishtinë në atë kohë

1 para lufte, një kohë të shkurtër, se pastaj na e kanë mbyllë.
2 Edhe shpesh vinte ushqente aty dhe nuk i pagunim, domethënë,
3 nuk i merrnim të holla. Shumë njerëz që s'kanë pasë mundësi
4 vëllai u ka dhanë gratis.

5 Z. TULLY: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqesë
6 në ekran [REDAKTUAR] faqja 34329, versioni në shqip
7 është në faqen 34343.

8 PY. Do t'ju tregoj një paragraf nga deklarata e Mehdi
9 Bardhit, sepse edhe Mehdi Bardhi ka qenë i pranishëm në klasën
10 ku keni qenë ju, që përshkruat ju.

11 PË. Ai e mban mend ndërveprimin ose bisedën ndërmjet jush dhe
12 z. Desku dhe jep një tjetër përshkrim të z. Desku që futet në
13 dhomë. Prokurori bën pyetjen:

14 "A ka ndonjë gjë tjetër që ju kujtohet?

15 Mehdi bardhi thotë:

16 "Jo. Vetëm ai, Tahir Desku, komentatori i luftës në atë
17 kohë, kishte ardhur tek ne atëherë kur ishim në fshatin Baicë
18 dhe kishte qenë shumë në ndikim të alkoolit dhe na ka thënë që
19 do bëhej avokati jonë."

20 Z. Desku nuk ka qenë ndonjëherë avokat, apo jo?

21 PË. Për herë të parë po e dëgjoj sot, që ka qenë avokat.

22 PY. Mbështetur në atë çfarë thotë z. Bardhi, a është rasti që
23 z. Desku u fut në klasë i pirë, dhe që thoshte gjëra pa
24 kuptim, ndërkohë që u fut në klasë, ka ndodhë kjo?

25 PË. Me thanë të drejtën, shumicën e kohës ka qenë i pirë. Se

1 njifet, mu po më shtini në pozitë të vështirë, sikur të ishte
2 gjallë, nuk isha mërzitë. Por njëri ka vdekë, pra s'kam
3 dëshirë me dhanë kualifikimet.
4 PY. Nuk dua që të mos e respektojmë. Por, thjesht doja të
5 përshkruaja atë çfarë ka thënë z. Bardhi lidhur me këtë. Pra,
6 ju thoni që të tjerët ishin të shqetësuar lidhur me atë çfarë
7 ju kishte thënë Tahir Desku në fund të klasës, dhe erdhi në
8 një pyetje se çfarë kishte ndodhur, domethënë, për çfarë bënte
9 fjalë biseda.

10 Z. TULLY: [Përkthim] Për referencë është [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR] në faqen 34263.

12 PY. Pyetja ime është kjo. Në qoftë se Mehdi Bardhi thotë që
13 Tahir Desku u fut në klasë i pirë, shumë i pirë, dhe thoshte
14 që unë do jem avokati juaj, sa të shqetësuar mund të ishin
15 personat e tjerë lidhur me atë çfarë menduan të kishte thënë
16 Tahir Desku ty. Besoj që nuk mund të ishin shumë të
17 shqetësuar, apo jo?

18 PË. Shiqoni, nuk di unë sa kanë qenë të shqetësuar. Unë s'kam
19 qenë fare i shqetësuar. Sepse unë e kam ditë kush është Tahir
20 Desku, nuk e kam marrë shumë seriozisht, as hiç seriozisht.
21 Domethënë, edhe vetëm ka shku në punë të vet, edhe këta
22 delegacioni më kanë pyetë, "Çka tha", thashë, "Mirë, në
23 rregull, nesër shkojmë në shtëpi", edhe qe kaq.

24 PY. Kur EULEX-i ka shkruar në raport që ju i keni thënë që ju
25 po qetësonit njerëzit, ndoshta është ekzagjerim që delegatët e

1 tjerë ishin shumë të shqetësuar lidhur me çfarë ju kishte
2 thënë Tahir Desku.
3 PË. Jo, por unë isha lider i grupit, dhe unë kam dashtë
4 rregullisht me i qetësu grupin, me qetësu të gjitha palët.
5 Edhe me kalu ashtu siç kemi kalu pa pasoja. Domethënë, me shku
6 në Prishtinë e me vazhdu jetën tonë politike, angazhimet tona,
7 deri në arritjen e plotë të lirisë dhe të pavarësisë së
8 Kosovës.

9 Kjo është kanë misioni jonë. Dhe ky delegacion meriton
10 çdo respekt. Edhe ndoshta një ditë shteti i Kosovës duhet me i
11 pajisë me medalje të arta. Sikur që kam thanë dhe ma kanë
12 marrë shumë për bazë, edhe UÇK-jua si UÇK e meriton Çmimin
13 Nobel për Paqe.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të më
15 lejoni një minutë sa të konsultohem me kolegët? Besoj se
16 përfundova.

17 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

18 Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të më
19 lejoni që të rishikoj dhe një herë pyetjet gjatë drekës? Dhe
20 do t'ju them në qoftë se kam ndonjë pyetje shtesë pasi të
21 kthehem.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përfunduar
23 këtu, kemi pushimin tani një orë e gjysmë. Do kthehem përsëri
24 në orën 14.30. Mund të dilni nga salla i shoqëruar nga
25 Sekretarja. Ju lutem mos flisni me asnjëri për dëshminë tuaj.

1 DËSHMITARI: [Flet anglisht] Jo, nuk mund të flas dot me
2 asnjë se jam vetëm.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Në qoftë se ju ndihmoj, thashë që më
6 duhen 30 minuta por, nuk mendoj që do jenë 30 minuta nga ana
7 ime, sa për t'ju njoftuar kjo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

9 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59

10 --- Seanca rifillon në orën 14.30

11 Z. TULLY: [Përkthim] I nderuar Gjykatës nuk kam më pyetje
12 për dëshmitarin, por mbase do të ishte më me vend që t'ia
13 thoja vetë.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] As unë s'kam më pyetje për këtë
15 dëshmitar.

16 Nuk kam pyetje për dëshmitarin.

17 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
18 këshillohen]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, të
20 sillni dëshmitarin brenda në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
23 jemi gati të vijojmë.

24 Z. Tully.

25 Z. TULLY: [Përkthim] Dëshmitar, u çova në këmbë vetëm për

1 t'ju thënë që unë nuk kam më pyetje për ju dhe thjesht doja
2 t'ju falënderoja për dëshminë që na dhatë dhe ju uroj rrugë të
3 mbarë.

4 PË. Faleminderit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, për
6 procesverbal, a ka pyetje?

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, ne nuk kemi pyetje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Pyetje shtesë?

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam pyetje shtesë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
12 Mettraux ka disa pyetje.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
14 Smith.

15 Pyetje nga Trupi Gjykses:

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe mirëdita, Dëshmitar.

17 Unë kam disa fusha për të cilat kam nevojë për sqarim. E
18 para, ka lidhje me kronologjinë kohore nga Qirezi në Baicë.

19 Siç e kam kuptuar unë ju personalisht keni qenë në makinë
20 me dy persona të tjerë, kështu?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përafërsisht, sa makina ka
23 pasur në këtë udhëtim nga Qirezi drejt Baicës?

24 PË. Nuk jam i sigurt për numrin e saktë. Ndoshta tri, katër
25 makina, pesë makina. Nuk jam i sigurt. Sinqerisht nuk jam i

1 sigurt.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të them
3 që në çdo makinë ka pasur një përzierje të anëtarëve të UÇK-së
4 edhe anëtarë të delegacionit tuaj?

5 PË. Ka mundësi, por nuk se nuk kam bë ndonjë evidencë, ka
6 mundësi.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet cilët kanë
8 qenë në makinat e tjera apo është ka kaluar shumë kohë? Për
9 shembull, a ju kujtohet në çfarë makine ka qenë z. Krasniqi
10 apo z. Bardhi apo nuk ju kujtohen këto?

11 PË. Me qenë i singërtë nuk më kujtohet. Domethënë është konë
12 e pamundshme me --

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë që të
14 gjitha makinat që u larguan nga Qirezi mbërritën në të njëjtën
15 kohë në Baicë? Pra, e thënë ndryshe këto katër, tri deri në
16 pesë makina mbërritën në Baicë në të njëjtën kohë, kështu?

17 PË. Mendoj se po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe një herë, me sa ju
19 kujtohet, a ishin të njëjtit persona që patë në Qirez edhe ata
20 që mbërritën në Baicë? Pra, ishin njëmbëdhjetë anëtarë të
21 delegacionit tuaj dhe të anëtarë të UÇK-së që ju tashmë i keni
22 identifikuar?

23 PË. Sa di unë ishin trembëdhjetë anëtarë të delegacionit tonë
24 edhe shoferët. Na kemi zbrit. Nuk kam ide, domethënë, nga kanë
25 shku ata të tjerët; na kanë thënë me hy në këtë shkollë dhe

1 jena ul në holl të shkollës fillore dhe aty kemi prit.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do doja që të më thonit,
3 krahas anëtarëve të delegacionit tuaj që u kthyen mbrapsht në
4 Prishtinë, dy zonjat deputete, vozitësit dhe gazetarët, i
5 njëjti grup personash që ishte në Qirez përfundoi në Baicë me
6 sa ju kujtohet ju apo jo?

7 PË. Ne kemi përfunduar në Baicë, vetëm grupi jonë prej 13
8 anëtarëve. Ata janë kthy prej Qirezit janë kthy për Prishtinë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjithashtu pjesëtarët e
10 UÇK-së që patë në Qirez apo jo? Pra, ata që patë në Qirez, që
11 ju thatë që patë në Qirez i patë sërish në Baicë, kështu?

12 PË. Po disa i kam parë, disa i kanë zbrit njerëzit aty edhe
13 kanë janë kthy. Nuk di unë, domethënë, ai ka qenë një fshat i
14 vogël e nuk e di, nuk për herë të parë kam qenë në jetë në atë
15 fshat. Nuk i di rrugët nga --

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po ju pyes për rrugët.
17 E kam tek pjesëtarët e UÇK-së që patë në Qirez. Pra, të
18 njëjtën pjesëtarë të UÇK-së që patë në Qirez i patë dhe në
19 Baicë apo ishte ndonjë pjesëtar që nuk e patë më në Baicë?

20 PË. Nuk e kemi pa. Ka pas pjesëtarë që s'i kena pa më,
21 domethënë. Në Baicë dikun ndoshta në atë moment kanë qenë tre,
22 më vonë nuk jam i sigurt. Fillimisht.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, personat që ishin në
24 Baicë kur mbërritët ju, kështu?

25 PË. Po. Që na kanë fut brenda në klasë, shkollë. Jo në klasë,

1 por në holl.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në deklaratën për UNMIK-un
3 në 2001 ju keni thënë se një nga makinat që keni parë në Qirez
4 kishte shenjën e policisë ushtarake. Është prova materiale
5 P681, faqja 2.

6 Sot, kur jeni këtu, ende ju kujtohet të ketë qenë një
7 makinë me shënimin Policia Ushtarake e UÇK-së mbi të?

8 PË. Në hyrje të Qirezit, por jo në Baicë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet përafërsisht
10 në ç'orë të ditës keni mbërritur në Baicë?

11 PË. Në Baicë, në orët e mbrëmjes, saktësisht nuk e di, 4, 5
12 nuk e di, nuk jam i sigurt.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një anëtar tjetër i
14 delegacionit tuaj ka thënë rreth orës 4 të pasdites, pak para
15 se të binte akshami mbrëmja. A ju kujtohet edhe ju kështu?

16 PË. Mendoj se ashtu duhet me qenë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa ju kujtohet, sa koha
18 kaloi nga momenti i mbërritjes, pra, nga momenti që shkuat në
19 shkollë në Baicë dhe deri në momentin që ndodhi kjo kacafytje,
20 pra. Sa kohë ishte mes momentit të mbërritjes edhe momentit që
21 ndodhi kacafytja?

22 PË. Po është vështirë me e thënë saktë, se janë 25 vite në
23 pyetje. Por ndoshta prej 30 minuta deri 1 orë. Por nuk mund
24 me, nuk është nuk mund me thonë saktë. Nuk e di.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe nga momenti që ndodhi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 115

Pyetje nga Trupi Gjykses

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 kjo që ju përshkruani si kacafytje dhe deri në një moment që
2 shkuat të diskutonit, pra, sa kohë zgjati mes këtyre dy
3 ngjarjeve; sa kohë ishte në mes të këtyre ngjarjeve?

4 PË. Ndoshta më pak që e fola më përpara. Prej atij holli,
5 atij korridorit të shkollës na kanë dërgu me një klasë ku kanë
6 qenë shtretërit në atë klasë edhe nuk e di saktësisht për sa
7 minuta kjo ka zgjat, sa kohë. Nuk mund me ia qëllu.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po me përfaqësi, mund të
9 themi kështu në përgjithësi, 10 minuta, 15 minuta, më shumë?

10 PË. Nuk, unë, çka do që të them atëherë i bien se, sinqerisht
11 nuk mund me e dit.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju pyes për diçka
13 tjetër. Kjo ka të bëjë lidhur me ato që keni thënë për
14 ngjarjet në shkollë në dhomën ku keni qëndruar. Unë do të
15 përpiqem ta përmbledh fillimisht atë që kemi dëgjuar këto dy
16 ditë. Dhe ju më thoni pastaj nëse përmbledhja ime është e
17 saktë apo jo?

18 Fillimisht, të paktën si e kam kuptuar unë nga dëshmia
19 juaj sot, ju nuk ju kanë rrahur dhe as ju kanë keqtrajtuar në
20 Baicë; nuk keni parë as të rrihej ndonjë person tjetër as nuk
21 keni pësuar ndonjë lëndim si pasojë e rrahjeve dhe nuk keni
22 parë të kishte lëndime ndonjë anëtar i delegacionit tuaj që
23 mund të ishte shkaktuar nga rrahjet.

24 A përmbledha siç duhet atë që keni thënë këto dy ditë?

25 PË. Kam thënë që ka pas kacafytje. Një grup i vogël i

1 personave kanë hyrë aty dhe janë shty me ne, na kanë fye, ka
2 pas një kacafytje aty në shtymje, por unë aty s'kam pa as
3 armë, as nuk kam parë siç me mijëra herë na kanë thënë nëpër
4 media na kanë fye, poshtërue me pjesë të hekurt e me drunj.
5 Domethënë, ato nuk edhe nuk kam pa asnjë pikë gjak, e
6 domethënë, edhe ne jemi kthy shëndoshë e mirë në Prishtinë.
7 Është e vërtetë se duke fillu prej meje e të tjerët nuk e di,
8 mund t'i pyetni ata, s'kena pas nevoja me kërku asnjë ndihmë
9 mjekësore, asnjë trajtim dhe asgjë tjetër. As nuk e kemi kërku
10 prej askujt.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do përpiqem sërish. Por
12 bazuar në dëshminë, të paktën siç e kemi kuptuar ne këtu, ju,
13 ju, ju personalisht nuk ju kanë rrahur dhe nuk ju nuk keni
14 parë të rrihej ndonjë anëtar tjetër i delegacionit tuaj. A e
15 thashë saktë këtë?

16 PË. Edhe unë jam përfshi në kacafytje. Domethënë, jam ngrit
17 nga karrigia se kam dash me e qetësu situatën. Edhe domethënë
18 aty ka pas shtymje, ato janë konë momente që shumë të shpejta
19 që truni jonë me siguri në atë fazë është ndalë. Domethënë --

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshmitar, thjesht
21 përgjigjuni pyetjes time. Pyetja ime ishte si kjo në vijim:
22 Nga dëshmia që keni dhënë këto dy ditë, ju keni thënë që mua
23 personalisht nuk më kanë rrahur dhe nuk keni parë të rrihej
24 asnjë anëtar i delegacionit tuaj, po apo jo?

25 PË. Mua personalisht, jo. Nuk më kanë rrahur dhe nuk kam parë

1 që është rrah dikush përveç shtymjeve edhe domethënë ato që i
2 kam përshkrue, sikurse i shohim në fushat e futbollit, sikur i
3 shohim nëpër parlamente. Domethënë ka qenë një që ka zgjat një
4 minutë, shumë shkurt.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të
6 sugjerohet që kjo është pikërisht e kundërta ajo që i keni
7 thënë më herët UNMIK-ut dhe EULEX-it? A është propozimi i
8 drejtë ky që thashë unë? Në të dyja intervistat që keni dhënë
9 si për UNMIK-un si për EULEX-in keni thënë se keni qenë
10 dëshmitar i rrahjeve që ju kanë ndodhur të tjerëve dhe ju
11 ishit rrahur, kështu?

12 PË. Po unë i kam shpjeguar arsyen pse i kam thënë ato disa
13 herë. Në gjendje të rëndë. Ju e dini, besoj e keni dëgjuar
14 fatin tim tragjik gjatë lufte.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshmitar, i kemi parasysh
16 arsyet tuaja. I dëgjuam arsyet tuaja.

17 Unë po ju pyes këtë: A e pranoni ju, Dëshmitar, që ju,
18 duke marrë parasysh dhe dëshminë që keni dhënë sot, ju u keni
19 dhënë informacione të rreme dhe çorientuese hetuesve të
20 Kombeve të Bashkuara? A e pranoni parashtrimin tim?

21 PË. Shiko, iu kam dhënë informacione që në gjendje të rëndë
22 shëndetësore edhe shumicën e rasteve, domethënë, kam dashtë me
23 revanshu për atë krejt çka ka ndodh atë ditë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime është më e
25 thjeshtë. Unë po ju them, a e pranoni ju, duke marrë parasysh

1 dëshminë që po jepni para kësaj Gjykate tani, informacion apo
2 dëshmitë që i keni dhënë UNMIK-ut janë të rreme, këto po na
3 thoni?

4 PË. Po janë, janë të ekzagjeruara.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për shembull, në atë
6 deklaratë keni thënë që më kanë rrahur. Këtu po na thua që nuk
7 ju kanë rrahur. Pra, pretendimi se ju kanë rrahur bie poshtë
8 duke marrë parasysh dëshminë që po jepni këtu sot, a është e
9 drejtë?

10 PË. Disa herë e kam thënë që i kam ekzagjeruar dhe i kam
11 tregu motivet e atyne deklaratave që i kam ekzagjeruar edhe në
12 letrën e fundit që e kam dërgue në vitin e kalum.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë po ju jap një sugjerim
14 ju mund të reagoni. Sipas dëshmisë që po jepni sot i bie që ju
15 i keni gënjyer hetuesit e EULEX-it apo jo, sepse ju keni
16 thënë, keni pretenduar se ju kanë rrahur, keni thënë që edhe
17 të tjerët janë rrahur edhe gjëra të tjera të këtij lloji. Pra,
18 informacioni që i keni dhënë EULEX-it, nëse marrim parasysh
19 dëshminë që po na jepni ju sot, i bie që i takon që të ketë
20 qenë i rremë edhe tjetërsues, e pranoni këtë?

21 PË. Ka qenë i ekzagjeruar.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nuk e pranoni që ka
23 qenë informacion i rremë?

24 PË. Po është, edhe mund të jetë i rremë. Domethënë, tash e
25 kam thënë të vërtetën. Kur jam kthyer në konferencë shtypi edhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 119

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 po them të vërtetën këtu. Këtu në mes, domethënë nuk
2 qëndrojnë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që të jem i qartë, ju e
4 dini që kur po ju intervistonte EULEX-i mosthënia e të
5 vërtetës ishte vepër penale sipas të drejtës së Kosovës. Ju
6 ishit në dijeni të kësaj.

7 PË. Unë s'kam pas as avokat as këshilltar juridik.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por ama ju u informuat që
9 të mos tregosh të vërtetën prokurorit është vepër penale apo
10 jo?

11 PË. Domethënë jam i informu, por unë s'kam pas kurrë në jetën
12 time s'kam qenë nëpër gjykata dhe nuk e kam vlerësu si duhet
13 domethënë atë edhe s'kam pas asnjëherë as këshillë juridike as
14 avokat.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretares të
16 kalojmë në seancë private.

17 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F2133RED

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. I lutem
20 Sekretares të nxjerrë në ekran [REDAKTUAR]
21 faleminderit.

22 Që t'ju japim kontekstin është një deklaratë që ka thënë
23 Kurtesh Devaja më 14 korrik 2014. Është një deklaratë që ia ka
24 dhënë një prej prokurorëve të EULEX-it. Do presim të dali te
25 shqipja në ekran.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825(Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 120

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 A mund të konfirmoni që edhe z. Devaja ka qenë anëtar i
2 delegacionit tuaj dhe njësoj si ju edhe atë e çuan në Qirez
3 edhe më pas në Baicë, kështu?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë që të
6 themi që njësoj si ju edhe ai është një figurë e spikatur
7 politike në Kosovë ose të paktën në atë kohë ka qenë figurë e
8 spikatur politike?

9 PË. Ka qenë, domethënë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë nuk dua t'ju them
11 çfarë duhet të thoni, por ju e keni përshkruar si një person
12 me të cilin keni ndarë vlerat politike, kështu?

13 PË. Po, ka qenë në Partinë Shqiptare Demokristiane.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është ky një person që e
15 respektoni si person dhe si figurë politike?

16 PË. Unë të gjithë anëtarët e delegacionit që kanë qenë me mua
17 i respektoj.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ai ka qenë një prej
19 personave të tjerë, me sa kuptoj, pra, ai ka qenë po ashtu një
20 nga personat që është përfshirë në këtë kacafytje, fjala që
21 përdorni ju, kështu?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretares të
24 shkojmë në faqen 16 të të njëjtit dokument me ERN 034457. Në
25 shqip është 034488. Shkojmë pak më poshtë për shqipen.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 121

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 Ju lutem ta lexoni vetë, Dëshmitar. Lexojeni këtë dhe
2 këtu do të shihni atë që ju sot e përshkruani si kacafytje apo
3 përplasje. Z. Devaja e ka përshkruar ndryshe. Së pari, ai
4 përshkruan se si është rrahur z. Bardhi. Edhe mavijosjet që u
5 shkaktuan. E shihni?

6 PË. Po, po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas përshkruan si është
8 rrahur Agim Krasniqi. E përshkruan në të njëjtën mënyrë,
9 ofendime, dhunë. A e shihni?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.
12 Përshkruan si e rrahën atë vetë. Shkelmim, shkelma e rrahje
13 nga ushtarët. A e shihni? E rrihnin dhe e shqelmonin.

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pastaj përshkruan që ka
16 dëgjuar edhe që bërtisnin, e shihni? Piskamat e tyre, thuhet.

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ai thotë:

19 "Nuk e di. Nuk kam guxuar të shikoja. Ne vetëm i kemi
20 dëgjuar piskamat e tyre".

21 E shihni në ekran?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e parë është,
24 ju vetë a keni parë ndonjë prej këtyre që ka përshkruar z.
25 Devaja? Ju vetë dëshmuat ndonjë prej këtyre që ka përshkruar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 122

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 z. Devaja me sytë tuaj?

2 PË. Unë i kam cekë emrat e gjashtë anëtarëve të delegacionit
3 që jemi përfshi në kacafytje. Janë po të njëjtit, domethënë
4 edhe thashë --

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshmitar, do flasim edhe
6 për gjashtë emrat. Do ju pyes edhe për atë. Unë tani po ju
7 pyes këto: Ju patë me sytë tuaj këtë që përshkruan z. Devaja
8 në këtë tekst?

9 PË. Unë, ka qenë gati si errësirë edhe në atë moment thashë
10 ju ndoshta e besoni e mund ta kuptoni se truni më nuk
11 funksionon normal si duhet edhe adrenalina ku ta di ato unë
12 nuk jam mjek. Edhe domethënë nuk kam mund në atë rrufe, në atë
13 kacafytje, domethënë, me i shiku detalet kadale, *slow motion*,
14 edhe me e ditë kush çka si ka ndodhë. Unë s'kam mund domethënë
15 me i pa ato.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përgjigja e pyetjes sime
17 që po thoni ju? Pra, përgjigja juaj është s'keni parë asgjë
18 prej këtyre, apo jo?

19 PË. Jo kam pa unë që kacafytje. Disa herë e kam thënë. Por
20 këto detalet kush, a ka bërtitur dikush a kush në cilën anë i
21 kanë mëshu a s'i ka mëshu, domethënë, këto nuk kam mujt me i
22 vërejt. Nuk kam pas mundësi me i vërejt se ka qenë edhe terr
23 edhe kam qenë i shokum në atë moment domethënë. Singërisht
24 s'kam mund me i regjistru.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas i përshkruan pjesën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 123

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 ku jeni rrahur ju. Është faqja 034458, në shqip është 034489.

2 Unë do jua lexoj çfarë ka thënë ai. Ai thotë:

3 "Pas tij", domethënë pas Agim Krasniqit, "Është marrë

4 Gjergj Dedaj".

5 Prokurori e pyet:

6 "A ka ndodhur e njëjta gjë?".

7 Dëshmitari, z. Devaja thotë:

8 "E njëjta gjë ka ndodhur, përveç asaj unë kam parë njërin
9 prej tyre që goditi atë në shpinë me një stupcë të drurit i
10 cili në realitet u thye në shpinën e tij".

11 "Prokurori e pyet: A i thonin të njëjtat gjëra edhe
12 Gjergj Dedajt?".

13 "Përgjigje: Gjëra të njëjta, rrahjen e njëjtë, ofendimet
14 e njëjta. Unë po ashtu e di se ai, se atij iu thye stupca e
15 drurit në shpinë".

16 Pyetja ime është: A ka ndodhur vërtetë -- më lejoni të
17 mbaroj pyetjen -- A ka ndodhur vërtetë kjo apo --

18 PË. Unë s'kam pa --

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- na lejoni të mbarojmë
20 pyetjen ju lutem. Pra, edhe një herë, a ka ndodhur vërtetë kjo
21 apo e ka trilluar z. Devaja këtë histori?

22 PË. Shiko, krejt në këtë proces ka pas ekzagjerime edhe
23 skenarë filma të ndryshme. Unë nuk kam pa asnjë dru që u thye.
24 S'kam pa kujt asnjë dru në dorë, as një hekur dhe asnjë gjë në
25 atë moment s'e kam pa. Thashë truni im është ndalë për një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 124

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 minutë dy. Se është konë problem unë me mendu në atë moment
2 edhe me i shiku gjonat, detalet, sepse kena qenë në një
3 gjendje traumatike në ato sekonda.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e pranoni, Dëshmitar, që
5 dëshmia e z. Devaja, që sapo jua lexova përputhet tërësisht me
6 dëshminë që ju personalisht ia keni dhënë UNMIK-ut në 2001 dhe
7 EULEX-it në 2014? A e pranoni këtë?

8 PË. Ka ngjashmëri, domethënë, e përshkrimi i tij në detale,
9 domethënë nuk përputhet, domethënë. Se nuk di unë për çfarë
10 druni ai folë se unë s'kam pa asnjë copë druni aty.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e pranoni, për shembull,
12 që gjashtë persona që përmendte z. Devaja si personat që janë
13 rrahur dhunshëm, shqelmuar dhe që piskatnin janë të njëjtët
14 persona, pra, të njëjtët persona ata gjashtë që ju fillimisht
15 i keni thënë UNMIK-ut se ishin rrahur, a e pranoni këtë?

16 PË. Unë s'kam dëgju asnjë person që të ketë piskatur.
17 Domethënë, edhe për fjalën për emrat që i ka përdor e i ka
18 përmend z. Devaja është e vërtetë; bëhet fjalë për ata njerëz
19 që kemi qenë të përshirë në kacafytje. Nuk e ka spekulu.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do përpiqem të përmbledh
21 atë që mendoj se kam kuptuar unë nga dëshmia juaj këto dy
22 ditë. Dhe ju lutem më korrigjoni në qoftë se do të them diçka
23 të gabuar.

24 Siç e kam kuptuar unë është kjo: Ajo që i keni thënë ju
25 UNMIK-ut dhe EULEX-it për keqtrajtimet, ndalimet ishte e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 125

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 gjitha një gënjeshtër që ju e keni thënë nga inati dhe për
2 revansh politik.

3 Pyetja ime është kjo: A e keni idenë pse z. Devaja e ka
4 thënë këtë histori? Pse ka thënë ai të njëjtën histori që i
5 keni thënë ju UNMIK-ut dhe EULEX-it për keqtrajtime, për
6 ndalime të të njëjtët personave, këtyre gjashtë personave? A
7 keni një shpjegim ju për këtë?

8 PË. Unë mendoj se këtë shpjegim për pse e ka thënë Devaja
9 duhet me e dhënë personalisht Devaja, meqenëse është gjallë.
10 Unë e kam dhënë, sepse në një periudhë të caktume këtë grup që
11 na ka, që jemi ndalë në Qirez e në Baicë unë e kam konsideru
12 armiqësorë, kundërshtarë dhe ka dashtë, domethënë, me u
13 revanshu, s'kam pas mjete mundësi as dëshira të tjera me pa
14 përdor mjete të tjera se nuk jam unë i tillë, por e kam bë me
15 revansh me gojë. Edhe kam dashtë me i dëmtu derisa nuk e kam
16 kuptu të vërtetën.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, deri në masën që
18 mundeni dhe sigurisht në qoftë se nuk mundeni na e thoni që
19 nuk mundeni. Por i takon që ky shpjegim është i vërtetë edhe
20 për z. Devaja apo mendoni që është thjesht koincidencë,
21 thjesht rastësisht ai ka treguar të njëjtën histori që i keni
22 thënë juve autoriteteve në 2014?

23 PË. Nuk e di pse e ka thënë ai ashtu. Dhe ju kisha lut,
24 domethënë, me më kuptu se unë jam përgjegjës për atë që them
25 unë. E të tjerët mund me thënë çka të dojnë. Ju e patë edhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 126

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 nga avokati parë katër persona i kanë dhënë katër variante të
2 ndryshme për kur janë dhënë letërnjoftimet. Domethënë, edhe në
3 atë situatë që ka zgjat shumë shkurt, në rrethana traumatike,
4 rrethana të pabesueshme është vështirë me mund me u koncentru
5 edhe me dit krejt çka ka ndodh. Kushdo që të flet nuk mundesh
6 me ia qëllu krejt çka ka ndodh.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju kërkoj që të shikoni
8 dhe çfarë ka thënë ai lidhur me z. Blakaj. Megjithatë, së
9 pari, ju konfirmoni që z. Blakaj është dikush që ju e
10 konsideroni si shok, si shok dhe një bashkëpunëtor i ngushtë
11 politik, është e vërtetë kjo?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju kërkoja që të
14 shikonit, në faqen në anglisht është 17, ERN 034458 dhe në
15 shqip është 034490. Z. Devaja ka shpjeguar si më poshtë lidhur
16 me Z. Blakaj. Ai pyetet a i ndodhi e njëjta gjë edhe atij, ai
17 thotë:

18 "Po, në të njëjtin vend dhe e njëjta rrahje".

19 U pyet nëse është përdorur armë. Ai thotë nuk ka parë një
20 gjë të tillë dhe pastaj pyetet a ka parë ndonjë lëndim mbi z.
21 Blakaj. Ai thotë që:

22 "Ai është goditur në hundë dhe iu lut atyre që të mos ta
23 qëllonin më, sepse kishte probleme me veshkat. Ai ishte
24 shtrirë përdhe në mënyrë të tillë që të mbronte veshkat, sepse
25 ata e godisnin, po e gjuanin me grushte në mënyrë që të mund

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 127

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 ta gjuanin gjithandej. Ai ishte shtrirë në mënyrë horizontale
2 me shpinën kundër murit".

3 Pyetja ime e parë është kjo: A ke parë ndonjë gjë nga ky
4 përshkrim që ka dhënë z. Devaja lidhur me rrahjen e z. Blakaj?
5 Ju vetë a keni parë ndonjë gjë nga këto?

6 PË. Siç e paska përshkru z. Devaja paska qenë dashtë me ardhë
7 dy-tri autoambulanca aty me na marrë me na dërgu menjëherë në
8 spital. A na nesërmit kena dalë dy orë mbas asaj konferencë
9 shtypi dhe na shihni krejt si jena -- domethënë, kjo nuk
10 përkthyet me këto përshkrime. Se një njeri në atë gjendje të
11 tillë nuk mundet pastaj me qenë krejt brenda disa normalë.
12 Asnjoni prej nesh nuk kena kërku as s'kena pas nevojë me
13 kërku ndihmë mjekësore, duke fillu prej meje.

14 Domethënë, ky përshkrim i Devajës nuk e di pse e ka bë.
15 Duhet me pyet atë. Unë nuk mund me spekulu edhe me thënë që ka
16 pas, se kësoj lloj rrahjesh bile njëri a dy a tre prej nesh ka
17 qenë dashtë me qenë vdekun, se janë përmend hekurat, janë
18 përmend drunjtë. Domethënë aty dikush as një ambulancë nuk ka
19 ardhë, askush s'ka shku në spital. E keni parë konferencën
20 time për shtyp kur jam kthy. Domethënë, krejtësisht normal.
21 Secili prej nesh e kena vazhdu punën normal, pa asnjë problem.
22 As jemi shtri në shtëpi, as kemi ndejt në spital. Kjo është,
23 domethënë, e vërteta.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, pyetjes time ju i
25 përgjigjeni që nuk keni parë asnjë gjë të tillë që të ndodhë,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 128

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 kështu?

2 PË. Unë e kam pa kacafytje. Thashë ajo ka, sikur një rrufe,
3 domethënë, një rrufe. Kam pa kacafytje. Dikush ndoshta i ka
4 mëshu dikujna me duar me grushta, domethënë, i kam pa to, ama
5 shpejt e shpejt. Edhe, mirëpo truni menjëherë mua m'u ka
6 ndalë; truni im. Domethënë, sikur ndoshta që edhe tash mundet
7 me u ndalë, nuk e di detalet, nuk mund me i kujtu detalet.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në 2014 kur i keni thënë
9 EULEX-it që z. Blakaj ka pasur lëndime në fytyrë, kjo ka qenë
10 gënjeshtër apo jo?

11 PË. Shiko, z. Blakaj ka pas ai, unë e kam, meqenëse jena në
12 seancë private z. Blakaj ka pi shumë alkool. Domethënë, edhe
13 aty ka lyp birra.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndjesë, nuk ju bëra këtë
15 pyetje; nuk kishte lidhje me pyetjen time. Ju lutem, më lejoni
16 së pari të mbaroj pyetjen dhe përgjigjuni pyetjes.

17 Për procesverbal është prova materiale P680, faqja 7.
18 Është procesverbali i intervistës me EULEX-in në maj të 2014
19 ku ju thoni se Sokol Blakaj kishte lëndime në fytyrë. Pyetja
20 ime është kjo: A keni gënjer kur keni thënë këtë?

21 PË. Nuk më kujtohet.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për të qenë i drejtë me
23 ju, Dëshmitar, dëshiroj t'ju paraqes një parashtrim të z.
24 Devaja në deklaratën e vet. Në faqen 26 të deklaratës në
25 versionin anglisht është ajo që do ju lexoj. Për procesverbal

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 129

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 është faqja ERN 034467 dhe në shqip është dokumenti 034499. Në
2 versionin në shqip është pak më poshtë tek faqja.

3 Z. Dedaj, do ju kërkoja që të përqendroheshit tek
4 paragrafi i fundit që fillon me "Ata na". Mund ta shikoni këtë
5 paragraf? E lexoni përpara në ekran?

6 PË. Po, po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në anglisht është po ashtu
8 paragrafi i fundit tek faqja. Ju lutem, të kalojmë pak më
9 poshtë në faqen në anglisht.

10 Z. Devaja thotë si më poshtë. Kjo është ajo çfarë u ka
11 thënë Prokurorëve të EULEX-it. Ai thotë:

12 "Ata na i dhanë kartat tona të identifikimit, mua dhe të
13 tjerëve dhe Rexhep Selimi i tha Gjergj Dedajt 'ju jeni ende
14 nën hetim'. Më kujtohet se ai i tha fjalët e njëjta edhe Agim
15 Krasniqit, Mehdi Bardhit dhe nuk e di se kujt tjetër. Kur ma
16 ktheu kartën time të identitetit ai më tha, 'ju nuk jeni nën
17 hetim'.

18 Pyetja ime e parë për ju është kjo: A ju kujtohet që
19 është bërë, ju është bërë një deklaratë e tillë juve? Ju është
20 thënë diçka e tillë juve?

21 PË. Shiko, karta e identitetit sa më kujtohet mua na u kanë
22 kthyer në shkollë në Baicë. Tjetër mundësi nuk kam me sqaru.
23 Edhe nuk më kujtohet që Rexhep Selimi të na ketë thënë një gjë
24 të tillë, domethënë edhe vetëm se na kanë liru edhe na kanë
25 dërgu për më në fund për Krajmirov.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 130

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, përgjigja është që
2 ju nuk ju kujtohet që t'ju jetë thënë diçka e tillë, e kuptova
3 drejt apo jo? Këtë po thoni?

4 PË. Nuk më kujtohet. Janë 25 vjet në pyetje. Nuk më kujtohet
5 se është krejtësisht normale.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që
7 të paraqesë në ekran dokumentin, provën materiale P158.

8 Dëshmitar, besoj që e njihni dokumentin se e keni parë
9 edhe më herët gjatë kësaj jave. Është një deklaratë apo
10 njoftim për shtyp që është nxjerrë nga Drejtoria e Policisë
11 Ushtarake e UÇK-së. Mendoj që ju e përshkruat këtë si
12 propagandë. Megjithatë ka një ose dy gjëra për të cilat do
13 doja t'ju pyesja lidhur me këtë dokument.

14 Ju lutem, kalojmë një faqe më poshtë. Faleminderit.

15 Është i njëjti dokument që jua treguan edhe sot apo dje.
16 Është një kumtesë e Drejtorisë së Policisë Ushtarake të
17 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Titulli është "Vazhdojnë
18 hetimet ndaj tre të dyshuarve".

19 Nëse do të lexoni në tekst aty thuhet që tre anëtarët e
20 delegacionit që është ju, z. Bardhi dhe z. Krasniqi, Agim
21 Krasniqi, janë akoma nën hetim të UÇK-së edhe pse janë liruar.
22 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

23 PË. Po, e shikoj.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e pranoni që kjo është
25 në përputhje me deklaratën që sapo ju lexova që është dhënë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 131

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 nga z. Devaja që ju të tre vazhdonit ose të paktën ekzistonte
2 pretendimi që ju të tre vazhdoni që të ishit objekt i hetimit
3 prej UÇK-së? A e pranoni këtë?

4 PË. Po kjo është e njëjta, po. Domethënë kjo është q'ajo që
5 është thënë; qysh e paska thënë Devaja, po thotë edhe këtu.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ajo çfarë nuk është e
7 qartë për mua kur u pyetët lidhur me këtë dokument është që, a
8 u vutë në dijeni që ekzistonte ky dokument në shtator të '98-s
9 apo edhe më pas që të paktën pretendoheshit që të kishit qenë
10 objekt i hetimeve të UÇK-së apo nuk e mësuar asnjëherë një gjë
11 të tillë?

12 PË. Jo, besoj që kam, as kanë pas arsye me më hetu mu. Unë
13 kam qenë gjithmonë objekt i hetimeve nga Serbia. Nuk kanë pas
14 asnjë arsye. S'kam bë asnjëherë në jetë asnjë gabim, gabim
15 edhe në semaforë bën njeri. Unë s'kam bë asnjë vepër që më ka
16 shqetësu mua që kam bë diçka të keqe në kundërshtim me ligjin.
17 Prandaj as nuk kam pas noj telefonatë, as nuk kam pas noj
18 përcjellje, as nuk kam pas noj shqetësim nga ana e UÇK-së për
19 këtë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk ju bëra këtë pyetje.
21 Ndoshta nuk e formulova siç duhet pyetjen. Nuk po ju pyes në
22 qoftë se kishin arsye për këtë gjë apo jo, por ju pyeta në
23 qoftë se e mësove ndonjëherë apo jo që pretendohej që ato t'ju
24 kishin juve nën hetim? Domethënë, a e dëgjove ndonjëherë, a e
25 mësove ndonjëherë këtë gjë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 132

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 PË. Ndoshta kam dëgju nga shtypi. Domethënë, kam harru, janë
2 25 vjet. Por mua s'më ka lënë përshtypje kjo, domethënë,
3 s'kanë pas asnjë arsye.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
6 çaktivizuar]

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim]

9 Mirëdita, Dëshmitar.

10 Kam disa pyetje të tjera për ju.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në
12 seancë private.

13 Sekretare na kaloni në seancë publike, përderisa jemi në
14 seancë private.

15 ~~{Seancë e hapur}~~

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
17 jemi në seancë publike.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do filloj edhe një herë.

19 Mirëdita, Dëshmitar. Kam disa pyetje për ju.

20 Të hënën kur Prokurori po ju merrte në pyetje ju i thatë
21 si më poshtë dhe këtu citoj:

22 "Rexhep Selimi me shumë respekt dhe shumë politesë na
23 ktheu kartat e identitetit dhe nuk do i harroj asnjëherë
24 fjalët e tij të këndshme. Dhe Hashim Thaçi erdhi dy orë më pas
25 dhe ishte shumë nervoz; kishte një radio në dorë dhe po

1 dëgjonte lajmet. Unë nuk kisha raport shumë të mirë me
2 Personin 1 dhe mendoj që Personi numër 1 ka vendosur lidhur me
3 çdo gjë".

4 Dhe për procesverbal ky fragment është marrë nga
5 transkripti i ditës së hënë, rreshtat 9 deri në 14.

6 Dëshmitar, pyetja për ju është kjo: Pse mendoni që z.
7 Thaçi dhe z. Selimi ose të paktën personi që mendoni që ishte
8 z. Selimi, pse mendoni që edhe dy persona nuk kishin raport të
9 mirë me Personin numër 1? A i keni parë ju që të ketë pas
10 ndonjë bisedë ndërmjet tyre ose të ketë pasur ndonjë kacafytje
11 ndërmjet këtyre dy personave dhe Personit 1?

12 PË. Jo, jo. Kacafytje s'kam pa, por nuk kanë pas biseda,
13 domethënë kolegiale. Aty kam kriju ndoshta perceptimin e
14 gabueshëm, por s'kanë biseda, domethënë, se kanë respektu,
15 domethënë, ato. Atë kacafytjen nuk kanë bërë, s'kam pa
16 kacafytje.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja tjetër
18 është: Pse kishit përshtypjen që Personi 1 ishte personi që
19 kishte vendosur lidhur me çdo gjë?

20 PË. Po se ai jepte urdhra. Domethënë ai jepte urdhra "Merre
21 letërnjoftimin", "Kthehi në Prishtinë". Këta knejna,
22 domethënë, ashtu kena kriju përshtypjen ne. Atë çka kena pa po
23 flas, atë çka mbaj mend po flas. Se nuk mund me folë atë çka
24 kam harrue, çka s'kam pa.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A ke parë apo

1 a ke dëgjuar Personin 1 që t'i jepte urdhra ose z. Thaçi apo
2 z. Selimi ose personit që ju besoni që ka qenë z. Selimi gjatë
3 tre ditëve që jeni takuar me të? Jeni takuar me këta të dy në
4 Qirez dhe/ose në Baicë në shtator të '98, kështu?
5 PË. Në Qirez jam taku vetëm me atë Personin 1. Domethënë e
6 kanë përmend edhe të tjerët dhe kisha pas dëshirë që kjo edhe
7 kjo bisedë me qenë në seancë private, sepse më shkaktoni shumë
8 probleme mua dhe familjes time. Probleme të paimagjinueshme,
9 të cilat unë nuk i meritoj.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Besoj që u pajtuam ndërmjet
11 palëve, Dëshmitar, që ju të përdorni pseudonimin, të përdornit
12 kodin Personin numër 1, kur doni t'i drejtoheni një personi
13 konkret. Kështu që do sugjeronim që të vazhdonit ta bënit të
14 njëjtët gjë.

15 PË. Por kur të flasim për detale atëherë dihet kush është
16 Personi numër 1. Domethënë atëherë më mirë me e thënë me emër
17 e me mbiemër. A që po më shkaktoni trauma, probleme, domethënë
18 për krejt jetën time dhe për fëmijët e mi është kjo e vërtetë
19 absolute. Shumë të mëdhaja që ju nuk mund t'i besoni.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Thjesht dua të di dhe e
21 përsëris edhe një herë pyetjen këtu. Po pyes në qoftë se e
22 keni dëgjuar apo keni parë që Personi 1 i ka dhënë ndonjë
23 urdhër ose z. Thaçi ose z. Selimi apo personi që ju besoni që
24 ishte z. Selimi në atë kohë gjatë tre ditëve ose në Qirez
25 dhe/ose në Baicë?

1 PË. Unë s'ka pa atë tuj dhënë urdhra, por e kam pa kur ka
2 urdhnue për rastin tonë. Dhe aty kam pa, domethënë, se ai kam
3 kriju përshtypjen, ndoshta edhe paragjykimin edhe perceptimin
4 se ai është personi aty kryesori që ka vendos.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj.

6 Kam një tjetër pyetje për ju, Dëshmitar. Sot paradite ju
7 bëri një pyetje z. Misetic nga Mbrojtja e z. Thaçi lidhur me
8 një lëndim që. Z. Blakaj mund të ketë pësuar ose jo në shtator
9 të '98-s. Ju kërkua që të kalonim në seancë private dhe sepse
10 na thatë që z. Blakaj ka vdekur edhe është ka qenë shok i
11 juaji.

12 Dhe ju na thatë gjithashtu dhe këtu cilësoj:

13 "Mos harroni që ne kemi qenë në mal dhe kemi lëvizur në
14 male. Kështu që duke qenë kështu mund të kemi pas pësuar
15 ndonjë dëmtim, nxirje sepse kemi qenë në baltë, kemi qenë në
16 shi dhe kemi qenë në granatime të vazhdueshme të forcave serbe
17 dhe kemi lëvizur në një terren malor".

18 Për procesverbal ky është transkripti provizor, faqja 9,
19 rreshtat 16 deri në 20.

20 A mund të na thoni, Dëshmitar, mund të na e sqaroni pak
21 se çfarë doni të thoni me këtë? A doni të thoni me këtë që
22 edhe z. Blakaj është rrëzuar ndërkohë që keni qenë në mal apo
23 e keni parë që të jetë rrëzuar edhe ai?

24 PË. Unë s'e kam parë që të jetë rrëzuar, sepse aty kemi qenë,
25 nuk kena, domethënë janë bëhet fjalë për 13 vetë. A zakonisht

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç Faqe 136
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 unë çdo lëvizje iu kam pri. Përmas çka ka ndodhë, por është e
2 vërtetë absolute që ne kemi ec nëpër mal, nëpër drunj, nëpër
3 ferra, nëpër gropa, shi, baltë dhe ato ditë nuk është ndalë
4 shiu tërë natën. Ke shka kam parë unë nuk mund me thonë që e
5 kam parë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shumë faleminderit. Nuk kam
7 pyetje të tjera.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë pyetje
9 plotësuese nga Prokuroria?

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, nuk kemi
11 pyetje.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje të
13 tjera nga ekipet e Mbrojtjes?

14 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës,
15 shkurtimisht kam disa pyetje.

16 Do kërkoja të kalonim në seancë private.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, të
18 kalojmë në seancë private.

19 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F2133RED

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë private.

22 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Faleminderit.

23 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç:

24 Z. MISETIÇ: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, Gjykatësi Mettraux ju bëri disa pyetje që kanë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 137

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 të bëjnë me krahasimet e dëshmisë që i keni dhënë EULEX-it në
2 vitin 2014 dhe dëshminë që i ka dhënë z. Devaja në vitin 2014
3 EULEX-it. Ndërkohë që tani do doja që Sekretarja të
4 transmetojë në ekran dëshminë e z. Telaku që ka qenë një prej
5 gjashtë personave që ka qenë bashkë me juve në Baicë, a është
6 e saktë kjo? Ka qenë ai në Baicë me ju?

7 PË. Po.

8 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
9 paraqesë në ekran dokumentin nga 034363 deri në 034402. Ju
10 lutem, paraqisni faqen 034373 në anglisht dhe 034391 në shqip.

11 PY. Pyetja që i bëhet atij është:

12 "A ju kujtohet në qoftë se është rrah ndokush?".

13 Ai thotë:

14 "Nuk e di, nuk më kujtohet".

15 Pastaj bëhet pyetja tjetër:

16 "A ju kanë rrahur juve?".

17 Ai thotë:

18 "Jo". Si përgjigje.

19 E shikoni këtë pjesën, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Megjithatë, ju thatë që Dr. Telaku ishte rrahur. Këtë e
22 keni thënë në deklaratën e 2014 për EULEX-in, a është e saktë
23 kjo?

24 PË. Kam thënë që jemi, është përfshi në kacafytje. Domethënë,
25 jam ka flas për deklaratën që e kam dhënë këtu që një javë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç Faqe 138
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 ditë që janë të vërteta dhe nuk jam ato që i kam thënë në 2001
2 e 2014 ato unë i kam tregu arsyt pse i kam thënë. Edhe janë
3 të ekzagjerume. Një mijë herë jam ka ju them. Pa marrë
4 parasysh, janë me mllef edhe janë, i kam bë revansh. S'kam pas
5 tjetër mjet si me revanshu.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kërkoja të kalonim në faqen
7 tjetër në anglisht. Do kërkoja që të zmadhohet pak më shumë
8 dhe të kalohet pak më poshtë në mënyrë që të mund të lexojmë
9 më tepër.

10 PY. Ai është mjek dhe pyetja që bëhet është:

11 "A keni parë ndonjë person i cili ka qenë i dëmtuar, kur
12 keni qenë brenda klase?"

13 Ai thotë:

14 "Nuk e di. Nuk kam parë gjë".

15 Kjo nuk është, është ndryshe nga ajo çfarë keni dëshmuar
16 si ti edhe z. Devaja për EULEX-in në 2014. A është e saktë
17 kjo?

18 PË. Shiko, s'di valla, i kam kalu nja 100 a 200 herë që jam
19 përgjigj në këtë pyetje. Ndoshta duhet, nëse duhet prapë,
20 prapë përgjigjja edhe një muaj dit nëse keni nevojë e dëshirë.
21 Domethënë, krejt këtu çfarë i kam thënë --

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
23 përgjigjuni pyetje; thjesht përgjigjuni pyetjes.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim 034376 në këtë dokument
25 dhe faqen 32 në versionin në shqip.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 139

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 PY. EULEX-i e pyet atë:

2 "A keni parë ndonjë person tjetër të grupit që ka pas
3 lëndime?"

4 Përgjigje:

5 "Nuk e di".

6 "A ju është ankuar ndonjëri prej tyre?"

7 Përgjigje:

8 "Nuk e di, nuk më kujtohet".

9 Pyetje:

10 "Ju keni qenë mjek apo jo?"

11 Përgjigje:

12 "PO, unë kam qenë mjek, por unë nuk e di, nuk më kujtohet
13 nëse më është ankuar njeri mu apo jo".

14 Ai nuk është kujtuar në qoftë se është ankuar dikush tek
15 ai apo jo, sepse askush prej jush nuk është ankuar, është e
16 saktë kjo apo jo?

17 PË. Nuk jemi anku. Domethënë --

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera, i
19 nderuar z. Kryegjykatës, dhe mund të kalojmë në seancë
20 private, publike -- më falni.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
22 në seancë publike.

23 ~~{Seancë e hapur}~~

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
25 jemi në seancë publike.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje të
2 tjera?

3 Z. STRONG: [Përkthim] Nuk kemi pyetje. Faleminderit.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Kemi një pyetje vetëm, për disa
5 pyetje vetëm për një temë, në qoftë se më lejoni.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

7 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Tully:

8 Z. TULLY: [Përkthim]

9 PY. Dua që t'i referohem pyetjeve që bëri Gjykatësi Smith që
10 kanë të bëjnë me [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR] Dua të bëj një lexim ose

12 të citoj nga deklarata që i keni dhënë UNMIK-ut me 4 shtator
13 2001.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti
15 SITF00055954.

16 PY. Afër fillimit të faqes ju përshkruani rrugën nga Baica
17 mbrapsht në Qirez edhe prej aty në Krajmirovç. Ju thoni:

18 "Ata na vendosën aty në vend, pra, në automjet, në Baicë
19 dhe na çuan në nga aty në Qirez. Kishte një lëndinë aty dhe
20 ata na thanë që aty do liroheni".

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR] apo jo?

23 PË. Po aty në Qirez jemi liru. Është e vërtetë ajo.

24 PY. E kuptoj. Tani dua që të shikojmë bashkë deklaratën e
25 EULEX-it të 2014-s ku jeni liruar në Qirez. Për procesverbal

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 141

Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Tully

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1913, F1914RED dhe F2133RED.

1 është dokumenti P680 në faqen 34266. Ju përmendi atë çfarë ju
2 është thënë juve. Po flisni për një shtëpi në rrethinat në
3 Qirez. Por besoj që e keni fjalën për të njëjtin vend, për atë
4 vendin nga ku jeni liruar juve në atë shtëpinë që ka qenë në
5 rrethinat e Qirezit, në ka qenë për këtu e kemi fjalën me datë
6 22 shtator, kështu?

7 PË. Në një oborr në shtëpi.

8 PY. Atëherë Prokurori ju pyet:

9 "Ajo çfarë ka ndodhur atë natë në periferi, në një shtëpi
10 në periferi, në një shtëpi në periferi të Qirezit, çfarë ka
11 ndodhur aty".

12 Dhe ju thoni: "Aty na thanë që jeni të lirë; ne nuk kemi
13 asgjë për t'ju thënë; nuk keni bërë asnjë gabim; nuk dimë se
14 ku do ju dërgojmë".

15 Pra, kur keni thënë në 2014 që "jeni të lirë që të shkoni
16 dhe nuk keni bërë asnjë gabim", a e besuat ju që në qoftë se
17 këta persona do kishin pas duke bërë një hetim ndaj jush,
18 hetimi kishte dalë i pastër ndaj jush edhe delegatëve të tjerë
19 të grupit?

20 PË. Para se me ia nis hetimeve unë e kam dit që jam i pastër,
21 por edhe mbasi kanë hetu këta që kanë pas të drejtë me hetu,
22 sepse kanë pas të drejtë me dyshu, edhe çdo ushtri në botë
23 kish dyshu, çdo ushtri në botë. Domethënë, e kanë vërtetu mbas
24 dy ditëve, 48 orëve që s'ka kurrëgjë prej kësajna dhe jemi
25 liru.

1 PY. Në rregull. E kuptoj. Të hënën në faqen 9435, ju

2 përsëritët:

3 "Ata na thanë që çdo gjë është në rregull me ju".

4 Ndërkohë që në shënimin përgatitor ju thoni: "Ata kryen

5 ose bënë hetimin, delegacioni nuk kishte bërë asgjë gabim".

6 Z. TULLY: [Përkthim] Besoj se thuhet kjo tek paragrafi

7 32.

8 PY. Pra, ju keni qenë konsistent lidhur me këtë pikë, ndryshe

9 nga ajo çfarë ka thënë [REDAKTUAR] që ka pasur një hetim që

10 është kryer ndaj juve [REDAKTUAR] Ndërkohë që ju në mënyrë të

11 vazhdueshme dhe konsistente keni thënë që nuk kishte asnjë gjë

12 gabim të bërë prej anës tuaj. A është e saktë kjo?

13 PË. Asnjë gabim, as më të voglin gabim nuk e kanë identifikuar

14 te na dhe s'kena pas gabim. Edhe për atë arsye ne kemi qenë të

15 lirë; kena vazhdu jetën politike menjëherë se kena mbërri në

16 Prishtinë. Krejtësisht normal. As pa shku te mjeku, kena dalë

17 në rrugë. Besoj që me u konë me shenja siç më keni përshkruar, i

18 onjtën në fytyrë, unë kurrë s'kisha dalë në rrugë.

19 PY. [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 PË. Po.

22 Z. TULLY: [Përkthim] Ju lutem, a mund të paraqesim në

23 ekran provën materiale 158 në versionin shqip dhe në anglisht?

24 PY. A t'ju kërkoj të shihni Zëri i Kosovës. Lart fare. A

25 ishte një gazetë goxha e shpërndarë kjo në Kosovë Zëri i

1 Kosovës?

2 PË. Kjo më shumë ka qenë në diasporë, më shumë, sa e di unë.

3 Edhe pse s'kam qenë lexuesi i saj. Domethënë, edhe në Kosovë

4 është shpërnda edhe në Kosovë, domethënë, por jo shumë. Nuk ka

5 qenë shumë e shpërndamë.

6 PY. Por a pajtoheni se z. Devaja si gazetar dhe botues për

7 diçka të tillë, për një incident të këtillë nuk ka të ngjarë

8 që një artikull i këtij lloji të këtë shpëtuar vëmendjes së

9 tij.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E kundërshtoj sa i takon

11 themelësisë. [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni

18 çaktivizuar]

19 DËSHMITARI: Po ai ka qenë publicist, gazetar dhe ndoshta

20 është më mirë me pyet atë. Mua po më vini në pozitë të

21 vështirë me më pyet çfarë ka mendu ai, pse ka thënë ai. Unë

22 jam përgjegjës çka them unë, çka mendoj unë, çka.

23 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit Dëshmitar. Kaq pyetje

24 kisha.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni

1 çaktivizuar]

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Unë nuk kam pyetje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
4 dëshmia juaj përfundoi, pra, për të gjithë seancën për të
5 cilën ishit thirrur. Asistentja e Gjykatës do t'ju shoqërojë
6 jashtë sallës së gjyqit.

7 DËSHMITARI: Faleminderit shumë. Faleminderit shumë.
8 Respekt për të gjithë që jeni në këtë dhomë.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
12 Prokurorisë që e ka gati dëshmitarin e radhës, por nuk besoj
13 që të kemi kohë që të fillojmë me të. Kështu që është më e
14 volitshme që me dëshmitarin të fillojnë nesër në orën 09.00.

15 Ka gjë që do të parashtrohet nga palët në këto momente?

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, thjesht për provat materiale
17 që u prezantuan sot do kërkoja të njëjtën periudhë pesëditore
18 në mënyrë që të shohim redaktimet përpara se t'i nxjerrim si
19 versione publike.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë në fakt
21 këtë ju inkurajoj të bëni. Të gjitha ekipet që të bashkohen me
22 njëri-tjetrin dhe të shohin çfarë redaktimesh do bëjnë.

23 Z. Ellis u çua në këmbë.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Doja të pyesja Prokurorinë për
25 përditësim për dëshmitarët e javës së ardhshme, sepse javën e

1 fundit kemi pas probleme me videolidhjen.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
3 çaktivizuar]

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Me sa kuptoj unë është konfirmuar
5 videolidhja nga Zyra Administrative që do të jetë funksionale,
6 kështu që besoj se dëshmitarët e javës tjetër --

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të na e
8 jepni sipas rendit që na duhen, ju lutem.

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk e di. Me siguri e di që është
10 siguruar për të martën dhe të mërkurën videolidhja. Besojmë se
11 dy dëshmitarët që kemi për këtë, kishim parashikuar fillimisht
12 për këtë javë do të kalojnë, do të vazhdojnë edhe javën
13 tjetër. Konkretisht dëshmitari 4043 do fillojë nesër paradite
14 në orën 09.00 dhe pas këtij dëshmitari kemi dëshmitarin e
15 radhës 4444.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky është
17 radha që na kishit dhënë edhe më përpara, por thjesht doshim
18 që të siguroheshim që s'ka ndryshime.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Pastaj pas videolidhjes kemi
20 dëshmitarin me numër 04765.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
22 Ndonjë pyetje tjetër?

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Dëshmitari që nuk, që ishte
24 planifikuar fillimisht për këtë javë do të fillojë javën
25 tjetër po thoni?

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Me sa di unë janë gati madje që
2 nesër në qoftë se -- më falni -- domethënë dëshmitari është
3 gati. Në qoftë se dëshmitari i ditës së nesërme nuk na
4 nevojitet gjithë ditën do fillojmë me dëshmitarin që kishim
5 parashikuar. Sidoqoftë, në qoftë se dëshmitari i parashikuar
6 për nesër do duhet të vazhdojë edhe javën tjetër, ne kemi gati
7 këtë dëshmitar për të hënën dhe të martën dhe të mërkurën kemi
8 gati videolidhjen.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
10 çaktivizuar]

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Prapë s'po e kuptoj unë. Pra, ju po
12 thoni pas videolidhjes kemi një dëshmitar tjetër për pas
13 videolidhjes?

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po pra. Është dëshmitari me numër
15 04765.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
17 Faleminderit për bashkëpunimin tuaj. E vlerësojmë shumë.
18 Shihemi nesër.

19 Seanca për sot ndërpritet.

20 --- Seanca mbyllet në orën 15.35

21

22

23

24

25